Faik Mustafa

BURRAT
e
DHEUT

Tregime dhe skica satirike-humoristike

Tetovë, 2012

Botues

Arbëria Design
Redaktor
Sulejman Aliu
Recensent
Salajdin Salihu
Lektor
Artan Arsllani
Ballina
Jeton Mikullovci (Jemi)
Shtypi
Arbëria Design

Botimin e librit e ndihmon KK i Tetovës

dhe vëllai, Sherif Osmani-Daci

RRËFIME JO THJESHT HUMORISTIKE

Faik Mustafa është i dënuar që të mbetet përherë i ri. I fisëm, me humor të këndshëm, ai refuzon që ta shohë botën sipas skemave të ngurta. E ka përjetuar galerën, sepse e ka dashur pafundësisht lirinë, e cila na mundëson që të jemi të dinjitetshëm. Megjithatë, nuk bën pjesë në grupin e të përvuajturve që më pas i bëjnë të tjerët të vuajnë. Ai është dëshmuar edhe në planin artistik, si krijues, nëpërmjet epigrameve, tregimeve dhe skicave humoristike – satirike, të botuara në gazeta, revista ose në formë librash. Ai i shfaqet tani lexuesit me librin *"Burrat e dheut"* – një përmbledhje rrëfimesh jo thjesht humoristike, sepse krijimet e këtij libri të shtyjnë të mendosh më thellë për gjithçka ndodh me ne dhe përreth nesh. Nëpërmjet një diskursi të këndshëm artistik, Faik Mustafa i vë njeriut përpara një pasqyrë hamletiane, për të parë aty të zitë e zemrës. Ai thumbon fenomenet e dëmshme për njeriun dhe shoqërinë. Ai huazon nga përditshmëria atë që i nevojitet për të krijuar rrëfimet e tij sfiduese. I kundërvihet estetikisht pandershmërisë dhe vështirësisë për të qenë i ndershëm në një ambient të ngulfatur nga uniformiteti, efemerizmi, bërja "sikur", servilizmi, mashtrimi, gënjeshtra, shumëfytyrësia, vjedhja, makutëria, spiunimi, thashethemnaja, abuzimi në emër të idealeve të mëdha, abuzimi me vlerat e larta estetike për shkak të përfitimit të çastit, oportunizmi apo heshtja qyqare për përfitime personale, abuzimi me pronën

publike, mungesa e ndjenjës për jetë të përbashkët, guximi i rrejshëm. Ai i kundërvihet, nëpërmjet artit të tij, kaosit brenda dhe jashtë njeriut. I kundërvihet rrënimit të sistemit të vlerave që po bëhet me kazmat e padukshme të atyre që kanë mandatin për ta ruajtur paqen e përhershme ndërmjet njeriut dhe shoqërisë.

Faik Mustafa është njohës i gurrës popullore, veçanërisht formave të shkurtra: proverbave, përrallave, bekimeve, mallkimeve etj., që i ndërfut natyrshëm në krijimet e tij artistike, në funksion të asaj që rrëfen.

Autori frymëzohet nga përditshmëria, nga rrëfimet e zakonshme të njerëzve dhe i mvesh me petkun artistik. Rrëfimi i narratori apo i personazheve është i rrjedhshëm dhe të mban në pritje, kurse kthesat, zakonisht, ndodhin në fund të tregimeve apo skicave të tij. Janë kthesat që krijojnë komiken, apo, sikurse thotë Kanti, të pritshmen e kthyer në asgjë. Ky rrëfim herë është i distancuar e herë jo. Narratori herë i gjithëdijshëm, herë tjetër flet në vetën e parë...

Faik Mustafa ka syrin e mprehtë dhe vrojtues për të kapur detajet dhe nëpërmjet tyre rrëfen me masë duke na mundësuar të qeshim, por edhe të mendojmë. Në këtë kohë kur po bëhemi gjithnjë e më "serioz", kemi shumë nevojë për humorin, sepse i ç'tensionon raportet e acaruara në jetë e shoqëri. Personalisht i kam lexuar me kënaqësi krijimet e përfshirë në këtë libër dhe besoj që edhe lexuesit tjerë do të kenë këtë përjetim estetik.

Salajdin SALIHU

KUDR-a

Shkak partitë politike. Plasi sherri midis dy shokëve të ngushtë, që s'i ndante dita as nata. Kjo i habiti të gjithë ata që i njihnin. Goni, ndonëse s'i përkiste asnjërës, mbante anën partisë më të vjetër, të cilën e konsideronte si pishtare të demokracisë në një kohë përvëluese. Ndërsa Loni,që kishte kaluar gati nëpër të gjitha partitë ekzistuese, fliste në superlativ për më të renë, me emër shumë të çuditshëm KUDR-a.

ZËNKA filloi krejt rastësisht.

- KUDR-a, i kishte thënë Loni Gonit, është parti që dallon nga të tjerat. Ajo nuk mbiu si kërpurdhat pas shiut. Në skenë u paraqit me vonesë, ama, në të u inkuadruan burra, që paraprakisht, kishin kaluar shumë sita. Në një shtet në zemër të Evropës, erdhën si të paprishur e të përvuajtur. Por, siç ndodhë nganjëherë, u buzëqeshi fati. Ndeshën njerëz zemërbardhë, të cilët ua zgjatën dorën e ndihmës. U kujdesën për nxjerrjen e tyre në dritë. I ushqyen, i veshën e i mbathën, duke i kaluar edhe nëpër disa laboratore, me qëllim që, siç arsyetoheshin, t'i parapërgatitnin sa më mirë për jetë. Kur i lëshuan në terren, ishin të përgatitur të veprojnë si patriotë.

- Po,a? - Provoi të ndërhyjë Goni. Kot. Loni aq shumë ishte thelluar në historikun e partisë së re dhe të liderve të saj, sa as ia kapën veshët fjalët e Gonit.

Rreth tyre filluan të tubohen si zgjue bletësh bashkatdhetarët. Nga goja e liderëve rridhte mjalt e

qumësht. U bënë melhem për varrë. Vetëm t'i përkujtojmë demonstratat e organizuara nëpër shtetet e Evropës në mbrojtje të atdheut dhe kërkesave të popullit. E, që thoni ju, nuk ishin fare karrieristë. I organizonin tollovitë dhe njerëzit pas tyre shkonin si Muça pas daive, e vet kurrë nuk dukeshin në ballë. Njerëz vigjilentë, ore. E arrinin qëllimin dhe mjeshtërisht i iknin mbikëqyrjes nga hienat e lëshuara nga ish-Jugosllavia sllavo-komuniste. Bile, të shumtën e rasteve bëheshin tebdilë,me demek,visheshin edhe me rroba grashë.

-Eu, patriot trima se jo mahi! - thumboi Goni.

Loni,si kokëmushk që është,mori flakë.

- Pse pak punë të duket kjo ty dhe tarafit tënd, a? Çdo gjë e kanë dëshmuar me punë. Ashtu siç ditën t'i përfitojnë zemrat e bashkatdhetarëve, me sukses depërtuan edhe në xhepat e tyre. Formuan Fondin për grumbullimin e mjeteve për çlirimin e vatanit. Vështirë gjendej njeri t'i kundërshtonte. E kishin planifikuar mirë. Çdonjëri që do të merrte guximin ta kundërshtonte, sa çel e mshel sytë, e hante tartakuti, e anatemonin dhe saora ia ngjitnin etiketën e tradhtarit të kombit. Prandaj, fondi u fry spic.

- Aaaaa, këtu të besoj. Nga të mjerë shtatskelet, u shndërruan në kaca për turshi.

- Pse, mos deshe ti, zotërote, e shumë gojëkëqinjë të tjerë ta shihni ajkën e kombit duke ngrënë bukë me gjizë e qepë,a? Mos deshët t'i shihni rrugës bythcullak, a? Apo, mos duhet, kujt t'i teket, të kërkojnë llogari prej tyre? Ju jeni mosmirënjohës ndaj gatishmërisë dhe aftësive të tyre. Vetëm ata janë të aftë të depërtojnë atje ku nuk mundet as turjela, për të blerë e përvetësuar trurin autoritar evropian, për ta mbajtur gjallë çështjen shqiptare, për t'i mbrojtur të drejtat e tyre që të rrijnë të nëpërkëmbur. E, ç'mendoni ju? Bëhen këto pa para, a për sytë e bukur të tyre?

Goni,si gazetar me përvojë që ishte, me informata nga më shumë burime, dëgjonte dhe nuk besonte se çfarë dërdëlliste shoku i tij. E kuptonte interesin e tij politik, ama, të kapesh aq fort si i dehuri për gardhi për të mbrojtur të pambrojturën, s'ia kapte fare radakja. E, Loni, në stilin e vargjeve të Nolit "dhe Feridi faqe ndërron,dje shanë sot lëvdon", hyri edhe më thellë nëpër sërnishta.

Hë, kush e organizoi dhe e nisi luftën? Pas kujt shkoi populli? Prej gjirit të cilës parti dolën gjeneralë? Kush…?

Kësaj here s'u durua Goni. Si i çartur, duke ia ndërprerë pyetjet në vazhdim, bëriti:

-Ti që luan bisht e që të tregojnë me gisht, partia jote me emrin KUDR-a, e morët flamurin në luftën e famshme dy-tre mujore, mbrojtët fshatrat e vëllezërve, duke ua faruar pula, gjela, qengja, viça e mëzetër. Shkuat asht e lëkurë, u kthyet all të kuq nga vuajtjet. Ju nga gjiri juaj nxorët gjeneralë me një çerek shekulli përvojë në shërbim të KOS-t, por jo kosit të dhenve, që me lezet e kollofitnit, por në hyzmetet e Shërbimit Sekret Ushtarak në kohën e Perandorisë së kuqe. Është gjenerali, që sipas atyre që e njohin, nuk e shkrepi kurrë një fishek.

- Ti, kur ta përmendësh emrin e gjeneralit, duhet të marrësh abdes. Strategjia dhe taktika e tij e detyroi Evropën dhe Amerikën të intervenojnë, që të mos ndodhte hataja në rajon.Gjenerali mbase s'ka krisur asnjë plumb, por a e di ti sa të rinj i shtyu para plumbave? Deri dje, këta të rinj, ishin kërkushi, sot janë heronj. U janë ngritur varre madhështore, lapidarë, përkujtohen çdo vjet me kurora lulesh. Ja, kështu krijohet historia.

Gjakërat mes shokëve kishin arritur pikën e vlimit.Të dy gufonin si vullkan përbrenda. Heshtjen e prishi Goni.

Ju lumtë, ore! Për meritat në luftë u shpërblyet. Kthyet gëzofin nga frynë era. Prej një partie, emrin e së cilës përpiqesh ta deshifrosh si Këshilli i Unitetit Demokratik Revolucionar, shkurt KUDR-a, u shndërruat në integristë të flaktë. Me kapitalin e luftës, n'i thënçin asaj luftë, mashtruat edhe njëherë popullin. Fillimisht, përfituat zemrat, pastaj xhepin dhe, ja tash, edhe votat.

Loni e pa veten të zënë ngusht, por, nuk u dorëzua.

Kush është i zoti, mos i shkoftë zi moti.

Fjalët e fundit sa nuk e nxorën taktit Gonin. Kafshoi buzët fort për ta mundur tërbimin dhe foli:

Dhe tash sa gjatë e gjerë, pa kurfarë kushtesh, keni rehatuar prapanicat në prehër të atyre kundër të cilëve e zhvilluat luftën, rrini urtë dhe keni rënë në ekstazë nga kënaqësia e vetëorgazmës që e përjetoni, duke e rënduar edhe më tepër pozitën e popullit që ju besoi. Ani,vazhdoni! Mos u ndalni! Ky milet ju meriton. Më kot pleqtë nuk thonë: "Si jemi, punët i kemi".

Pas shqiptimit të fjalëve të fundit, Goni ndjeu të jetë liruar nga një barrë e madhe. Nuk i mundësoi Lonit t'ia kthej. Me hapa të shpejtuar, që i ngjanin më shumë vrapit, humbi në lakun e parë të rrugës. Ata,që e dëgjuan dialogun,kishin mbetur si të nemitur. Mbase s'do të kenë qetësi edhe kur të shkojnë në shtëpi, duke vrarë mendjen se cili prej shokëve kishte të drejt.

FLIJA NË FYT

Zizi, si e kreu punën praktike të mjekut, fitoi besimin se dallon nga shumë kolegë të tjerë dhe e dërguan në punë në një poliklinikë më në zë të qytetit. Ajo, funksiononte në kuadër të kombinatit me renome. Kushtet e punës të mrekullueshme, besa edhe të ardhurat dallonin. Si i ri, përplotë energji, mbase edhe me ideale që të jetë në shërbim të qytetarit, të punëtorit, gjithëherë ishte i buzëqeshur, gojëmbël. Shpejtë i doli nami për të mirë. Lehtësi të madhe e kishte se vinte nga një qytet tjetër dhe të gjithë pacientët ishin njësoj për të. Ndjente kënaqësi që i buzëqeshi fati kur e dinte se shumë të tjerë heqin të zitë e ullirit duke shkuar nëpër fshatra.

Një ditë, në ordinancën e tij, u duk një burrë musteqosh aty të 50-tave. Si u përshëndet, ia tregoi hallin, butë e ëmbël:

Doktor, ti nuk e di sa shumë të duan njerëzit. Mjek më të mirë ende s'kemi hasur!

Faleminderit, faleminderit! Ju, s'keni asgjë serioze. Keni marrë një ftohje të vogël. Me ilaçet, që t'i kam përshkruar, shërohesh! - i tha.

Të lumtë, ore! Ama, të lutem, para s'e të dal, e kam një lutje, besa edhe amanet nga im at. Rixha të bën, të na urdhërosh një ditë andej nga ne në muhabet.

Faleminderit, po s'ka nevojë.

Aaaa, llaf është kjo! Ne të marrim me makinë dhe ne të kthejmë, kur të ta dojë zogu i qejfit. O për ty, o për askë tjetër…

Pas shumë lutjesh, Zizi, si hatërxhi që ishte, pranoi propozimin. Në ditën e caktuar pushimi, shkoi. Boboooo, ç'befasi! Si të kishte ardhur në dasëm. Muhabet deri në fyt. I rrinin gati në këmbë gra e burra. Sa i vinte mirë për nderin që ia bënin, shpesh e kaplonte një nebulozë truri, duke kërkuar pse-hun e gjithë asaj që ndodhte rreth tij. Unë jam i ri e s'kam bërë asgjë të jashtëzakonshme – thoshte me vete!

Plaku, babai i pacientit, të cilit as emrin nuk ia kishte mësuar, që pufiste pandërprerë cigare në një çibuk të gjatë e të thurrur me sërm, i tregoi shumë vakira nga e kaluara, për trimëri e bujari të familjes.

Dhe fjala fjalë, si e morën edhe e kthyen. Bile, kur arritën te banesa, ku banonte me qira, nga bagazhi i makinës nxorën edhe një shportë goxha të madhe.

Urdhëro, doktor, edhe për shoqen ca gjëra.

Ju lutem, s'është nevoja, unë…

Doktor, mos e prish. E mira shkon deri në fund. Nuk bën të anashkalohet as fisnikja.

Ia lanë shportën në dorë dhe saora avulluan. Domosdo se s'kishte çare pa i dërguar në banesë. Ç'të shihte! Brenda, të gjitha të mirat. Fli, zogëza pule të pjekura, vezë pa galofak, djath të pamazitur… Gruaja e ndjeu veten tepër të lumtur, jo aq për shportën plot, sa për autoritetin e të shoqit që kishte arritur aq shpejt në punë. Zizi qëndronte si i nemitur. Parandjente se dardha e ka bishtin pas. Nuk guxoi të thotë para të shoqes se ajo mund ta fshinte përpara me atë gjuhën e saj çakallë.

Nuk kaloi shumë kohë, në ambulancë, ja, erdhi miku i tij i shtrenjtë. E priti si është më së miri. Si e pyeti për të gjithë të shtëpisë foli:

Hë, ç'e mirë të solli? Përsëri i ftohur?

Jo, doktor, si molla jam. Por, të mbetet mes nesh! Është koha e kositjes së livadheve. Më duhet një javë pushim mjekësor.

Zizi u rrënqeth i tërë. U mat, si tip naks që është, ta qortojë se si nuk i vinte turp, ama, një forcë nga brenda e ndali. Ia mori librezën dhe ia plotësoi kërkesën. Nga brenda ziente si gështenjat në tenxhere. Nuk e bëri të madhe dhe e harroi. Vazhdonte punën me zell e pa hile. Nuk lejonte pacientë të prisnin. Kjo, shpesh i nxirrte telashe me kolegët e tjerë, duke ia ngjitur një varg bishtash. I fuste veshët në lesh dhe, pashë s'pashë, vazhdonte me të veten. Diçka shumë e trishtonte. Mos t'i përgatisnin nga xhelozia ndonjë kurth. Ishte i vetëdijshëm se nuk mjafton të jeshë profesionist i mirë. Duhet edhe t'i përshtatesh kohës. Pra, ata lart, të cilët vendosin për karrierën tënde, duhet t'i lavdoshë e t'i çoshë në qiell, paçka se kjo s'është e vërtetë. Të gjithë e dinë se përparimi yt gatuhet në kabinet. Servilizmin e kishte zët, po, ç'të bënte. Mos të pikshin në qafë. Të moçmit kot s'kanë thënë: një i lig e një i sëmurë, një të shëndoshë e bëjnë urë". Dhe i delte parasysh një profesor i tij, ndër mjekët më të shquar në qytet, që për llapën e tij pa qime, e hëngër. Ia ngjitën një varg izmash, sa e detyruan të emigrojë. Atij, në vend që ta kafshojnë, e përqafuan, si i thonë një fjale, ka bërë emër në Perëndim dhe jeton si veshka në dhjam. Ama, këtu, duhet hapur sytë se shkon si qeni n'rrush. Sa më shumë që kalonte koha, doktori i ri idealist, sikur hetonte se gjërat nuk janë ashtu si duken. Bujaria e buzëqeshjet janë me hile. Kjo erdhi në shprehje një ditë të premteje kur në ambulancë hynë pa trokitur musteqoshi 50-vjeçar i shtëpisë së madhe, bashkë me kushëririn e tij.

- Doktor, ngutemi të shkojmë ta falim xhumanë, të lutem, për mua dhe kushëririn tim, ashtu si din ti, të na i shkruash disa ditë pushim. I kemi të korrat e kombajnat

duhet t'i shfrytëzojmë se s'bën ndryshe. Kemi ne, ke dhe ti, s'të lëmë keq. Jemi, a s'jemi tanët?

Zizit iu bë se tërë ambulanca iu sollë. Ndjeu sikur mbi shpatulla i ra qielli. Nga shqetësimi, gati iu zu fryma. Për një çast, iu terrua çdo gjë.

- Doktor, je mirë, doktor?! - dëgjoi ca zëra. Kjo e këndelli. Përpara veti pa dy silueta. Nuk kuptonte. Kishte të bënte me njerëz apo hijena që donin ta shqyenin. Si tundi ca kokën dhe fërkoi sytë, u afrua te lavamani dhe, i drejtuar nga pacientët. Me zë të çuditshëm, shpërtheu, duke i futur dy gishtat e dorës së djathtë në gojë:

- A do të largoheni nga ambulanca, apo me këto dy gishtat në fyt kam për t'i vjellur pulat, flinë, djathin, mazën, vezët, se të gjitha i paski me sherr!

Kur hetuan se sytë e doktorit të mirë shkëlqenin si gaca të gjalla, të gatshme edhe për më të keqen, me bishtë nën shalë, dolën pa bërë gëk as mëk.

Ani se përhapën një mori përfoljesh, Zizi u qetësua dhe vazhdoi punën me të tijën.

BURRAT E DHEUT

Turidhelpëra, siç e thirrin shokët Micin, e kishte matur mirë punën dhe i kishte vënë në përdorim hundët për të nuhatur rezultatet që mund të dilnin nga ndeja, që duhej çdo çast të ndodhte. Po, po. Kishte bërë çka kishte bërë, e kishte bindur liderin e partisë më të fuqishme në pozitë, që, ta nderonte me një vizitë në shtëpi. E kishte të njohur të moçëm. Prandaj, Besharetja (kështu quhej e shoqja), kishte bërë përgatitje asisoji, siç njihej e shkathtë, sa ishte e bindur se do ta mahniste mysafirin. Mandej, ajo nuk ishte si gratë e tjera. Është kush është, nuk ka pehris fare. Ia plasë në fytyrë të mirën e të keqen gjithkuj. Ama, kësaj here, ishte zotuar para Micit se do jetë e kujdesshme, do të jetë më e kulturuar. Mici i shkretë, bënte si pordha nëpër brekë, duke u endur nëpër sallon. Si i afrohet pasqyrës, rregullon kravatën, mbledhë buzët për të parë dhëmbët a i shkëlqejnë. I duket vetja goxha mashkull.

Ah, po! Ujk i vjetër kam qenë dhe jam – nisi të fliste me Micin në pasqyrë. Gjithmonë e kam pasur nuhatjen e mirë. Që në nismë ua ndiej erën ndryshimeve politike. Kjo më ka ndihmuar gjithmonë të jem, mos i pari, pranë të parit. Paçka se ndryshojnë sistemet, ndryshojnë partitë. Unë, në qofsha burrë, nuk jam mur.

Mbase do ta vazhdonte bisedën me veten edhe gjatë, sikur mos të ishte dëgjuar cingërima e ziles. I tëri i shqetësuar, në vend se të niset nga dera e hyrjes, hapë atë

të banjos, hutinë e të cilit e përmirësoi e shoqja, duke e tërhequr për krahu.

Hajt, hajt, se nuk na vjen mbreti! Ç'më je bërë si limoni!

Bashkërisht e hapën derën. Ç'të shihnin? Para tyre, skopani Dan. Në të dyja anët e portës heshtje varri. Tri mumje të gjalla shikonin njëri-tjetrin pa e hapur gojën.

More, e kam gabuar adresën apo ka rast vdekjeje? Ç'është kjo huti? Ku është buzëqeshja, që i falet mysafirit, ku është mirëseardhja?!

Bah, urdhëro! Mirë se na erdhe! - u dëgjua zëri valë-valë i Micit. - Ama, që thua ti, dua të them… ashtu pra…

Dani si Dani, pa ua vënë veshin shllajfitjeve të fjalëve, që dilnin nga goja e Micit, zuri vend në fotele. Bile, nisi edhe ai si zagar të nuhas. Kur mendonin se ai e ngacmonte të zotin e shtëpisë, foli:

Aiiiii, bre, ç'erë e këndshme! Ia ndiej erën parfumit, ama edhe më tepër mishit në kuzhinë.

Jo, ore jo, vie nga zgara e qebaptores poshtë banesës, u ngutë të përgjigjet Besharetja.

Në derë, përsëri u dëgjua cingërrima. Burë e grua u shikuan mes veti. Mbetën si të shtangur, s'dinin si të reagonin.

Hapeni, ore, a shurdhë jeni? – urdhëroi Dani.

Nuk kishin nga t'ia mbajnë. Hapën derën.

Oooooo, kush na erdhi! Na u zbukurua shtëpia! Dielli vet!

Dani, dëgjonte e nuk besonte. Kujt iu drejtohen gjithë këto fjalë të bukura. Mbase dikush nga larg. Mendimet ia zhdaraviti hyrja e mysafirit të ri. Të zotët e shtëpisë në ethe. Mysafirët, me sy të çakërdisur donin ta përpinin njëri tjetrin të gjallë.

Ti?! – foli Dani.

Unë, po, po ti? – shkrepi tjetri.

Mos të ishte Besharetja me autoritetin e saj ta kthente qetësinë, mbase mund të ndodhte tërmet.

Në këtë shtëpi kollitem unë! Secili keni vendin e merituar. Jashtë këtij ambienti, në parlament, vazhdoni të bëni si gjela!

Mysafirët u shikuan vëngër deri sa nuk u shtrua tavolina përplot të mira. Si filloi cakërimi i gotave, fillimisht me nervozë e, pas ngritjes me fund të disave, u krijua atmosferë krejt tjetër. Ha, pi e fol. Nuk mungonte besa as muzika e zgjedhur në ekran. Këtë e ndihmonte edhe Besharetja nganjëherë duke kënduar lajf.

Çka kërkon Dani këtu? - ngacmoi lideri i pozitës.

Në vend të Micit, reagoi Dani.

Pse, kush mendon se je ti?! Mos je më i mirë?

Jam pushtet, në të cilin kam ardhur me pushkë, kam luftuar...

Hahahahaaa… - ia plasi gazit Dani. - Ke luftuar?! Besa mirë e ke. Për disa muaj, që humbe si shurra e pulës, duke u fshehur maleve, nuk le ti e soji e sorollopi ytë, pulë, qengj e as viç në fshatra. I kollofitët të gjitha. Ikët xhenaze, u kthyet kuq si bostani.

Shihe, njëherë, shihe kush po flet. Njeriu që shërbeu tërë jetën në ish sistemin kuqalosh, ka guxim t'i nëpërkëmbë vlerat e luftës! Pështynë në gjakun e bijve të rënë për liri…

Hajde, hajde e mos llap shumë! Të vdekurve, që erdhën pas teje, u qoftë toka e lehtë, po flas për të gjallët. Para luftës së paqenë, s'kishin lesh në byth, tash kanë shtëpi, banesa, vetura, shëtitje pas shëtitjes…

Në mes provoi të hynte Mici, t'i qetësonte. Ua mbushte gotat t'i çonin në fund. Ua mbushte pjatat me mish. Ata zhvatnin, si luani prenë dhe merrnin edhe më tepër energji për sulm. Bile, i pikën në qafë njëri dhe tjetri zotit të shtëpisë.

Ah, ti! Kush je ti? Paradite me mua, pas dite me të! – tha Dani.

Edhe në ish sistemin, kur ishim anëtarë të partisë, i tillë ishte. Përherë kalonte pa therrë në këmbë.

Besharetja i dëgjonte bisedat nga kuzhina. Ëndërrat e të shoqit se organizimi i ndejës së sotme do të shpaguhej me punësimin e ndonjërit prej djemve, po binte në ujë. Dinsëz njëri, imansëz tjetri, i cilësoi mysafirët. Lavdet e tyre se kush është më trim, ia sollën shpirtin te hunda. Pa një e pa dy, nxorri një revole lodër, për nga pamja origjinale, ashtu edhe nga krisma dhe me turr u fut në sallon.

Ç'është kjo zhurmë këtu? Me ngrënë e pi keni sa të doni, muzikë po, atëherë, kujt ia shitni trimërinë?!

Mori guximin të flet Mici, për të treguar kush është zot shtëpie dhe sa u çua në këmbë, nga brezi Besharetja nxorri revolen dhe krisi. Mici, si lis i prerë, ra në tokë dhe u fut nën tavolinë. Pas tij, edhe Dani dhe lideri i pozitës. Kur dëgjuan krismën e dytë, ndodhi mrekullia.

More lider, ty po të shkojnë pordhët, hej! – foli Mici.

Mua, po, por dhe jarani yt i ka mbushur pantallonat! Qelbëson i tëri.

Dilni, dilni nga nëntavolina o ju burrat e dheut, dilni dhe shporruni se nevojtore ma bëtë shtëpinë! Merreni edhe këtë teveqelin tim! – urdhëroi rreptë Besharetja.

Në atë çast arritën në shtëpi edhe dy djemtë e vajza të cilët, kur panë këtë skenë, nisën ta mbajnë barkun nga gazi.

MJEKRA MIQËSORE

Kaloi pranë nesh si para kishës, siç shprehen të moçmit, pa na e hedhur syrin e jo më t'na përshëndes. Nuk na pa, vërtet, apo nuk është mirë, ishte pyetje që lindi instiktivisht. E njihnim mirë natyrën e tij. Dinte të krijonte atmosferë edhe në kushte të vështira. Sa çudi, nisi të flasë vetmevete. Bënte me dorë e me kokë. Kjo ishte shenjë se diçka i ka krisur e koptusur. Si më i afërt i tij, që më nderonte pa hile, ngadalë e me takt iu afrova.

Tatjeta, miku im i vjetër!

Si më mati me sy prej tepesë së kresë deri te këmbët, nuk më foli, por me dorë më dha shenjë që të ulem. Meqë kamarieri ishte aty, pa më pyetur fare, foli:

Një teke dhe një dopio raki rrushi!

S'ia prisha. Nuk folëm derisa i pamë përpara gotat e rakisë.

Gëzuar! - i them.

Gëzuar, me të mira! – ma ktheu.

Hape gur gojën. Luli vet i katërdhjeti. Vetëm që nuk shkumonte nga sikleti. Akullin e heshtjes e theva unë.

Nuk të kam parë në këtë gjendje kurrë. Mos… ndoshta…

Ai, sikur e priti momentin.

Çka nuk mban toka… - shpërtheu.

Toka… Për atë është krijuar ajo… - ia ktheva.

Po, a? Për të bartur edhe halldupë, matrapazë, gënjeshtarë, hajdutë, servilë, hafije…

Ani de, kjo e bën jetën më interesante. Mos të ishte e keqja, s'do ia dinim vlerën të mirës, mos të ishte e tharta ose e hidhura, s'do dinim ta shijonim të ëmblën…

Mua më gjete të më mbashë orë filozofie, a? Kur ta pësosh, siç e pësova unë, atëherë do shihje a të shkon mendja për të filozofuar.

Uaaa, me demek, nëse më lejohet të konstatoj, ty të paska pjellë diçka.

Çfarë të pjelle se! Fundja, ç'janë 99 shkopinj në byth të tjetrit?

Pa, hë, pa hë, të dëgjoj!

Luli mezi priti. Gjuha e tij nisi të punojë si çakallë mulliri. Kërkoi t'i ngrehim gotat me fund, duke porositur edhe nga një tjetër.

Eh, lum vëllai. Kot të moçmit nuk kanë thënë. I besës jij, besë mos zë. Nuk e kemi bërë shumë mall këtë. Mandej, nevoja të çon mos ta përfillësh. Ama, kur ke fëmijë detyrohesh ta bësh. Dy vite ua thava zorrën familjarëve, që pastaj mundi, sa çel e mshel sytë, të më avulloj.

E çoi edhe një gllënkë raki. Ndezi cigaren. Si i lëshoi disa tollunga tymi, vazhdoi:

- Më erdhi në shtëpi djali i mikut. E prita me krejt të mirat. Një që e konsideroja të afërt, por edhe për aftësitë që kishte, dua të them, bën si shkop kaçamaku dhe arrin si turielë të depërtojë ku s'ta merr mendja. Meqë djali ka dy vite që ka kryer fakultetin e s'po i plasë fati për punësim, kërkova ndihmën e tij. Të gjitha kursimet ia dorëzova, që helbete, ndihmojnë për ta lyer rrotën, e…. Eu, ç'ma bëri rrafsh. Punë e kryer, më tha. Njoh këtë ministër, njoh atë deputet, në partinë në Qeveri ma kanë hatrin e kështu me radhë. Prit një muaj, prit një vjet, pushka e mikut s'po kërset.

- A u sos puna?

- Për dikend po, ama jo për mua.

- Dale se ma përzive, si i thonë, me kos. Të kreu punë?!

- Kreu, kreu, he e kreftë ndërvete! Në vend të punësimit të djalit tim, punësoi të vetin. Ma lëshoi mjekrën miqësisht.

- Eh, vakia e Zotit, i them. Të paska gjetur si ajo përralla e moçme, kur njëri kishte hyrë mësit një mikut, t'ia nxjerrë një nuse. U mundua shumë, fundi me sukses. Por, për kend? U mundova shumë, ama, mezi e bëra për vete, kishte thënë mësiti.

Kjo, sikur e qetësoi dhe e relaksoi pak Lulin.

Djali i mikut dhe tarafi i tij, na i marrshin të ligat. Hu më hu, hyri të hynë, mbase një ditë ngulen dhe i paguajnë mëkatet!

SHKULJA E GJUHËS

Rrallë ndodhë që Sela të çojë gotë rakie kohë pa kohë. Preferon zakonisht mbrëmjeve, dhe atë, më shumë për hatër të shoqërisë. E bekuara, ka qejf shpesh ta thotë, ta freskon gërmazin e ta këndellë trurin, që të ndjehesh vërtet i lirë. E pi me karar dhe pa zarar.

Aaauuu, do të ndodhë kiameti! - i tha Dani shokut të tij të fëmijërisë. - Nuk mbaj dot mend të të kem parë të pishë në këtë kohë!

Pijnë burrat, pijnë edhe kohë e pa kohë.

Ishalla për gëzim.

Mos dërdëllis shumë e bashkohu ta ngremë nga një gotë!

Kokën ta thyej, por qejfin s'ta prishi! - u tall Dani. - Ama, të lutem shumë, vetëm një gotë sa për qarkullimin e gjakut.

Do thuash një gotë medicinale.

Hë, hë, ja qëllove, do të thotë sa për mbytjen e mikrrobeve.

Mikrrobeve?! Aiii dhe ti! Për mikrrobe janë zbuluar barna e barna dhe zhduken pa nam e nishan. Ka diçka më zi se mikrrobet.

Me sa kuptoj, lum vëllai, ti paske një siklet.

E kam unë, e ke ti, e kanë gati të gjithë burrat.

Si i cakëruan gotat, një çast qëndruan pa bërë zë. Sela i bërë vet i katërdhjeti, nuk dinte bëri mirë a jo që e

çeli këtë temë, ndërsa Dani, priste t'i dëgjonte hallet e shokut, i bindur se mund edhe ta ndihmojë.

E nisën me një, arritën te gota e tretë.

E, tash, në më ke mik, shfryu! Qite atë barrë prej Brenda! Çlirohu! - e prishi qetësinë Dani.

Jo, or, jo. Janë telashe të zakonshme, të përditshme. Herë durohen, herë të pëlcasin. Por…

Nejse, të tilla siç janë, rrefehu! Mos ke telashe me punë?

Jo, atje çdo gjë vete mbarë.

Mbase, probleme familjare...?

Të gjithë i kam shëndosh e mirë si molla. Gruaja, ah, vetëm gruaja!

E sëmurë?!

Punë që s'bëhet. E fortë si mushkë.

Atëherë?

E sëmurë në kokë, në gjuhë, në kërkesa megalomane. E dërgova fisniken te stomatologu se mbrëmë s'bëri një pikë gjumi. Deri sa merrej me dhimbjet, ishte e mrekullueshme. Vetëm që s'më hante me sy nga dashuria. Do ti, vetëm sa dolëm prej klinikës, harroi çdo gjë.

Hë, ku ta shkeli bishtin?

Nisi të më shetiste vitrinë pas vitrine. Shtroi kërkesa e kërkesa. M'i numëroi një varg dasmash e lindjesh që vijnë me radhë. Janë të gjitha nga të familjes tënde, nuk dua të turpërohem e fajin t'ma lënë mua, më tha. U mundova ta qetësoja. Doja ta bind që të gjitha i zgjidh vet. Nderi bëhet sipas takatit. Nuk është mirë ta shplosh bythën tënde, për t'ia mbuluar tjetrit. Pa, le të jetë edhe i afërmi. Kot. Desh më hëngri gjallë. Pas gjithë atyre viteve martesë, guxoi e më tha se s'jam kurrfarë burri.

Pastaj?

Shpërtheva si vullkan. Shava rëndë.

Kend, atë, të familjes?!

Jo, ore, jo, por stomatologun.

Po, ai, ç'të pati faj?

Ka, ka dhe mirë bile. Ai ia shkuli dhëmbin gruas, e çliroi. Jo, vëllaçko jo, duhet të kemi mjekë që dinë të shkulin gjuhën. Ta kishte bërë këtë me gruan time, s'do të kishte fare telashe.

Pas këtyre fjalëve Sela vërtet sikur u çlirua. E hetova nga sytë e tij si të pleshtit, prej nga shpërthyen ca shkëndija gëzimi.

TUTA NË PALCË

Laçi është djalli vet. Çka nuk i pjellë truri atij. Po të mori përpara i lave duart, të fshiu tartakuti. Të çmend të tërin. Kështu ndodhi me Salon mbrëmë. I shkreti. Nuk ka kohë që është liruar nga Goli Otoku. Atje, si shumë të tjerë që e kanë përjetuar këtë kazamat çnjerëzor, vetëm t'ua përmendësh, bijnë në ethe. Sipas adetit, ishim mbledhur në mbrëmjen e radhës tek shtëpia e Laçit. Këtë e bëjmë prej kohësh me shokët, që konsiderohemi intim mes veti. Është argëtim i vetëm për ne si gjeneratë. Shumica jemi mësues. Përgatisim sallata të ndryshme, gjizë e djath e, besa, dhe mish. Mbase, jo me bollëk, ama, që thoni ju, ngihemi me erën e tij të këndshme. Kështu, një herë në javë, në këto ndeja relaksojmë shpirtin nga punët e ditës. Përmes përfoljeve, lavdeve e sharjeve të atye që i konsiderojmë fajtorë të problemeve që na rrethojnë, shfryhemi mirë. Sidosmos kur ia nisnim rrëfimit të barsoletave, përmes të cilave fshikëllejmë dobësitë e pranishme. Jemi marrë vesh që politika të ishte jashtë ndejës. Edhe muri ka vesh, thonim. Përse t'i qesim ferra vetes në këmbë. Hafijet e UDB-së janë të pranishme gjithkah, bile edhe në gjiret tona familjare. Prandaj, është e pamundur edhe pordhën ta fshehësh. Për dreq, në pikën e gëzimit, kur ishim bër all në faqe nga rakia e rrushit dhe pas këngëve, që i kënduam me shpirt, fjalën e merr Laçi. Në vend të barsoletës, për çka është mjeshtër, i mvërejtur, u çua në këmbë e me zë ca të ngritur, foli:

Hapni veshët e dëgjoni mirë!

Edhe pse bënte zheg vere, si u afrua te dritaret, i mbylli dhe i lëshoi perdet e trasha. Nga një orman aty pranë, nxori një pushkë gjuetie, me dy tyta, trashëgim nga i ati, gjuetar i njohur. Si e shtrëngoi mirë, na u drejtua:

Shokë, është koha të zgjohemi nga gjumi i rëndë. Sa më shumë që e durojmë zullumin aq më shumë ai trashet. Jemi intelektualë, s'guxojmë të durojmë deri në pakufi. Patjetër të organizohemi!

Pa e lënë të vazhdojë mëtej u dëgjua zëri revoltues i Salos:

Nuk dëgjoj kurgjë, nuk jam këtu!

Të gjithëve na u tha pështyma në fyt. Nuk kuptonim ç'po ngjet. Laçi si Laçi, si pa të keq, vazhdoi me të veten.

Duhet t'i ndajmë detyrat konkrete, të veprojmë...!

Salua brofi në këmbë dhe me të dyja duart kishte mbuluar veshët edhe më i shqetësuar, shfryu:

Nuk jam këtu, nuk dëgjoj!

Unë, - vazhdoi Laçi, - shyqyr Zotit, e kam këtë çifte dhe jam i gatshëm të marr hak.

Të gjithë qëndronim si mumie të gjalla, të befasuar në kulm. Kur mezi pritnim rrjedhën e bisedës, pamë Salon që brofi në këmbë, sikur ta kishte pickuar gjarpëri. Pa një, pa dy, hapi dritaren që e kishte pranë dhe me kërcim akrobati, sa çel e mëshel sytë, u hudhë jashtë me vrap. Iku pa e kthyer kokën.

Ç' bëre more Laç kështu?! – i fola me hidhërim.

Ai, sikur të mos kishte ndodhur asgjë e jashtëzakonshme, ia plasi gazit në kupë të qiellit. Qeshte aq fortë sa na lindi dyshimi mos ka lojtur nga fiqiri. Por, jo.

- Heu, ju burrat e dheut, trima patriotë, i mbushët brekët, a? Boboooo!

Mbetëm të shastisur. Ulëm kokën. E kuptuam djallëzinë e radhës të kurdisur nga Laçi.

Ia punove keq, Salos - i themi si në kor.

Jo! - u përgjigj ai. - E kuptoj gjendjen e tij psikike, vuajtjet në Goli Otok, ama është koha edhe ta ndihmojmë, ta çlirojmë nga kompleksi i tepërt i frikës së grumbulluar. Do thoni, 99 shkopinjë në prapanicë të tjetrit, s'janë gjë. Dakord. Ne duhet të kemi kujdes. Por, komitetlinjtë e mortajës së kuqe, kujt ia vënë pikën, e fshinë përpara kur të duan. Të moçmit kot s'kanë thënë "Një i lig e një i sëmurë, një të shëndoshë e bëjnë urë".

E dinim se djallzitë e Laçit ishin qorr fishek, pa zarar. E vazhduam ndejën deri në të gdhirë të mëngjesit. Vetëm në të ndarë, u besatuam, që e gjithë çka ndodhi, të heshtet, të futet në dhe, të vetëdijshëm se po doli për mejdani, bëhemi gaz i botës.

TOPET

Nodhi kjo në vigjilien e shënimit të 500-vjetorit të Skënderbeut. Në të gjitha qytetet me popullatë shqiptare, zhvillohej garë e paparë, kush më mirë do ta organizonte manifestimin për këtë qëllim. Ishin pesë minuta të çmueshme për të dëshmuar se kush është më patriot. Mandej, kishin kaluar shumë vite nën sundimin e mortajës së kuqe që s'lejohej të bësh gëk as mëk për të përmendur ndonjë figurë nga historia kombëtare e lëre të organizosh program. Në qytezën ku jetoja, në krye të Pallatit të Kulturës, kështu e quanin …. ani se ajo pak ndryshonte nga një kasollë e rëndomtë, qëndronte Culi. Edhe pse i kishte vetëm katër klasë fillore, për shkak të biografisë së pasur si mbrojtës i vatanit, ishte shpërblyer me këtë post. Si tip ambicioz, i kishte dhënë vetes për detyrë ta mbante flamurin e të parit. Përveç angazhimit të shoqërisë kulturo artistike vendëse, kishte ftuar edhe këngëtarë të njohur me qifteli e sharki nga një qytet më i madh. Po, hallin e kishte te salla e pallatit. Ndonëse e kishte zbukuruar si kishte ditur e mundur, nuk ishte i kënaqur. Donte të bënte diçka të paparë. Prandaj, kishte marrë në telefon mikun e tij nga një qytet më i madh, ku funksiononte edhe teatri. Njihenin me kohë.

Alo, tatjeta e mira!

Tatjeta, dhe ty, burazer.

Hë, do më ndihmosh a jo?

O për ty, o për askend.

Të lumtë goja! Pra, siç të kam thënë, sonte dua ta kalli krejt qytetin. Le të dihet kush është Cul Kaculi. Prandaj, nisi ata dy topat që t'i kam kërkuar!

Punë e kryer, miko. E thënë, e bërë. Veç sa s'të kanë arritur.

Brofi i ngazëllyer në këmbë, duke i fërkuar duart me gojën vesh më vesh. I harroi edhe ca miqë që ishin aty. Sa u afrua pranë një pasqyreje të vogël, të vendosur në derën e ormanit që ishte e hapur, duke fishkëlluar, nisi të marrë ca poza të çuditshme. I bëhej se ka hypur mbi një at të bardhë në krye të kolonës me flamurin kuq e zi.

Le të binden se nuk jam krejt ashtu si më njohin! - pëshpëriti nëpër dhëmbë.

Kur u këndell. Hapi sytë dhe pa se kishte mbetur kalli vetëm. Në zyrë s'kishte ngelur njeri. Nuk iu bë vonë. Ishte shndërruar në pritje të mbrëmjes që vjen. Papandehur dhe pa trokitur, brenda u fut sekretaresha e tëra e zbehur.

Hë, zogëz, ç'ke? Ç'më je bërë si xhenaze?!

Kanë ardhur… përjashta…njerëz… mysafirë nga… - foli me zë të ngjizur. As që arriti ta përfundojë fjalinë, brenda futen dy veta me sy të çakërdisur.

Ju jeni Cul Kaculi?

Unë, dora vet. Urdhëroni, uluni!

Jo, po çohu ti dhe eja me ne!

Të nderuar, kam punë e….

Edhe ne kemi punë e për punë të marrim.

Më shumë s'i lanë afat të hapë gojën. E mbërthyen për krahësh e gati si një cofëtirë e nxorën prej zyre duke e mbërthyer në një veturë që priste jashtë.

Hej, ç'po ngjet, ku më çoni?

Atje ku e ke vendin.

Sa çel e mëshel sytë, e pa veten në zyrat e policisë. Nuk mund të besonte. Është ndonjë gabim, mendonte me vete. Më kanë përzier me ndonjë tjetër. Por jo, aty u fut

një burrë skopan. Pa e pyetur për emër e mbiemër, kush është, çka bën, me nofulla të shtrënguara në shenjë kërcënimi bërtiti:

Hë, do ta kallësh sonte qytetin, a? Ta ka bërë nëna a baba atë, a?!

Koka i gumëzhinte si t'i kishte hyrë brenda një bumbar i madh. Nuk e kishte të qartë, ishte kjo një mahi a përnjëmend?

Po hesht, a? Do të na e hedhësh, a?

E keni gabim, e keni shumë gabim! Unë jam Culi. Unë, në këto zyre, kam sjellë shumë armiqë kundër popullit e shtetit dhe ua kemi treguar qejfin. Së bashku i kemi dërguar atje ku e kanë vendin.

Po, është shumë e vërtetë. Ama, këtë e ke bërë për t'i mbuluar gjurmët, për të vepruar më shlirë.

Për Allah, jo! Pasha t'madhin Titë.

Mbylle mos e fëlliq emrin e tij, mor maskara!

Në zyrë, futet një polic trupmadh, i gatshëm të zbatojë urdhërat që do ia jepnin. Culit një çehre i shkonte, një i vinte. Ishte larë i tëri në djersë. Përpiqej të gjente ndonjë fjalë dëshmie se e gjithë kjo ishte vetëm keqkuptim, por shikimet shtazarake e nemitnin.

Shkulja topet këtij qyrraveci, që kërkon ta kallë qytetin, nëse nuk tregon fije e për pe planin e organizimit! – u dëgjua zëri i inspektorit.

Kur polici u afrua nga Culi, ai, i kishte shtrënguar këmbët sa s'bëhej nga frika. Kishte ndier një herë si të ftohtë, pastaj të ngrohtë. Nuk e kuptonte ç'është kjo. Vetëm kur u ndie një erë e keqe dhe në dysheme u pa një curril uji i verdhë, u bë e qartë çdo gjë. Culi dridhej si thupër.

O, trego për topat që i ke kërkuar përmes telefonit për ta kallë qytetin, o, i lë peng topet tua. Zgjedh!

Tek kur dëgjoi këto fjalë Culi sikur u çlirua, u shfry. Iu paraqitën para syve miqtë që i kishte në zyrë gjatë

kohës që mikut të tij ia kërkonte në shërbim dy topat e dritës për ta ndriçuar skenën e sallës. Duke tundur kokën e duke buzëqeshur, foli:

Të nderuar, Ju thash, është një keqkuptim.

Fill e për pe ua tregoi historinë e topave. Të tre mbetën të shtangur. Pas pak, të gjithë ia plasën gazit. Me siguri më ëmbël qeshi Culi meqë shpëtoi topet mos t'i bien kurban. Në kokë i ushtonte një fjalë e popullit, "ç'të bësh, ta bëjnë bile me kamatë".

PROMOVIMI

Ca shokë e miqë, ashtu siç e ndihmuan Colin për ta botuar librin e fundit, e bënë zemrën gur, ta organizojnë edhe promovimin e librit të tij. Donin që të mirën e bërë, ta çonin deri në fund. Mandej, ishin të bindur se libri e meritonte një nderim të këtillë. Coli fluturonte nga gëzimi. Kishte dhe arsye. Me pensionin që merrte, s'i mbulonte dot as shpenzimet e tabletave qetësuese. Por, ai ishte tip i çuditshëm. Kurrë nuk dinte të ankohej. Bile, e quanin optimist i sëmurë. Edhe në kasavetin më të madh, gjente forcë për të bërë humor. Kur e pyesnin se si ia dilte në krye në këtë krizë ekonomike dhe morale, që ka kapluar, me buzën në gaz përgjigjej si prej pushke:

Yyyyyyyyyy, shkëlqyeshëm! Të na rroj, ore, Qeveria. Nuk na lë keq. Për dyzet vite punë në arsim, kulturë, art e gjetiu, na shpërblen me 80 euro në muaj. Me to, ne arrimë të bëjmë pikën e sefasë. Hamë, pimë, vishemi, shkojmë në pushim, bile edhe kursejmë diçka".

Të gjithë qeshnim. E kuptonim. Edhe libri i tij është përplotë thumba të kësaj natyre. I vinte mirë që kishte krijuar mjaft lexues. Këtë e dëshmonin klikimet që i vinin përmes internetit. Kjo përkrahje sikur ia shtonte, siç shprehej, jetën që të angazhohet edhe më tepër. I kënaqi lexuesit dhe, më shumë veten. E vras kohën dhe nuk e ndjej pleqërinë, po, njëkohësisht, vendosi një gur, sado të vogël, në murin që hovshëm ngritet nga të rinjtë tanë në lëmin e letrave tona. Por, t'i kthehemi promovimit.

Atë ditë, salla ishte mbushur përplotë dashamirë të librit, sa nuk kishte vend të lirë. Colit, i lëvizte mustaku i hollë në shenjë gëzimi. Njëkohësisht, përbrenda ndjente edhe një tremë të pashpjegueshme, me një dozë frike se: "a thua, vallë, e arsyetoj këtë nderim?" U këndellë vetëm atëherë, kur fjala iu dha recensentit të librit, i cili, e vlerësoi lart kontributin e tij. Mjeshtërisht edhe me guxim, tha në vazhdim recensenti, autori i librit, vë në bisht të lahutës dukuritë e shumta negative që vërshojnë në përditshmërinë tonë. Me vargjet e tija satirike, ai, njëkohësisht zigëlon dhe thumbon kryekokat, pushtetarët, prijësit e verbër e sharllatanë, servilët, hajdutët, mjekët e paaftë dhe profesorët si prodhues të diplomave, mjekët dhe avokatët që me fëlçi të forta janë shndërruar në rrjepës të shkëlqyeshëm të popullit… Për çudi të të gjithëve, të cilët ishin koncentuar me tërë qenien e tyre në fjalët e njeriut profesionist, që përpiqej ta ndriçoj vlerën e librit, nga fundi i sallës u dëgjua një zë i vrazhdë dhe kërcënues.

Vafsh në dreq ti dhe autori i librit! Kush hamamin është ai të tallet me alamet emra, me autoritet e qytetit tone?!

Në sallë, për një çast, heshtje varri. Si me teledirigjues, kokat e të pranishëmve u drejtuan në drejtim të zërit të çakorduar. Kjo, nuk kishte ndodhur gjer më tash në manifestime të këtilla. Coli, ishte bërë katran në fytyrë. Edhe recensenti, ndonëse njihet si pa qime në gjuhë, iu mbyll e shkreta gojë. Jo nga frika, por nga befasia.

Hapu tokë të hy i gjallë! - pëshpëriti mes dhëmbëve autori i librit. Nuk i vinte aq keq për vete sa për dashamirët dhe përkahësit e tij që i futi në siklet. Kur shikimet u drejtuan nga recensenti, që po përgatitej të vazhdonte fjalën e tij, para mikrofonit të foltores u dukën

dy djemë të pashëm e buzagas. I pari mikrofonit iu afrua flokëkaçureli:

"Dikur kisha nder e itibar
Dridhej katundi kur rrugës kaloja,
Kush guxonte para t'më dalë
Te çika Llazë, duarlidhur e çoja".

I dyti, një djalosh i hajthëm, por zëkthjelltë, me sytë drejtuar tek këndi i sallës prej nga erdhi pak më parë reagimi:

"Zgjebën s'e do askush, zgjebarakët përditë shtohen
Gjithandej zënë vend n'kabinete plotë rehati,
Sa më shumë kruhen, lartë më lartë ngjiten
Jeta n'kurriz t'popullit, ju krijon kënaqësi".

Salla jehoi nga duartrokitjet. Ndërkohë, recensentit, sikur i erdhi shpirti. Ishte ndihma më e mirë që mund t'ia ofronin dy ish nxënësit e tij, tash studentë të aktrimit. Ndërkaq, u hetua se nga salla, ngutshëm largohej njeriu që e lëshoi fjalën si lopa bajgën, bashkë me ca shokë. Recensenti, foli shkurt:

Ata, që e kishin mizën nën kapuç, ata që e gjetën veten në vargjet e librit, me bishtin nën shalë, tretën,e lëshuan sallën.

Në allë, saora u kthye disponimi. Përurimi i librit rrodhi edhe më mirë se ç'parashihej.

Buzëqeshte Coli nga gëzimi, ndërsa ndjente se tërë trupin e kishte të larë në djersë.

HAJMALIA

Cuci, s'është rehat. I ka humbur qetësia. Bën si pula pa krye. Nuk zë vend kund. Cigaret nga sikleti nuk i pin, por i ha. Flet vetmeveti. Bën me këmbë e bën me kokë. Askujt nuk i hapet. Përbrenda zien. Askush s'e di çka e brenë. Është natyrë e çuditshme. Pa një pa dy, pasi i bëri disa minuta ulur, brofi si ta kishte pickuar gjarpëri. E hudhi jaknen krahëve dhe u nis dikah. Këmbët e çuan drejtë shtëpie të një lagjeje në skaj të qytetit. Kur arriti, trokiti në derë. Pas pak, me një kërcëllimë, që ia kujtoi djalërinë, dera e madhe e oborrit u hap.

- Uaaa, shihe, shihe kush më paska ardhur!

- Baba hoxhë, bre - u dëgjua zëri i dridhshëm i Cucit. - A të kujtohet sa duatë përmenç i mësova?

- Yyyy, si bilbili ma kishe zërin.

- Mbase disa, baba hoxhë, i kam harruar, ama, nja dy jo.

- Cilët ashtu?

- Duatë mos me të kafshua qeni dhe gjarpëri.

Për një çast heshtën. Ia kishin daltuar njëri-tjetrit sytë dhe secili priste atë ta thyej.

Baba hoxhë, vërtet kam pasur rast të ndeshem me gjarpërinj e qen, kam kaluar si më mirë.

Evlad, më duket se diçka të mundon. Çlirohu, mos e mbaj rëndë në shpirt!

Besa, ia qëllove. Erdha të kërkoj derman prej teje.

Qoftë me hajr e, ishalla kam mundësi.

Kur na i mësove duatë e qenit dhe të gjarpërit, e a ekziston duaja kundër kafshimit nga njeriu?

Tybistikfa, bir, luaj vendit se ke rënë në ograk!

Jo, baba hoxhë, jo. Ograku mua nuk më zë.

Ku ke parë, i nderuar, njeriu të kafshoj?

Yyyy, të kafshon, që ç'ke me të, bile më zi se qeni e gjarpëri!

Luaj vendit, mos fol qyfyre!

Kur të kafshon qeni dhe gjarpëri, asgjë e jashtëzakonshme. Të japin serum a ndonjë ilaç tjetër dhe kalon. Kur të kafshon njeriu, dhe atë përditë, s'ka bar që e kalon.

Bjer shahadet, evlat, se qenke çuar në krah të majtë!

Jo, baba hoxhë, mendjen top e kam. Dal në treg, më kafshon tregtari, mos të them, matrapazi. Në komunë, pa u kruajtur nuk sos punë. Te mjeku, fjalët mjaltë këndej të rrjepë. Në shkollë, profesorët bidatet e tyre, në…

Pse m'i thua të gjitha këto?

Paj, baba hoxhë, të lutem, gjeje një dua kundër kafshimit nga njerëzit e na shpëto se mbaruam krejt.

Hoxha u zu ngushtë, mbeti si pa gojë. Cuci, ofshani njëherë dhe ndjeu se u çlirua nga një barrë e rëndë. Iku pa përshënedetje.

KRYEKOKA

Demokracia apo sallamadia, siç preferojnë disa ta quajnë, na solli shumë gjëra të mira, ama edhe të këqija. Të mirat janë të shumta. Ja, bie fjala, ke liri pa kufi, bile dhe të vuash. Thuaj çka të duash dhe mos të të hajë palla se mund të japësh përgjegjësi. Fjalët më nuk konsiderohen delikte. Ku ka më mirë. Kur të duash shfryhesh dhe lirohesh nga sikleti. Sidomos na përgjigjet neve që merremi me gazetari. Përpara, në ish sistem, ishim shndërruar në robotë. E kishim të kufizuar fushëveprimin tonë. Edhe të doje të gabosh, nuk të linin. Punimi yt kalonte nëpër disa sita. Fundi dihej. Ashtu si e donte interesi i politikës ditore. Pas çlirimit të vendit, ndonëse në moshë, i hyra zanatit të vjetër. Me kënaqësi shkruaja për shumë tema. Erdhi në shprehje ligji i kompensimit. Isha pa qime në gjuhë. Problemeve u qasesha ashtu siç e shihte diopria ime. Shumë lexues nisën të më përshëndesin, të më përgëzojnë për guximin. Unë fryhesha e fryhesha. Më dukej vetja një analist i formuar. Një ditë më polli. Kërkova takim për bisedë me një nga kryekokat tona. Mrekulli. Më priti si është më së miri në kabinetin e tij të mobiluar me shije dhe në vazhdimësi kundërmonte nga aroma e këndshme e livantos së shtrenjtë. Në kokë, se ç'më tingëllonin vargjet e një epigrami, kushtuar bashkëbiseduesit tim "Nga lufta doli krejt skelet, kishte hequr t'zitë e ullirit, si u ulë n'fotele, u këndellë krejt, për hatër t'vatanit e t'flamurit". Duke

pritur kafetë, mbyllja në çast sytë dhe përpara shihja njeriun në dy figura. I pari, për gjynah, 40 kile me gjithë krevat, i zbehtë si xhenaze dhe, të dytin, i veshur shik sipas modës, i larë e i lyer, pëlcet nga shëndeti. Doja ta zë fillin e bisedës, po e kisha vështirë. Sytë i hapa kur dëgjova zërin e ëmbël të sekretares, e cila na solli kafetë dhe lëngjet.

Ju bëftë mirë! - na tha dhe doli.

Unë - i them kryekokës - bisedën do ta nisja nga emri dhe mbiemri juaj, është me interes.

Është dhe s'është. Emri është emër…

Tamam. Ama, që thoni ju, deri më tash, Ju keni qenë pa emër, nuk ju ka njohur njeri. Pra, prej askush, jeni bërë dikush. Para lexuesve shpërthyet si vullkan.

Fjalët e fundit sikur ia nxitën buzëqeshjen. U drejtua, mori qëndrim prej kryekoke dhe foli:

Paj, ju gazetarët jeni ca të çuditshëm. Shpesh kërkoni çka s'duhet. Ani, ani, nuk mërzitem fare. Ja, vërtet, isha kërkushi, por s'jam bërë rastësisht dikushi, mos të them gjithëkushi. Unë jam ai që plumbave të armikut ua tregova gjoksin, pa më bërë syri bef. Ani se nga ndonjëherë, për qëllime strategjike, hynim edhe në birë të minit nga frika. Nëpër borë, shi e fërfëllëzë, pa ngrënë e pa pirë, të veshur dobët e pa armatim të nevojshëm, u bëmë ballë të gjithave. Dhe ja, sot, pa ferrë në këmbë, më ke përpara.

Ju lumtë! - i them.- A mund ta tërhiqni një paralele në mes të djeshmes e të sotmes.

Si mendoi pak, duke shëtitur me sy nëpër skajet e kabinetit për të lënë përshtypjen e njeriut të urtë, sikur ofshani dhe foli:

Mua, në këtë vend më solli e djeshmja. Është shpërblimi më i çmueshëm. E dini pse? Pse vjen nga populli. Më deshi dhe më besoi dje, më do e më beson edhe sot.

Shumë e vërtetë! - ia pohoj fjalët. - Po, Ju, e arrini të jeni mirënjohës, dua të them, a e arsyetoni besimin ndaj tij?

Fjalë është kjo,a? Unë jam kurban i tyre e ata të mijtë. Ja, bie fjala, shumë prej atyre që ma besuan votën, si e qysh, kjo s'është puna ime, përpiqem t'ua kthej.

Si, në ç'mënyrë?

Me punësime. Bile, me autobusë i marr nëpër fshatra, për t'i sjellë në kryeqytet. E mira me të mirë kthehet.

Këtu më erdhi si në shtek ta provokoj ca. I bindur se do ta gjallëroja bisedën.

Nuk pushojnë përfoljet se pjesa dërrmuese e të punësuarëve janë farefis Juaji, nipa, mbesa, dajallarë, xhaxhallarë, kunetër…

Fjalët e hallkut - baltat e sokakut. Bie shiu dhe i lanë, bie dielli e i thane… - ma kthen ca me nervozizëm.

Nuk kanë kurrfarë kualifikimi, thuhet.

Bre, bre, sipas përfolësve, ky na qenka kriter kryesor, a? Pse, unë e shumë shokë të mi, erdhëm me diploma? Nuk i patëm, tash i kemi. Me hapjen e universiteteve private, sa çel e mëshel sytë, jo që u bëmë me fakultet, por fituam edhe tituj magjistër, doktor e besa s'mungojnë apetitet as për anëtarë Akademie.

Shkollimi, nuk bëhet brenda natës. Do kohë e hap pas hapi.

Shihe ti, shihe! Ke dyshime në titujt tanë, a? Po i futë hundër edhe në sekretet tona personale, a? Turp të kesh! Ty dikush të ka dërguar, ke ardhur me mision të caktuar! – nisi të çirret me të madhe.

Dale, dale! - desha ta zbus e t'i them se më keqkuptoi. Kot. Ai mori edhe më tepër flakë.

Ta lëshosh kabinetin allaminut! Haram të qoftë kafeja dhe lëngu i portokallit!

Nuk më mundësoi më tepër të bëj as gëk, as mëk. Ma tregoi derën. E gjithë kjo të vej në dreq. Tagri ishte i rëndë. U mbyllën dyert e gazetave me të cilat bashkëpunoja. Demokraci se jo mahi.

GOJA HAM, SHPINA BAM

I shkreti Lan. Sa shumë u gëzua kur shkëndijat e demokracisë depërtuan edhe tek ne. Në ish sistemin kuqalosh, kishte hequr të zitë e ullirit. Shpirti i tij prej rebeli s'mund të rrinte qetë kur përpara syve ndodhnin mutsihane të shumta, siç shprehej para shokëve. Kishte dëgjuar, ngapak edhe lexuar, se për fjalë goje më s'ka dënim. Sidomos kur s'e thua të vërtetën. Punën e bënte punë, aty kush nuk ia kalon dot, është ca si zevzek. Dëshiron të përzihet si shkop kaçamaku. I fut hundët ku duhet e ku s'duhet. Nuk e ka me sherr. Qëllimet i ka të pastra, por, ja se shpesh keqkuptohet. Kishte dalë te parku i qytetit dhe i ulur në këndin e një bange, pufiste cigare me të madhe. Ishte shenjë se diçka me të s'është në rregull.

- Tatjeta! - e përshëndes.
- Tatjeta dhe ty! - ma kthen.
- Si je, si vete?
- Mos pyet, për lezete.
- Ishalla e ke me gjithë mend.
- Bile me stërmend.
- Hajde, Lano, hajde…
- Ke dashninë me kajde.
- Çy, çy, edhe po këndon!
- Pse, a nuk m'beson?
- Paj, si të them, para ca ditësh më bëre zeher, nga goja villje vetëm helm e vrer.

- Dje ishte dje, sot është ditë e re.

Sjelljet e çuditshme, për një çast, ma mbyllën gojën. Nuk kuptoja ç'po ngjet. Sytë i shkëlqenin si gaca të gjalla duke i shetitur gjithkah. E ndjeja se ka një shqetësim dhe doja t'ia zbusja, ama…

Mirë the… - mora guximin të flas - … dita e re, nafaka e re. Me siguri të paska shkrepur ndonjë gëzim. Mbase ka ndodhur ndonjë punësim.

Punësim i sat ëme! A hajgare me mua bën?!

Dale, ore, dale! Ti më habite fare!

I di Meta punët e veta.

Yyyy, ç'njeri je! Njëherë vaj, vaj, tash haj, haj, s'të kuptoj dot, fole dje drejt apo sot?

Herën e fundit që u takuam dhe si shokë biseduam, si përherë, nuk u përmbajta, shkretova, shava e kritikova dhe shtrenjtë e pagova.

Uaaa, mos dyshon se unë kam lojtur bisht dhe ma bën me gisht?! Tash, vëllaçko, jemi në demokraci, fol shlirshëm, s'ka kufi.

Kështu edhe unë kam menduar, keq jam gabuar. Sistemi ka ndryshuar, njerëzit pak, interesat i bashkojnë t'hanë në një çanak, kush ua turbullon ujin, e këpusin dajak.

Të dëgjosh e mos t'besosh. A mund të ndodhë edhe sot kjo? Tek tash Lanit ia shoh njërin sy. E ka si të nxirë. Vërtet i paska pjellë ndonjë e papritur. Nuk u durova pa e pyetur.

Hiq, asgjë. Goja ham, shpina bam.

Nuk të kuptoj fare.

Aq më mirë. Nuk do të sulmojë kush, puna s'të rrezikohet. Bile, nëse lavdëron, siç bëjnë shumica, edhe të përparojnë. Mbase, nëse ke fëmijë të papunësuar edhe atë ta mundësojnë.

Të vërtetën për Lanin e mësova prej të tjerëve. Lani si Lani, në një mbledhje, kishte shkretuar për ca aktivistë

partiakë, pa e kursyer as liderin besa. Thonë se me argumente ua kishte nxjerrë shumë të palara për lendinë. Nuk e kishin mundësuar të arrijë as deri te shtëpia, e kishin lënë shtrirë në tokë.

Të gjitha gazetat nesër shkruan se sulmues të panjohur e kanë lënduar rëndë punëtorin e dalluar Lan. Policia bën çmos për t'i zbuluar sulmuesit.

UJI I TASIT

Ishte ulur Çuli në skaj të restorantit tek tavolina ku zakonisht rrinin të rinjtë. Më kuptoni, ata që ende flasin me sy, pra të rinjtë që e hapin trasenë e jetës së re, dashurisë. Kjo më habiti shumë. Ju ofrova. Ai, as që ktheu kokën. Ishte i tëri i humbur. Dhe, e pranoj, mbase bëra dhe mëkat. Mendja më shkoi gjetkë. Thash, burrë plak, mbase ka lënë ndonjë takim e, ajo s'i ka ardhur.

O, Çuli, tatjeta!

As që e ktheu kokën. Sytë i kishte gozhduar në një cep të perdes, ku açik shihej një njollë e madhe. Sikur e studionte atë, apo shprehte keqardhje që një alamet lokali me famë e lejon këtë. Nuk u durova. E kapa për supi dhe e trënda mirë.

O, Çuli, ku në djall ke humbur! Nuk u bë nami. Nëse nuk të ka ardhur ende, nuk do të thotë se u bë kiameti!

Ooo, tatjeta! Kush s'ka ardhur, për kë e ke fjalën?

Paj, si të them, mendoj…

Sa për të menduar, ti vetëm mbrapësht di t'mendosh. Imagjinata jote përherë ka qenë mo zot më keq.

Je ulur në tavolinën ku…

Vafsh në dreq! Ti ke lindur vetëm për të shkretuar! Unë jam në siklet, kam hall! Ti ke mendjen e axhamiut.

Mirë de, një mahi e vogël, Pa hë, ç'të ka pjellë?

E kam nënën e sëmurë.

Aiii, punë e madhe. Mjekët pse janë?

I kemi, i kemi. Bile i kam sjellë edhe në shtëpi. E kanë kontrolluar si është më mirë. Ilaçe e ilaçe më kanë dhënë. Kot.

Më shumë, nuk foli. Shtrëngonte grushtat dhe tundte kokën në shenjë nervozizmi.

Ore, ti vërtet sikur fsheh diçka?!

Mos qofsh në lëkurën time.

Ne, jemi miq, nëse ke nevojë për ndihmë, vetëm hape gojën. Mandej edhe të njohur kemi me bollëk, ku të duash e dërgojmë nënën tënde.

Pse, mendon se e lë keq unë, a? Po nuk kam lënë derë pa hapur, analizë pa bërë… Ajo nuk qetësohet se nuk qetësohet. Më plasi koka, thotë me gjëmime të rënda.

Si ndejtëm ca çaste pa ndërruar fjalë, Çuli shpërtheu.

E di, lum vëllai, ç'më ka bërë vaki?

Jo, ma thuaj.

Do ta them se kam nevojë dikujt t'ia qes të keqen që më është mbledhur brenda në shpirt si shllungë leshi.

Hë, de, shkrepe!

Ti je si ajo shosha pa fund dhe…

Do ta mbylli, do ta mbylli të shkretën.

Çuli dallohej ndër shokë si fjalëpak, që kundërshtonte përherë besimet e kota, siç shprehej, në bestytnitë e trashëguara nga të huajt. Ishte i bindur se vetëm në shkencë është shpëtimi i njerëzimit.

E di ç'më ka bërë sot vaki? - foli Çuli.

Me të mbara, shpresoj.

Të mbara se jo mahi. Me kërkesë të nënës isha në fshatin e saj të lindjes.

Ani de, mirë ke bërë.

E di pse? Trokita te një derë ku më doli një grua plakë, mbase si nëna ime. Sipas porosisë, ia tregova edhe

dertin. I tregova se ilaçet nëna i ka pirë po koka nuk i pushon se nuk i pushon.

Ani?

Fisnikja, pa një pa dy, si ma ofroi një shkam për t'u ulur, prej një rafti e mori një tas nga bakri. Unë e përcillja me kujdes. Ajo vrap e te kroni. Si e mbushi me ujë, e futi me një kavanoz dhe mu afrua.

I bëj nënës të fala dhe si ta pijë këtë ujë, ia jep selametit.

Po, ti, ç'i the?

Hiq. Bishtin nën shalë, me kavanozin që më dukej se rëndonte një ton, i bërë qull nga djersët e sikletit, vrap e në shtëpi. Nëna as që arriti të më falenderohet, e kollofiti gjysmën e kavanozit me ujë. E vështroja dhe pritja reagimet e saja. Bobooo, nuk kaluan as pesë minuta. Nënës i shkuan buzët në gaz. Po, po. U çua në këmbë dhe më përqafoi.

Të lumshin këmbët, bir, më shpëtove! – më tha ajo.

Të lutem, më thuaj më qartë, ç'është historia e këtij uji?

Më thuaj të të them, i thonë kësaj. Ujë i rëndomtë kroni. Ama, prej tasit të bakërt, i shkruar me shkonja arabe, me shkronja të kuranit, siç nëna ime beson se janë shkronja të Zotit.

Uaaa!

Uaaaa bëra dhe unë. Por, që thua ti, u pajtova. Ia pash hajrin. Shpëtova nga mjekët, nga ilaçet. Çdo të tretën ditë, e mbushi me ujë kavanozin por jo te plaka në fshat, po te kroni i parë dhe nëna, bilbil në këmbë.

Nga besimi i fortë, çka nuk bën vaki.

MËNGJESI I MAJMË

Kohëve të fundit, si shpesh më rastis ta takoj xha Malon. Gjithmonë buzagaz duke më bërë temena deri në tokë. Në fillim, aq më bënte. Por mirësjellja e tij, nisi të kalojë çdo kufi. Një ditë, kishte trokitur në derë dhe kishte lënë një shportë ve të katundit bashkë me porosinë: "Për sokolin e xhaxhit". Një herë tjetër, kishte sjellë djath, pemë e perime.

- Kësaj pune, s'i vie erë e mirë - i them nënës.

- Uuuu, uuu, të keqen nëna, ç'thua! Si ta mban fytyra t'i biesh shkelm të mirës!

- Nënë, e mirë me bisht më duket…

- Pësttt, mos t'na dëgjojë njeri se bëhemi gaz i botës!

Desha s'desha, mbylla të shkretën.

Një pasdite, me të kthyer nga puna, ja, në shtëpi e gjeta xha Malon. Nëna e kishte ndalur në drekë. Yh, sa puthjet e përqafimet që m'i fali duke ma rrahur shpinën. Parandjeva se ardhja e tij e ka bishtin prapa. Rrija si në ferra. Vetëm pritja kur do të dalë kopili për mejdani.

E, më,të pastë xha Mala! – foli, ende pa e gëlltitur kafshatën e fundit. Po, si ju vejnë punët, juve të hyqmit.

Paj, herë mirë, herë me telashe.

E po, helbete. Njerëzit ua kanë nevojën. E, hallexhinjtë, nganjëherë, dijnë të bëhen të mërzitshëm si mizat.

Ashtu është, ashtu është, ju përgjigja butë, i kënaqur për konstatimin që dha.

Shyqyr që i kemi njerëzit tanë - vazhdoi pa çarë kokën fort që sytë më mbylleshin nga lodhja. - Den baba den, në shpirt e kemi pasur ndjenjën për ta ndihmuar të afërmin. Në të mirë e në të keq. Besa, as kokën s'e kemi kursyer. Ah, si s'është gjallë i ndjeri yt at, ndjesë pastë, se krejt suratin e tij e ke, të të tregojë me gojën e vet se si njëherë e një kohë, ishte luftë, vlonte, desh u vrava për të me disa, që si thonë një fjale, hekur hanin me dhëmbë.

Foli e foli, ku hyri e ku doli, duke i pohuar fjalët e veta. Nënë shkreta ishte shndërruar në sy e vesh, duke dëgjuar për ndodhitë në të kaluarën. Unë, zieja përbrenda. Sa mblidhja fuqi për t'i thënë "hë, bjeri trup, ço gjuhën ku të dhemb dhëmbi!", droja se do lëndoja nënën. Vazhdova edhe më tej të duroja.

Ti, pëllumbi i xhaxhit, e njeh mirë Xhelon, të birin e Memo mullisit?

Si jo,në një klasë kemi qenë.

Ashtu, të paça!... Edhe punoni së bashku?

Po.

Nesër, do t'ju vizitoj. Do të dalim së bashku në kafjall. Unë paguaj.

Ti paguan?!... Tu rritë nderi! Gjithmonë bujar ke qenë! - fjalët e fundit i thash si me romuze - por, s'bën!

Aaaa, tash ma prishe qejfin! Yyyy, të rrebtit e të shkeptit u kam paguar mëngjese, dreka e darka, e jo ty e Xhelos, krenarisë së fshatit tonë.

Më shumë s'e zgjati. U çua dhe si rrufeja u zhduk në rrugën për në fshat. Mua më mbeti ta pres ditën e re, befasinë e re. Po. Që në të gdhirë, xha Malua, para meje,më priste. I buzëqesha me zor. Tok me të e në zyrë. E pimë edhe kafenë e mëngjesit, pas së cilës më mbuloi me urata. Unë, për të mos humbur kohë, e pyeta:

Hë, më thuaj, ç'e mirë të solli kaq herët këtu?

Hiq… Asgjë… Mendoj, asgjë e madhe.

Atëherë, ç'është ai hall i vogël?

Do më ndihmosh?!

Vetëm urdhëro. Po të jetë e mundur nuk do të kursehem.

Ashtu, më rrofsh!... Jotja është, t'ma sjellësh në mëngjes djalin e Memo mullisit.

Vetëm kaq?

Paj, si të them… kur të flas me të, bën mirë t'ua mbash anën fjalëve të mia.

Patjetër, patjetër! - ia prita pa e vrarë mëndjen për fjalët e tia nga droja se ishte koha kur shefi bënte kontrollin nëpër zyra.

Ora nëntë. Unë, Xhelua dhe ai, së bashku. Instiktivisht, shkonim pas tij, si dhentë pas ogiçit. Sa çelë e mëshelë sytë, u gjendëm në një qebaptore. Ende pa zënë vend mirë, si ajo përralla "sofër shtrohu", tavolina u mbush përplotë me pjata me mish viçi të pjekur, mëlçi, mushkëri, tru, salsiçe, sallata, kos dhensh e lëngje. Është ëndërr a zhgjëndër? Xha Maloja, fërkonte duart i tëri shend e verë. Fshehtas, ma luajti syrin.

Hë, ju bëftë mirë!

Donim s'donim,me tërë qenjen u angazhuam për të shqyer çdo gjë që na ishte servuar në pjatë. Oreksi ynë, si duket, e gëzonte xha Malon. Mua, kur më shkonte ndërmend biseda e bërë, sikur më lidhej nyje kafshata në fyt. Le të bëhet ç'ka të bëhet, i thoja vetes.

Eh, ju pastë xhaxhi! - foli dikur. - Sa shumë ju kam gjendur prindërve tuaj. Ama, ja. Sillet e sillet, të kthehet.

Aaaa, s'ka dyshim - e përkraha.

Bile nganjëherë detyrohesh të qesish pushkë për mikun. Sot kjo bëhet me një fjalë goje, me një firmë në letër. Ja, kam dëgjuar se djali i Memo mullisit, demek Xhelua (sytë i mbante nga ai), na qenka kryetar i komisionit për konkurse, e ti (mu drejtua mua) anëtar. A ka më mirë? Preni e herrni si të doni. E, për kend? Për njeriun tuaj. Për nipçen tim, çarkaloz djalë.

Kafshata e fundit Xheluas iu bë se e gëlltiti një boç gështenje me ferra. Po, torruan s'e humbi dot. Në stilin e tij të njohur, foli:

Punë që s'bëhet.

Dale, dale se ju të rinjtë e sotit jeni të ngutshëm. Ama, si thonë të moçmit, copën e madhe haje, fjalën e madhe mos e fol!

Ç'e do se. Xhelua, si Xhelua. Nisi e koptisi:

Turp të kesh! Derrin noksan e ke te shtëpia, këndej, shtiresh si i ngratë, për gjynah!

Lëri, lëri fjalët! S'është nipçeja im, as i pari, as i mbrami! Jemi a s'jemi tanët? – u mundua t'na bindë.

Për këtu, s'jemi fare.

More, i biri i Memos, thuajmë ç'të duash, le të kuptojnë të gjithë se sa i drejtë e parimor je, ama rixhanë ta kam, puna të soset.

More, dhëmbi të të dalë, ja, njëkaq (duke treguar gishtin e gjatë), kjo punë s'bëhet. T'i lëmë kërkesat e atyre që i plotësojnë kushtet e, ta pranojmë nipçen tënd, jo, jo, hiq...!

Xha Malua na i zgurdulloi sytë. Donte t'na përbinte me shikime. Sidomos mua që, s'e mbajta premtimin se do t'ia jepja anën. Dikur, brofi në këmbë, sikur ta kish pickuar bleta.

Ashtu, a?! Ashtu, a?!.... Shumë mirë, shumë mirë!... Atëherë, as unë s'kam para harram për të gjuajtur! Si i hëngrët, paguani!

Avulloi si t'mos ishte fare. Unë e Xhelua, mbetëm si të shtangur. Buzëqeshëm. E, në bark, zorrët na u përzien nga sikleti që duhej të paguanim mëngjesin e majmë, të paplanifikuar. Ishte fundi i muajit.

MEZEJA

Kishim rënë në hall me Lamen. Në ndejat javore, që i organizonim për ta lagur fytin me nga një pikë raki, që ishte i vetmi argëtim yni, me bashkëngjitjen e Lames, na katraleshej pak rendi. Asokohe, s'kishte kafiteri si sot, që mbijnë si kërpudhat pas shiut. Mungonin televizorët e të mos flasim për internet, që të ofron çdo gjë që shpirti të do. Pastaj, standardi i atëherëshëm dukshëm dallonte nga ky sot. Por, të kthehem te Lameja. E afruam. Na dukej goxha djalë. Ama, që thoni ju, i papërjetuar. Nuk dinte ç'është shoqëria, ç'është ndeja e rakia, ç'është qejfi. Me një fjalë, na e prishte terraqëllëkun. Do thoni: ç'bënte? Asgjë. Nga natyra është tepër i qetë e fjalëpak. Ashtu, pa të keq, posa e shtronim sofrën, servirnim mezenë, ende pa i cakruar gotat si duhet, Lameja ishte i gatshëm ta kollufiste një dash të pjekur. Pa bërë gëk as mëk, na lente me gisht në gojë. Dua të them, me disa lëvizje, fshinte çdo gjë përpara. Shikoheshim mes veti duke i rrudhur supet, pa guxuar nga turpi të reagojmë. Kjo na kushtonte. Detyroheshim të bëjmë teraqëllëk me ndonjë qepë a spec të mbetur. Lameja, si gogësinte nja dy-tre herë, mbështetej për minderi dhe shpesh niste gërhamën. Kur menduam se kjo po teprohet, u mblodhëm shokët kokë më kokë dhe mua më caktuan të bisedoj me Lamen. Të gjithë e dinin se isha më i afërt me të dhe më dëgjonte. Fundja, unë e inkuadrova në mesin tonë. E thënë, e bërë. Të nesërmen, në kohën e pushimit në punë, dolëm për të pirë nga një

kafe. U mata e u çmata se si t'ia zia vegzën bisedës. Duhej të kisha kujdes se dinte të jetë sedërmadh e kur merrte në thua, bëhej si i çartur. Prandaj, butë e me takt i them:

Lame, të paça, të kam a s'të kam shok?

Yyyy, mos e diskuto!

Ashtu pra. Ta dua e ma do të mirën.

Në e do nevoja, pushkë shkrepi për ty.

Jo, jo. Për pushkë s'do ketë nevojë, ama…

Hajt, hajt, jij më i qartë! Le të të shkojë gjuha ku të dhemb dhëmbi. E ndjej se ke një shqetësim.

E vërtetë, shumë e vërtetë. Do të them diçka, të më dëgjosh qetë dhe të më mirëkuptosh.

Hë, mor, ta lumsha, shkrepe se të dëgjoj!

Si të duken ndejat javore që i oërganizojmë?

Aaaa, pasha atë gëzim!

Shumë mirë. Ama, a të ka shkuar hiq mendja se sjelljet tua nuk puqen fortë me tonat?

Këtu, ma hupe si me kos, nuk të kuptoj.

Ja, si të them, kur e shtrojmë sofrën, serviren mezetë, e ato, sipas rendit, duhet të përcillen me raki. Kjo, na disponon, na çliron na pushon, na bën qejfli, na…

Bjeri, bjeri më shkurt!

Ti, s'kemi gjë kundër, të bëftë mirë, por pa e kërkuar asnjë pikë raki i kollofitë të tërat. Mezeja shkon, lum vëllai, me raki.

Me demek, unë ua prishkam rendin, a?

E bën pa dashje, pa të keq, ama, sikur na e shkurton muhabetin.

Si u mendua pak Lameja, duke e tundur kokën si kali teknefes ditëve me vapë, me një ton shumë të qetë, foli:

Pajtohem, ke të drejtë. Po, halli? Ç'duhet të bëj që të përmirësohem?

Asgjë të jashtëzakonshme, i nderuar. Të pishë dhe ti tri-katër gota raki sa për muhabet.

Lame është i kuptueshëm dhe i fjalës. Në ndejën e parë të radhës, kur u shtrua sofra, u mbushë përlotë të mira, nuk u ngutë si herave të tjera. Priti të mbushen gotat me raki. Mori pjesë edhe në cakrim, duke e pirë me fund. Na mati të gjithëve me sy, por u drejtua nga unë. E mori shishen me raki dhe:

Një - pështpëriti.

Mbushi të dytën, të tretën dhe të katërtën gotë dhe si të gëlltiste ujë e jo raki, i shterri me fund.

Hë, u bënë katër gota, a e mbusha normën?

Më shumë s'e zgjati. Ashtu i ulur këmbëkryq, sulmoi mezetë. Duart e tija vallëzonin nëpër pjatat e shtruara deri sa u ngi mirë. Këtë e dëshmonte me gogësimë.

Të gjithë qeshëm.

XUXI

Përrallat për Nasradin Hoxhën edhe sot janë aktuale. Së paku për gjeneratën time, që i kemi kaluar kaherë gjysëm shekulli jetë. Për të rinjtë, këto konsiderohen si hiçgjë, humbje kohe, sepse kanë mundësi të tjera për t'u zbavitur e për ta shijuar realitetin e jetës. Kësaj here, po ua përkujtoj ngjarjen që i kishte ndodhur Nasradinit me një bashkëfshatar. Të gjithë e njihnin atë si njeri dilinxhi, që i fuste hundët gjithëkah e gjithkund, sidomos të fuste në gjynah, kur vinte të të kërkonte diçka. Askush s'ia prishte dot. Erdhi radha të ketë punë edhe me Nasradinin. I trokiti një ditë në derë.

Urdhëro, i nderuar! - i kishte thënë.

Nasradin, kam një hall.

Fol, e mira.

Më nevojitet gomari yt të bie deri në shehër.

Gomarin?! Aaaa, të më falësh, s'e kam këtu.

Do ti, gomari si me porosi, lëshoi një ta pallur deri në kupë të qiellit. Bashkëfshatarit, i luajti buza në gaz që e zu atë në rrenë.

Po, kjo e pallur, a nuk erdhi nga shtalla jote, a?

Nasradini si Nasradini, aty për aty ia ktheu.

Po, nga shtalla ime vjen, po ti, i beson gomarit a mua?

Bashkëfshatari e kuptoi meselenë e Nasradinit dhe me bishtin nën shalë u largua.

Ngjashëm është puna edhe me shokun tonë, Xuxin. Thiun e ka mangut në shtëpi, ama, sillet si është më keq. Sytë i shkëlqejnë si të djallit. Kurrë si mban në një vend. I shetitë nëpër tavolinat e kaferestorantit, ku zakonisht mblidhemi. Pa kërkuar leje as falje, fuuup, ulet. Duhanin e pi, cigare nuk blenë. Shërbehet me ato që i gjenë mbi tavolinë. Bobobooo, ku ka të shtruar meze, nuri i qeshë. Turbo bën me duar prej pjatës në pjatë. Han për lezet. E ka edhe një të mirë. Nuk i lë keq as miqtë që i ka anësh. Është ky stil i veprimit të tij, për të mos rënë në sy si egoist. Bile, kush nuk e njeh, krijon bindjen se si është një bujar e xhentëlmen simpatik. Ç'të bënim ne? E kishim përditë. Çdo gjë tonën e konsideronte edhe të veten. I merr pa pyetur fare. Kohëve të fundit na u bë i mërzitshëm me telefonat celular. Si e shihte mbi tavolinë, ta fshinte.

Vetëm një minutë të lajmerohem në shtëpi, thoshte.

Minuta e tij na delte dardhë me bisht. Atë e diktonim në fund të muajit. Xuxi, në emër të shtëpisë, fliste me djemtë në shtetet e Perëndimit. Një ditë, më erdhi në maje të hundës. Duro e duro, turp sot e turp nesër, si nuk skuqet fare. Bile as një falenderim nuk të thotë. E diktova nga sytë se bëhej gati ta sulmonte celularin tim mbi tavolinë. E mora dhe e futa në xhep. Ai,e hetoi, ama, si e kroi kokën nga sikleti, s'u durua:

Të lutem, bën një minutë të shërbehem me celularin tënd?

Jo! - i përgjigjem shkurt.

Pse?

Pse nuk e kam.

Në atë çast cingëroi celulari im.

Hë, kjo cingërimë, nga vjen?

Nga xhepi im. Po ti, i beson cingërimës a mua?

Xuxi mbet i shtangur. Shoqëria ia plasi gazit. Pas pak, ndjeu djersitje kurrizit dhe ballit, që i shkëlqente,

ama, u përmbajt. Qeshi edhe ai duke e përkujtuar vakinë e Nasradin Hoxhës dhe gomarit.

Jo, nuk e lash me aq. Ia përplasa për fytyre ca të shara dhe pyetje.

Ti, Xux, a je rast social?

Jo, top i kam punët. Jetoj si veshka në dhjam. Punojnë djemtë, punon gruaja, shtëpi të mirë, veturë…

Me një fjalë, i ke krejt të mirat. Atëherë, ç'është ky pis ves yti, turr pas cigareve të huaja, pas mezesë e në fund edhe pas celularëve?

Në vend të pendimit apo edhe reagimit për t'u mbrojtur, duke e shndërruar çdo gjë në humor, foli.

E kam huj, de. Çdo gjë të huaj e dua më shumë se timen. Ne, derisa ziheshim përbrenda, Xuxi avulloi. Iu bashkua ndejës në një tavolinë ku ishte mbushur përplotë meze.

KËNGËTARI

Gimi është ndër këngëtarët me përvojë. Nuk ka ardhur prej rrugës, po ka të kryer shkollën e muzikës. Kur u paraqit në skenë, ishte befasia më e këndshme e qytetit. Vlerat, vlerat dhe vetëm vlerat ishin përcaktim i rrugës së tij prej artisti. Qoftë për muzikën, që e përgatiste vet, qoftë për tekstet e këngëve, që i siguronte prej poetëve më të dalluar. Kjo do t'i mundësojë të shndërrohet në yll duke fituar shumë shpërblime e mirënjohje. Po, ç'e do. Sheh dardha dardhën dhe piqet. Shumë shpejtë do të qesin kokë plotë këngëtarë të cilët, brenda natës, u bënë më të kërkuarit. Nuk kishte dasëm që bëhej pa ta. Do të jenë mysafirë të kërkuar në shtetet e Perëndimit. Në fillim, këngëtari ynë i nderuar, do t'i pranojë me përbuzje, do bëjë dhe do shkrime për çoroditjen e vlerave të vërteta të aritit muzikor. Kur kuptoi se e ka të kotë, heshti. Kaloi një kohë duke bërë si pula pa krye nga sikleti. Kur i erdhi shpirti te hunda, jo vetëm ndryshoi mënyrën e komponimit, nisi të këndojë këngë, sipas shijes së njerëzve pareli. Meqë kisha biseduar si gazetar me të në hovin e karrierës së tij, më erdhi në shteg ta zvilloj edhe këtë intervistë blic, meqë, ai kohën e ka ar dhe s'mund të shpenzojë në kotësira.

Tatjeta, zoti këngëtar!

Tatjeta dhe ty e mira!

Sipas disponimit, ka pasur verë të bereqetshme.

Mos pyet, kajmak.

Sa në Perëndim, sa në det.

Ngado sillem, punët sherbet.

As në dasma nuk ke munguar.

Patjetër, patjetër edhe ato i kam nderuar.

Tash, a bën ca të flasim për reportuar?

Pse, s'ke punë më të mençur mor qerrata djalë?

Paj, si të them, të mbaj në mend si këngëtar me vlerë, të vinim në koncertet tuaja e kishim për nder.

Ajo kohë, miko, ka perënduar, çdo gjë ka ndryshuar.

Për të mirë e për të keq?

Eu, po qenke gazetar dreq.

Shumë medalje e mirënjohje ke fituar, mos vallë i ke harruar?

T'i harroj jo, ama, ato vlera i mori era.

Tash e dhatë një vlerësim me vend.

Si shumë të tjerë edhe unë jam mbushur mend.

Njeriu është kurrizor, aq lehtë nuk dorëzohet.

I tilli e pëson keq, një ditë pendohet.

Kompozimet tua të dikurshme rrallë dëgjohen.

S'jam unë fajtor që nuk kërkohen.

Shkurt e trup, jeni pajtuar me këngët tallava.

Për ty, mbase tallava, për sojin e sorollopin tim, bakllava.

Heshtëm të dy. Në fytyrën time, hetoi buzëqeshjen cinike sidomos kur vërejti tundjen e kokës që ishte shenjë se edhe puna e tij ishte bërë hiq.

E di ku të dhemb, më dhemb edhe mua. Ku pështyhet, nuk lëpihet, thonë të moçmit. Ja se edhe kjo më ndodhi. Në fillim e ke të vështirë, pastaj bëhesh lëkurëtrashë e nuk ndjenë. Të dalin përpara fëmijët. Ata nuk kërkojnë vlera as patriotizëm, duan të jetojnë. Me rrogë të arsimtarit s'do isha në gjendje t'ua paguaj regjistrimin e vitit në fakultet. Këtë nuk mund ta zgjidhi as unë e asnjeri tjetër si individ, po institucionet.

Asnjë fjalë më shumë s'e tha. Ngadalë, si një bollë e vrarë, më la përshendetjen dhe iku. U zura ngushtë. Bisedën me këngëtarin e përjetova krejt ndryshe. Kurrë nuk e botova.

PËRVJETORI I MARTESËS

Ka kohë që Keli ka humbur si paraja e kuqe. Askund nuk duket. Kjo u ndie shpejtë në shoqëri. Lindën një varg dilemash e pyetjesh. Njëri thumbit tjetri patkoit. Për një ishim të sigurtë: asgjë e keqe nuk e ka gjetur. Ajo, në qytetin tonë menjëherë dëgjohet dhe bile e stërmadhëruar. Ne për ujkun, ujku te dera. Me flokë të shprishura e i paruar, si lugat qiti kokë Keli. Me hapa të rëndë e i mvrejtur, sikur ta kishte qiellin mbi supe, na përshëndeti me një të lëvizur dore dhe zuri vend në tavolinën më të skajshme të kafiterisë. Kamarieri, pa e pyetur, ia çoi një raki.

Herën tjetër një dopio – i tha kamarierit.

I afrohem dhe ulem përballë tij në tavolinë.

Hë, mos më ke rëndë në shoqëri? – e ngacmoj. Ai, as që ma kthen. - Ç'e mira të ka gjetur, ka kohë s'po bëhesh i gjallë fare.

Pse, s'të dukem i gjallë, a?

Mendoj, ndër burra, aty ku cakërohen gotat.

E kam cakëruar një natë, për ta mbajtur në mend gjatë.

Ai, si duket, e kishte pritur këtë çast provokimi që pastaj të hapet si hashashi, të shfryhet.

Ti, e di - më tha. - Para një jave u mbushën 30 vjetë të plota martese.

I bëfshi 100! - e uroj.

Dale, dale! - më ndërpretë. - 100 i bëfsh edhe ti bashkë me mua. Ama, ato duhet të jenë cilësore.

Mos t'ishin të tilla, s'kishin kaluar kaq shpejt tri dekada.

I nderuar, këtë përvjetor do ta mbajë gjatë në mend. Ime shoqe kishte thirrë të motrën me burrë e një shoqe tjetër e, hopa, kishte zjgedhur edhe restorantin goxha me renome, për ta shënuar këtë datë.

Uroj të keni kaluar mirë!

Mirë?! Auuu, fjalë është kjo? Më shumë se mirë! - foli me romuze.

Nuk të bie në fije, flet seriozisht, apo po luan bisht.

Merre si ta marrësh! Po e përsëris: këtë natë do ta mbaj mend gjatë.

Nuk të pëlqeu shoqëria, shërbimi, a…?

Të gjitha ishin në nivel. Ishte mbrëmje e mrekullueshme. Rakia më dukej sherbet e ëmbël. Aq shumë m'u hapën diznet sa s'kisha të ngirë.

Si duket, qenke bërë xurxull.

Më mirë thuaj tapë e kungull. Ama, prej asaj nate jam mbyllur në shtëpi sa një Zot e di kur kam me e pa veten atje përsëri.

Në pse-hun tim, nuk u përgjigj menjëherë. I daltoi sytë në një plasë të murit përballë, sa, një djall mund ta kuptonte nga fluturonte.

Vetëm kur i arriti gota e dytë, sikur u këndellë. Si trëndi ca kokën, me gotën para buzëve, si më mati mirë me sy, ia nisi:

Vëllaçko, kot s'kanë thënë, "sharti i parë i burrërisë është t'ia dish hallin vetit". Unë i shkreti, atë natë, pas dy-tri gotave, e humba toruan sa nuk di sa zullumin e kam bërë. Më kupton, kemi pirë pa karar.

Ani de, njëherë ndodhë ajo! - i jap zemër.

Lehtë për ty. Ama, që thua ti, ne ha e pi, kamarieri shkruaj. Në shtëpi u kthyem me kokat si buaj.

Fundi?

Shkuam si erdhëm. Të nesërmen, kur më doli pija, gjak mu bë shtëpia. Kur hapa kuletën të marr ndonjë lek për të blerë qumësht dhe artikuj të tjerë të domosdoshëm për fëmijët, ajo krejt bosh. Koka më rëndoi sa një kosh. E tërë rroga kishte avulluar në natën e 30-vjetorit të shënuar.

E çoi me fund gotën dhe, sikur ta kishte pickuar bleta, me hapa të shpejtë, humbi në lakun e rrugës. Para largimit, ma lëshoi një shikim të çuditshëm kërcënues e lutës, me të cilën kërkonte ta heshti këtë. Po, fjala që del prej goje, vështirë të fshihet. Edhe unë jam njeri që më krijon kënaqësi përfolja e rasteve të këtilla, por pa zarar. Historia e Kelit u bë gjatë hit ndër ndeja, duke i shtuar edhe një varg bishtash.

DHËMBI POLITIK

Ju lutem shumë. Hapni sytë dhe veni vesh mirë. Kam nderin t'ju tregoj një histori të çuditshme të një dhëmbi. Po, e dini se dhëmbët janë të nduarnduarta: dhëmbëbardhë, dhëmbëbrisk, dhëmbëçakall, dhëmbëçatall, dhëmbëkalë, dhëmbëkatarosh, dhëmbëkrimbur, dhëmbëqelibare e të tjera. Dhëmbët e personazhit tonë, bëjnë pjesë kudo. Janë të bardhë, të fortë e të zhdërvjellët. Këtë mund ta dëshmojnë qytetarët e qytetit T, të cilët, si njeri i popullit shpesh i ka vizituar. Meqë ka qëlluar tejet i begenisshëm, pa qibër, përmendet gjithmonë. Dua të them, ky i nderuar, me organizëm prej mercedesi që s'ka hoxhë që ia kalon në haje, ka ditur, më besoni, të kollofisë, pos sallatave të shumta pa luajtur vendit edhe një dash të tërë. Pa vënë pikë uji në gojë. Vetëm pinte çka të qëllonte, verë ose birë sa për ta freskuar gërklanin. Euuu, po ta shihnit sa bukur që gogësinte për t'u çliruar nga gazrat. Pastaj, të merrte zjarr. Mbante fjalime të atilla sa tërë të pranishmit shndërroheshin në sy e vesh. Nganjëherë, në besim, fliste edhe për gjëra tepër sekrete. Pra, asish që vetëm të hyqymetit duhet t'i dinë. Prandaj, pas çdo fjale të tij, që i forconte edhe më tepër me grimasat e fytyrës, qytetarët si mirënjohës që ishin, si në kor pëshpëritin: "të lumtë goja se na kënaqe". Po, nejse. Qëllimisht në vija të shkurtra ju njoftova me të zotin e dhëmbit të çuditshëm, të cilin tek tani do ta veçojmë nga të tjerët, meqë, jam thellësisht i

bindur, në çaste më të vështira hamletjane, ka ditur ta nxjerrë nga situata DD - në tanë. Inicialet në fjalë, s'janë inicialet e tij. Mos e kërkoni as në fjalor shkurtesën e tyre si Pr. - profesor , Mr. - magjistër, Dr. doktor etj. Kjo shkurtesë është biografia e tij. Pra, deri dje, delegat, sot deputet. Thënë edhe në troç, gjithherë, njeri i popullit. Eheee, sa ka bërë për këtë milet, që shpesh kur bëheshin dinsëza e imansëza, që do të thotë, kokëgunksha e të padëgjueshëm në përfilljen e urdhrave, t'hyqymetit, dilte taktit krejt sa shante me soj e sorollop. Ama, për të mirën tuaj e kam pasur përherë, arsyetohet edhe sot. Megjithatë, e lëmë punën e tij gjatë sistemit që perëndoi, he na i marrtë të ligat, ne do të ndalemi në ditët më të reja. Ky i uruar, si njeri me përvojë, e përvoja thonë është mësuesja më e mirë në jetë, të hidhet në aksion. Veç ta shihnit bre, ç'fëlçi të forta që kishte. Goja si pushonte bënte si çakall mulliri. Fliste për demokracinë sikur t'ishte ekspert i saj, duke krahasuar shpesh me sistemin e avulluar bolshevik, që ai e quante si të keqen më të madhe të njerëzimit. Goja t'bën vezir, goja t'bën rezil, na mëson një fjalë e moçme. Ky rezil, pardon ky njeri "i përvëluar" vite me radhë në poste të ndryshme të ish sistemit, delegatët e D-eputet ose shkurt D.D. S'është gjithkush. Kush është zoti, mos i shkoftë zi moti. Eh, ç'zë bilbili që ka ore! Që në seancat e para të Parlamentit të ri, si gjëmëtari më i mirë, i numëroi të gjitha të zezat që i janë bërë popullit tij më të vjetër dhe autokton në trojet e veta gjatë afro gjysmë shekulli. Populli s'e hiqte dot nga goja.

- Hëm, e shihni, gjithë atë kokë të madhe, s'e ka kot!

- Kuukuu, t'ua bëri tetë me dy!

- Daleni, daleni, mos të ngutemi, kundërshtonin ca të tjerë. Kali plak, mëz nuk bëhet.

- Dita e mirë shihet që në mëngjes, e mbronin (sidomos) bashkëfshatarët.

Me rëndësi, zoti DD, u bë njeriu më aktual në qytetin T.E. ai, ani pse deri dje, si udhëheqës komunal i kishte përbuzur (me qëllime strategjike) bashkëkombësit e tij, duke mos u folur në gjuhën e nënës, sot, falë buzëqeshjeve të ëmbla, përkulet para tyre, përshëndet me to. Bile, e kanë parë edhe në xhami.

Ditët kalonin në pritje ç'të re do t'na ofrojë demokracia e aq pritur. Filloi edhe ndryshimi i akteve më të larta shtetërore. Sytë i bënin katër në televizor qytetarët e shkretë, ish të diskriminuar. Ani pse në fotelet e buta të sallës së parlamentit gjendeshin edhe shumë prapanica deputetësh, ja se shumica pritnin, ta dëgjojnë zërin e DD-së. Po ç'e do. I gjori ynë, njeriu i popullit, nga nervoza e madhe ngase s'mund i duronte gjithë ato laperë që s'kishin asgjë me demokracinë e llomotitnin më zi se komunistët, ta kapte dhimbja e dhëmbit. Edhe atë, që thoni ju, ai i syrit, kështu shprehnin keqardhje shokët e tij, sa, merreni me mend, gati asnjëherë s'ka qëlluar në mesin e deputetëve, për t'i çuar dy gishtat e tij për të votuar për çështjet shumë të rëndësishme. U mblodhën disa stomatologë për t'i dhënë ndihmë. Demek, t'ia shërojnë dhëmbin ose t'ia nxjerrin.

- Punë që s'bëhet, thoshte DD.

- Do ta rregullojmë si është më së miri, ore.

- Jo dhe jo, ngulte këmbë. Ju, nuk e dini punën e dhëmbit tim.

Jo bën, jo s'bën, ca më këmbëngulës, propozuan besa ta zotërojnë me forcë për t'ia hequr atë dhëmb idiotik që në çaste vendimtare mend e kresë ia luan DD - së tonë. Stomatologët edhe njëherë u zotuan se do të jenë aq të kujdesshëm sa ai as që do të ndijë fare dhimbjen kur të punojë në gojën e tij. I tërë qyteti fliste për këtë ngjarje tejet me rëndësi. Pritnin shumë që si njeri i lyer gjatë në vaj në ish- sistemin, he i humbtë fara, për një herësh shtonin, ta hapë atë të shkretë çorape më, e t'i mbrojë

kërkesat tona të drejta. E thënë, e bërë. Një ditë e zunë pisk.

- Do të të lirojmë nga ai dhëmb - i thanë.

- Daleni, ore, daleni, mos u ngutni!

Kur pa se disa duar të fuqishme e mbërthyen dhe si lanë afat për të bërë gëk as mëk, përvajshëm i luti ta dëgjojnë t'u thotë dy-tri fjalë.

- Ju doni të më ndani nga dhëmbi im më i mirë.

- Dhëmbi yt më i mirë?!

- Po, të nderuar. Dhëmb që s'ia gjeni shokun dot. Dhëmb që sa herë jam zënë ngushtë më ka shpëtuar.

- O, ka lojtur ky nga fiqiri, o ne! -

- Dhëmbi im është i rrallë, është dhëmb politik.

- Heu, t'na e hupi me kos tash!

- Historia e tij, s'është e ditëve t'sotme. Edhe në kohën kur të shkonte karriera, pardon, koka, për dy fjalë goje, dua të them, për mos ngritjen e dy gishtave ndaj qëndrimeve nga "lart", shi ky dhëmb më shpëtonte. Aty për aty, humbisja si paraja e kuqe, derisa vendosej për çështjet në fjalë. Kështu, mbetesha mirë edhe me hyqymet, edhe me milet. Pse, ndryshe si do ta kaloja gjithë këtë kohë pa ferrë në këmbë?

- Bobooo, ç'na polli, ç'na dëgjuan veshët! - u dëgjuan zëre të përziera. "Ujku qimen ndërron, hujet jo" - shtoi tjetri.

- E gëzofshim dhëmbin politik, uroi më nevriku prej tyre. Edhe më mirë na e punoftë. Kur u mashtruam nga fjalët e ëmbla të këtij që ia dinim dhëmbë e dhëmballë, ç'mund të presim nga të tjerët?

Historia e dhëmbit politik të zotëri DD-së nga qyteti T, këtu nuk merr fund, por, deri në grumbullimin e shënimeve më të reja, po e ndërpresim, meqë ende ka shpresë se së paku në seancat e tjera të parlamentit, thonë se ka vendosur që t'i vejë në shërbim dhëmbët tjerë

jopolitik respektivisht, do t'i kundërvihet Ligjit diskriminues për nënshtetësinë.

(1992)

KACULI

Me të zbardhur mëngjesi, Kaculi bishtin ndër vegë e del nga shtëpia. Të jetë në punë, nuk është. Të jetë besimtar e shkon n'xhami, jo. Kjo po ndodh me të, sidomos pas vënies në fuqi të orës policore. Ç'është më keq, me askënd dy fjalë si ndërron. Është bërë hijerëndë. Besa cazë duket i lodhur e i dobësuar. Shokët u bënë merak. Ama, si tip naks që është, s'guxonte kollaj kush t'ia prekë plagën. Më i guximshmi doli Quli. Një ditë iu afrua.

- Diçka me ty s'është në rregull, i tha.

- Është e s'është, ia priti.

- Njerëz jemi e njëri tjetrit mund t'i ndihmojmë.

- Punë që s'bëhet.

- Hape gojën, do para, të japim, do...

Ah, ofshani Kaculi dhe sytë e kuqur iu mbushën tas me lot. Së paku ashtu iu duk Qulit.

- Mos t'ka gjetur diç e pa pritur? Luftë është kjo. Jemi mbyllur nëpër shtëpia si në guaca e çka s'bën vaki.

- Këtu, këtu e kam dhimbjën, shpërtheu Kaculi. Te mbyllja në shtëpi.

Nuk ia kisha ditur vlerën lirisë.

- Lirisë?!

- Lirisë pra, lirisë së qarkullimit.

- Dale burrë se nuk u bë kiameti. Kjo s'është bërë vetëm për ty.

- S'është bërë vetëm për mua, ama, që thua ti...Hajt, hajt se po e lëmë këtë punë.

- U kënaqëm me gratë, ngacmoi Quli.

- U kënaqshi të gjithë si unë, hë! foli me nervozizëm sa e gllabëroi me sy Qulin e pasherr.

- Nuk të thash asgjë të keqe, u arsyetua ai.

- Nuk më the, por mjafton, që m'i kujtove ato çaste.

- Këtu s'u durua më Kaculi.

U zbrazë i tëri.

- Lehtë e kanë ata të malit.

Lehtë e kanë forcat policore ushtarake: bam bam e fshehu. Po le t'i mbyllin në shtëpi si mua e t'ua lëshojë atë fisniken e time 80 kilogram. Le që kërkon e bën si çakalle mulliri, por tërë natën s'të lëshon nga prehri. Dhe përsëri e pakënaqur se e pakënaqur.

Foli dhe sa çel e mshel sytë iku. Vërtet ishte për keqardhje. Pas ca ditesh vullnetarisht me zor u lidh për shtëpie dhe ja, veç një shpirt i ka mbetur. I bijnë pantallonat të gjorit. Shpëtimin e kërkon në të zbardhurit e ditës.

(2001)

AH, KJO ORË POLICORE!

Demograf Culi kohëve të fundit nuk është i qetë. Shfleton e shfleton gazeta e libra nga fushëveprimtaria e tij, kërkon të mësojë më tepër nga shtetet e qytetëruara për mënyrën e zhvillimit të regjistrimit të popullatës, duke hulumtuar metodat e tyre dhe shpesh, ndien kënaqësi të papërshkruar kur gjen diçka të kapshme. Shënon dhe vetëm shënon. Zoti e di sa materialin që e ka grumbulluar. Sonte u takuam rastësisht dhe pa e pyetur fare, më tha.

- Mirë që u shty regjistrimi. Kemi kohë për t'u përgatitur.

- Edhe unë ashtu mendoj, por...

- Çka por?!

- Edhe pak të ishte shtyrë, do ishte loçkë.

- Mbase pjesërisht ke të drejtë. Vërtetë në Organet e Statistikës shqiptarët nuk janë të përfaqësuar fare dhe ka vend për brengosje. Ama, të lutem shumë, kësaj here regjistrimi do të mbikëqyret nga ndërkombëtarët.

Foli dhe buza i luajti në gaz. Ai kishte hëngër veten gjatë regjistrimit të kaluar nga që e shihte si shtrembërohet e vërteta, po askush se dëgjonte. Dhe zemërplasur, kur mbetej vet, i revoltuar, në kupë të qiellit bërtiste: "Ju mund t'i zhdukni në letrat e juaja, mund ta mashtroni botën po ata janë gjallë, janë ushtarë!...Villte pastaj helm e vrer për partitë politike duke i quajtur

bytheca që lejojnë të nëpërkëmbet numri i popullatës të cilës i takojnë.

Unë fjalën e kam gjetkë, i them ngadalë.

- Pa, hë, pa hë?!

- Unë shtyrjen e kërkoj për diç tjetër.

- Fol, de!

Nga shpallja e orës policore e këndej, kur vullnetarisht me zor duhet të mbyllemi në shtëpi, patjetër duhet t'i kryejmë ca detyra të harruara të shtëpisë.

- Për çfarë detyrash e ke fjalën? - pyeti i habitur demografi.

- Të flesh me gruan e të çosh dashuri.

- Bobooo, sa axhami që je! A di t'i të flasësh seriozisht?

- Zotëri, nëse shtyhet edhe pak koha e regjistrimit, së paku të bëhen nëntë muaj nga shpallja e orës policore, mund të ndryshojë çdo gjë.

- Çka mund të ndryshojë?

- Atë çka ti e do, të rritet numri i banorëve. Dua të them, atëherë do t'i shohim rezultatet e orës policore.- Auuu, po djalli vet je, ku të ka shkuar mendja! Po, ama dhe ke të drejtë. Mbare me thënë, mbase dhe bëhem horë para fëmijëve që janë rritur, rrëshqitëm edhe njëherë si thiu n'akull.

- Do të thuash?...

....Se me orën policore do ta fitoj edhe fëmijën e pestë.

Qeshëm të dy dhe duke tundur kokën, u ndamë të lehtësuar që njëri tjetrit i qajmë hallin.

(2001)

PAMPERSAT

I pari i sigurimit të shtetit, e bëri zemrën gur dhe vendosi t'i vizitojë disa pika të rëndësishme të pulenëve të tij, të cilët "heroikisht" luftojnë jo vetëm kundër armikut, po edhe me hijet, me fluturimin e zogjve, lehjen e qenve, me çdo gjë që guxon të lëvizë pranë tyre. Kjo vlerësohet si gatishmëri e hatashme ushtarake, meqë të luftosh kundër një armiku të padukshëm s'është dhe punë e vogël. Krismat si ndalnin dot. Sidomos kur terri i lëshonte krahët. Fare s'mërziten se e shqetësojnë qytetin. Janë të bindur se kryejnë punë të shenjtë e atdhetare.

Pak para se të afrohej kryepolici tek qendra policore, për çudi ju bë sikur ndjeu një erë të keqe. Kapi hundët me dorë e me zë të shterur pyeti truprojën:

- Ç'po ngjet këtu, ç'është kjo erë?

- Është erë gjaku ekselencë, mori përgjigjen.

- Erë gjaku?!

- Po, po, erë gjaku, nga plagët e "trimave" tanë, foli me romuze ai.

- Bobooo, sa çudi! I bëra gjithë këto vite e s'e paskam ditur se gjaku paska erën e pëgatësi!

- Janë të rinj, e helbete, ç'ka s'bën vaki.

- Dhe ashtu të "plagosur" s'e lëshojnë dot frontin?!

- Punë që s'bëhet. Janë a s'janë të zgjedhurit tu, pardon tanët?

Kur u gjend krejt pranë policisë "elite" ju duk se po ngulfatet, i shteret fryma. Nuk e kishte të qartë, ndodhej para policëve apo mumieve të gjalla.

Të pa rruar, të zbehtë e me sy të çakërdisur. Megjithatë për t'ua ruajtur moralin, mori guxim dhe si prej pushke foli:

- Ku jeni trima luftëtarë, eu!

Të gjithë policët morën pozitën gatitu duke e përshëndetur eprorin e lartë pa bërë gëk as mëk. E kuptoi pozitën e tyre të vështirë. Që t'i lirojë nga kjo barrë e rëndë ai e theu heshtjen përsëri.

- Çlirohuni e mos u mërzitni! Ju jeni të rinj. Edhe këto lloj "plagë" nganjëherë janë normale. Lufta kështu e ka.

Për të ikur sa më parë nga ajo duhmë e padurueshme që vinte nga "luftëtarët trima", thirri njërin nga përgjegjësit e ekipit dhe i tha.

- Urgjentisht për çdonjërin të blihen nga disa pampersa numra më të mëdha, për t'i mbrojtur sokolat nga më e keqja. Patjetër atyre t'u ofrohen kushte elementare luftarake. Me pampersa do të mbrohet shëndeti i tyre dhe ambienti.

Më shumë nuk e zgjati. Sa çel e mshel sytë avulloi. Por, s'ndihej dot i qetë. Sa i thoshte mendja se bëri punë të mençur me pampersat, i hyri droja se me to mund të rahatohen policët e t'i merr gjumi.

- Jo, jo ishalla!, u largua duke belbëzuar në heshtje.

(2001)

PETICIONI

Do ti, plasi lufta në qytetin T., me demek atje lart në male. Shumë burra me nder me thënë, me mustaqe vesh e m'vesh, me shpërthimin e granatave të para, i mbushën brekët. Mblodhën teshë e koteshë e bishtin ndër vegë, nga sytë këmbët. Sidomos do rrafagjoksa patriotë e do pisnismenë, pardon biznesmen ikën, në Shqipëri, Kosovë, Turqi, Evropë e qebesa kishte azgana që fluturuan edhe për Amerikë. Ama, kishte edhe të tillë që syri vërt s'u bëri. Për meshkujt u bë kiameti kur filloi ora policore. U bënë vet të katërdhjetit. Për çudi, kjo disa tepër i gëzoi. Po, po shumë gra duke bërë fësh fësh prej veshi në vesh, sikur u ringjallën. Pa një pa dy vendosën të shkruajnë një peticion. Dhe e shkruan. Sa çel e mshel sytë, lista e të nënshkruarave s'kishte fund. Ia drejtonin Qeverisë. E dini ç'kërkonin? Të zgjatet afati i orës policore. Bile, me propozim deri në pakufi. Kjo çështje u bë temë e nxehtë.

- Motër, u shkrina nga lezeti krejt, i thotë njëra së shoqes. Pas sa vitesh u ngina me erën e burrit.

- Qe besa, topi s'e luan. Mblidhet grusht në një qosh ai i imi, më shikon me sytë xixëllues dhe zgërdhihet në ethe nga tuta kur i afrohem. E kam terë të gjorin.

Njëra thumbit tjetra patkonit ama, ndonëse s'ishte krejt ashtu siç flisnin, kënaqësia më e madhe e tyre ishte që edhe burrat ta shohin çka do të thotë burgu shtëpiak. Kishte edhe muhabete të këtilla.

- Rezultatet e orës policore motra, tek do t'i shohim. Po, po edhe atë pas nëntë muajsh. Nuk punojnë as barnatoret e që thoni ju, s'ka asi sende, më kuptoni, kapuça de për mbrojtje...

- Bobooo, kuku për ne?!

Ofshani njëra.

- Ç'pate? - e pyetën si në kor.

- Telashe, gjithandej telashe.

- Për ç'telashe e ke fjalën?

- Për atë 9-muajshin tënd. Këta, tanët, shyqyr zotin, janë si mëzetër. Ama, nëse është në fuqi ligji që s'lejon më shumë se tre fëmijë na mori djalli.

- Uuuu, motra mirë e ka, kjo është punë me telashe?!

- Mos u frikoni fare, kërceu një tjetër si juriste që ishte. Ai ligj më nuk vlen.

- Uraaaa, brohoritën të gëzuara grupi i grave të mbledhura.

Peticioni pret përgjigjen e Qeverisë.

(2001)

S'KA MË BYTH VIÇI

Kryetari i Mak banane Republikës është duke u çmendur. Është bërë vet i katërdhjeti. S'ka gjumë as ditën as natën. E shqetëson çdo gjë. Si kërpudhat pas shiut kanë qitur krye shumë dinsëza e imansëza. Nga qengja të butë, të shkëlqyeshëm, menjëherë u bënë naks. Kryekëcyer që ç'ke me të, provoi me ledhatime e me premtime siç kishin vepruar paraardhësit e tij, kot. More jo vetëm që ua lyente buzët me mjaltë që të ëmbëlsohen, por u mundësoi të hanë koshere të tëra ama përsëri kot. Ç'është më keq, u tranuan mu ato që deri dje ishin dora e djathtë e tij. Po, po. Vetëm t'i dëgjosh. Janë shndërruar në patriotë të mëdhenj. Vrasin e presin, shajnë e kritikojnë çdo kënd që guxon të merr ndonjë hap antikombëtar.

Mendoi e çmendoi kryetari që për çudi e quanin Shaban dhe tha:

- Kur ke mashën mos i digj duart.

- Thirri kasapin personal furaxhiun e mëhallës që po ashtu e kishte anëtar të kabinetit dhe disa xhelatë që i mbante mirë si pëllumba dhe i urdhëroi:

- O keni me e bërë zap këtë pis milet që guxon shkelma të qet, o do veni tok me to në djall.

- Lepe e peqe ishin përgjigjur. Atë dhe e kishin pritur. Ka kohë që s'kishin ndier erë gjaku, sidomos të fëmijëve. Eu ta bënë, sa çel e mshel sytë, pordhë e piskamë. Flakë në katër anët. Rrënime djegie, shkatërrime.

- Kryetari shikonte me dylbi dhe zemra i bëhej mal.

- E more pis milet, more pis milet, kujtove se do ndahesh aq lehtë, a?

- Ç'e do, kur priste lajme të mira nga terreni, erdhën e i thanë.

- Bëmë e çka s'bëmë por keq u ndamë. Rebelet, i madhi kryetar, po vjellin zjarr, janë bërë kuçedra që s'dinë për tutë, ushtarët tanë trima gati të gjithë janë përmutur.

- Si i çartur, briti në kupë të qiellit: jashtë, jashtë të gjithë!

- Në vetmi nisi të kërkojë shpëtim nga kjo mutzihane, siç shprehej kur ishte filikat vet.

Mendoi e çmendoi dhe përsëri iu duke mençuri ta thërriste atë plakun e urtë të "pis miletit të rebeluar". I bëri muhabet, kur erdhi ai, si t'ishte zoti vet. U mundua ta bindë që të bëhet krahu i tij i djathtë, duke i premtuar fusha e male, vetëm ta përdorë autoritetin për ta qetësuar atë pjellë të mbrapshtë, po këtë s'guxoi ta shprehë.

- Kur e dëgjoi mirë e mirë urtaku kryetarin, si e fërkoi mjekrën e zbardhur, pa e zgjatur foli shkurt.

- S'ka më byth viçi kryetar.

- Ishte fjala e fundit që shpërtheu nga goja e tij. Kryetari mbet si i nemitur. Pa bërë gëk as mëk u ndanë. Thonë se janë angazhuar institucione të ndryshme për ta analizuar thënien e plakut të urtë që vazhdimisht e mbajnë nën thjerrëz.

(1998)

MINISTRI YNË LESHKO

Nëse një shtet do të jetë i suksesshëm, puna e parë që duhet bërë është të ketë kujdes se kënd do ta emërojë në postet më të ndjeshme. Ja, bie fjala, ta marrim ministrinë e punëve të jashtme. Hëm, ç'thoni? Mendoni se duhet vetëm shkolla për këtë? Jo, jo. Duhet të krijohen ca kritere plotësuese, bile të domosdoshme. Prej njeriut mumie ka kush vallë hajr? Do thoni, është i mençur. Punë e madhe. Duhet të kihet parasysh edhe dukja e jashtme. Nuk e them këtë rastësisht. Në shtetin tim, për një kohë të shkurtër u ndërruan disa. Pati dhe një femër. Dhe mirë që i patëm, erdhën e shkuan dhe mësuam se si duhet të jetë ai i ardhshmi. Nuk gabuam. Vërtet ky i fundit doli si prej naftalina, ama, ahaaa, ka fëlçi të forta. Merreni me mend, ka qenë udhëheqës në disa ndërmarrje punuese. Shumë, shumë i suksesshëm. Askund s'ndalej më tepër se 4-5 muaj. Në shpejtësi i grahte jarani i pites. Premtime gjithandej premtime bashkëpunëtorëve. Që thoni ju, sa çel e mshel sytë avullonte. Por tash, jo më koc e lëkurë, po si një dem për gulak. Dhe jo vetëm kaq. Edhe me do qindra mijëra (atëherë) marka gjermane. E shanin, shkruanin gazetat për "aftësitë" e tij ekonomike, ai nuk ndalej. Tash, si i thonë, në sistemin e ri sallamadi, pardon demokraci, është bërë si top llastiku. Eh, ta din si kërcen. Sa në këtë parti, fop në tjetrën. Ju pagua. Ëndrrën e bëri zhgjëndërr. U bë ministër i punëve të jashtme. Prej çasti që ai erdhi, shteti ia dha bregut. Arushan mashkull, bre. Me fytyrë

krejt leshko, dua të them me mjekër, ta futë tutën në palcë, lëvizë si drugëza. Tërë jetën po e çon nëpër avione. Dhe jo në çfarëdo. S'është i marrë ta përbuzë autoritetin e tij e sidomos të vendit. Në diplomaci vlerësohen lartë dhe këto detaje. Ama, kushton. Kushton de. Ç'kujtoni ju, ashtu hajt lehtë mbrohen dhe afirmohen kërkesat dhe të arriturat "demokratike" të shtetit? Mandej, ai nuk është mësuar të qëndrojë gjatë në një post. Duhet shfrytëzuar energjinë e tij të pashtershme. Ai është bërë mjeshtër i politikës, jep e merr. Mos marrtë për shtetin, qe besa për vete sa t'i dojë zogu i qejfit. Është talent i rrallë.

Është lehtë?! Do thoni: "Keq gaboheni, i pafytyrë, duhet të bëhesh tepër i pafytyrë". Me demek, aty për aty e trillon rrenën, e akuzon tjetrin, buzëqeshë kur duhet qarë qanë kur duhet buzëqeshur. Të gjithë këto duhet bërë pa u skuqur fare, duke i shikuar kundërshtarët në sy, sa ethet t'ua shtishë. Arushani ynë, ministri i punëve të jashtme të shtetit tonë me nam, edhe në Kombet e Bashkuara arrin të bëjë harakiri me pafytyrësinë e tij. Në moment i besojnë, kthehet si triumfues. Pastaj nisën mban ders, bile është dorëshlirë edhe në kërcënime, për do dinsëza e imansëza e kërkojnë të bëhen të barabartë me to. Ai është i përgatitur që me kryeluanin, i aftë për të shqyer të padëgjueshmit. Ka dhënë prova të forta për këtë. Me një fjalë, ministri ynë leshko ka aftësi gënjeshtrën ta shesë për të vërtetë. Ama, do thoni se një ditë ajo do të zbulohet. Puna e madhe. Ai më s'do të jetë në atë post.

(2000)

QENËRISHT

Ishte bërë burri i botës vetë i katërdhjeti. Turfullonte si kali gjatë vapës në verë. Sytë i kishte daltuar në një oborr fqiu dhe kërcëllonte dhëmbët, hove-hove duke kafshuar buzën. Atje tej, një qen, tok me ca fëmijë bënte ca kërcime atraktive.

- Hej, hej ç'je humbur ashtu e je bërë si i çartur? - i them mikut tim.

- Për një qen ma kthen.

- Për një qen?!

- Shi për atë që kërcen si dreq atje.

- Të vesh në djall ti dhe ai, e qortoj.

- Qen bukëpërmbysës. Fëmijët e sollën koc e lëkurë, mezi e mbanin këmbët. Me gjithë fukarallëkun tim, sa herë që për drekë kishim mish, ashtin qëllimisht se gryeja dhe lëpija mirë, për t'i lënë atij. E, ai, fët e fët te fqinji, që e pranoj, e ka jetën më të mirë. Po, a kthehet shpina aq e lehtë?

- Boboo, për ç'gjëra të kota bëhesh nervoz!

- Bile edhe të pëlcas, pak është. Njëditëza, kur iu afrova dhe desha ta kthej në shtëpi, ç'mi kërcëlliti dhëmbët sa ishte i gatshëm edhe të më sulmojë.

- Po, qeni, qen, i nderuar. Kafshë më. Ke qen të mirë e besnik, qen stani e gjuetie, ama ke dhe qen rruge. Punë e madhe. Ç'të bësh me një soj tjetër që qen s'është e, punon qençe, sillet qençe. Ky fare qenisti, mashtrohet me një

asht, ky imi, ia jep gishtin, ta ha dorën, ia jep dorën, të përpinë të tërin.

- More, do të më ngushëllosh, apo e ke me gjithë mend?

- Bile me stërmend.

- Pa hë, pa hë!

- Ç'të themi për njerëzit tanë që njerëz janë, po qenërisht jetojnë. Të kujtohet sa e sa punuam t'i sjellim nga fshati, duke iu dhënë bursa ose kredi për t'u shkolluar. Pa i punësuam. Pa u martuan. Pa u bënë me banesa e shtëpia - U motorizuan.

- Shyqyr, ore!

- Shyqyr bëfsh, po haram i kanë. Qeni që është qen, qeni i bariut, është në gjendje të kacafytet me ujkun e arushën për ta mbrojtur kopenë e dhenve, ky yni, posa e sheh ngushtë, harron kush është. Për një fotele të butë, për një nam të rrejshëm, për një grusht para, shkon e tjetërsohet.

- Mos po e tepron ca?

- Ku është ajo e mirë, po, disa nga këta babaxhanë "të ndershëm" na i ndërsejnë edhe më keq se qentë dhe shyqyr zotin që kanë mbetur pak se na kishin shkyer më zi se ai qeni yt.

Kështu e ka kur dikush vendos të jetojë qenërisht.

(1994)

OGRAKU

Kishin kaluar dy orë e më tepër që e kishin futur në zyrë. E kishin ulur në skaj të zyrës në një karrige të fortë dhe i kishin thënë të priste. Kohë pas kohe, defilonin ca fytyra të panjohura duke i falur buzëqeshje të çuditshme ose edhe i kërcitnin dhëmbët. Kjo s'i pëlqente.

- Do të më kenë përngjarë me dikë, mendoi. Unë, me kaçikun tim, jam shkrirë i tëri për t'i kryer me përpikëri të gjitha detyrat e besuara. Nuk besoj t'mi kenë harruar. Kam kryer edhe detyra krye në vete. Yh, ç'më është tharë fyti! S'bëj keq ta përdor telefonin e të kërkoj një kafe me ujë të gazuar. Sa e kapi receptorin e telefonit u hap dera. Brenda u futën tre burra.

- Hëm e zumë me pelë për dore!

- Ka dashur ta informojë shtabin e vet.

Nuk iu besonte veshëve. Pështyma iu tha në fyt. Por, mblodh forcë për të buzëqeshur.

- Qyre, qyre, edhe po zgërdhihet trimi!

- Tash ia tregojmë! Ia qesim tamlin e nënës!

- Hajgaret me një anë, foli. Fyti më është tharë për një kafe e ju...

- Pale, pale, i qenka tharë fyti për kafe.

- Bile edhe me ujë të thartë.

- Çfarë e pini Ju lutem?

- Sade.

- Lepe, menjëherë.

Sa çel e mshel sytë, brenda u futën dy njerëz në uniformë e me shkopinj gome në duar.

- Njeriu u shkrumbua për një kafe, ku jeni ju?!

Pa një, pa dy, burrat e botës u kapën për shkopinj.

- Hej, ç'bëni ore! Mos më merrni në qafë! Me keni ndërrua me ndonjë tjetër. Unë...unë, jam...Tybe treqind tybe, n'më kujtohet tash kush jam...Rixha ju kam, thirreni Gjokën, ai e di më mirë kush jam.

- Hë, ç'thua koleg, e dëgjon?

- Do të fitoj në kohë, kopuku!

- Jemi të gatshëm për kafe, folën njerëzit në uniformë dhe menjëherë pas saj, edhe për kovë me ujë të ftohtë.

- Hë, mor ju paça, po kafetë e këtilla dhe uji janë për armiq! Bile, që thoni ju, janë pak. Duhet që t'i lidhim, t'i deshim cullak dhe si dikur, me Gjokën, i shuanim cigaret në trupin e tyre. Për më të qëndrueshmit, kishte ilaç tjetër. Nëpërmjet gishtave u venim fishekë. Mandej, i shtrëngonim, i shtrëngonim sa nisnin e këndonin si bilbila. Eh, heee, sa kanë kaluar nëpër duart e mia!

- Jo, ne kemi metoda më të përsosura. Metoda që mund të t'i prishin të gjitha organet vitale, pa të lënë asnjë shenjë.

- Hallall, ju qoftë! Sojsuzët edhe e meritojnë këtë!

- Ky, dërdëllitka si tepër. Fillojmë me provat e metodat e reja, hë ç'thua?

- Ju lutem, për të parën herë foli i treti. Duhet t'i mundësojmë njeriut që të zgjedh. Mbase do të flasë.

- Po si nuk flas, ore! Do këndoj nëse duhet.

- Atëherë, fillo. Kush je, çka je, ç'ke punuar, për kënd ke punuar?

- Unë, jam ky që më shihni, prej thembrave deri n'tepe t'kresë, Tosun. Po, po, tosun ma thonë emrin. Shkolla s'më ka shkuar e herët nisa punën, fillimisht mallterbërës e më vonë edhe murator. E kisha të vështirë,

e pranoj. Ama, që kur, si prej qiellit zoti ma qiti Gjokën, ia dhashë bregut. U bëra, njeriu i parë me revole në fshat. Mandej, që thua ti, Gjoka më ndihmoj ta kryej edhe shkollën fillore. Më mësoj t'i fusja hundët kudo nëpër mbledhje, në shkollë, bashkësi lokale, komunë dhe flisja si papagall. Eh, sikur t'ishte Gjoka këtu e t'ju tregoj sa me nderë e kam kryer detyrën time. Sa arsimtarin, unë sebep e, diferencimi fop e fop, i pastroi. Mandej, edhe si delegat në komunë, krejt porositë e Gjokës i kam çuar në vend, ju betohem. Ku është ai Gjoka që s'paraqitet mu tash?

- Mirë. Ja, po të besojmë.

Edhe të më besoni, se...

- Kur unë flas, s'dua të më ndërhyjë kush se...

- Aaaa, të më falësh, jam ca kokëtrashë e, si të them, bëj bëj nganjëherë, si çakallë mulliri.

- Qe sa kohë, kontributi yt është zero. Asnjë lajm prej teje.

- Posi, të paça, ke plotësisht të drejtë. Por, të më besoni, s'jam aspak fajtor. Qafirët, kudo që shkoj, ngado që hyjë, e mbyllin gojën si me dry. Bile, kuku t'i dëgjoni sa fjalë të rënda që m'i lëshojnë. Por, unë, i duroj të gjitha.

- Demek? - pyeti i pari.

- Hiq, pa demek, njeriut i paska dalë boja.

- Bash, vallahi.

- Atëherë, s'na vyen gjë prej gjëje.

- Ç'të bëjmë?

- Të bëjmë?

- Të diferencohemi.

- Siiii, unë...e dini...

- Por, do të jemi të butë. Nuk e mbysim krejt. Duhet t'ia pastrojmë ca trurin, mos të dijë kush është, nga është e çka është...

Më tepër, s'u dëgjua asnjë fjalë. Si cung i prerë mali u shtri sa gjerë e gjatë. Pas daljes nga spitali, shihet

rrugëve të qytetit duke folur vetmevete dhe duke rrahur gjoks, unë jam zotëri diferencimi.

Në qytet pëshpëritet me të madhe se ka rënë në grackë të rëndë.

(1986)

MIKROBORGJEZI I ZYRËS SONË

Të moçmit thonë: "Mos t'hyftë vetja n'qejf", se vaj halli. Nis e i shpeshton takimet me pasqyrën. Merr poza të ndryshme, zgërdhihesh. Bëhesh serioz. Të duket se s'ka më të bukur se ti, se s'ka më të mençur se ti. Të afërmit, shokët, miqtë i sheh me sy tjetër. Ca të duken matufë, ca primitivë, ca të pakulturuar. Ndërron rrethin shoqëror. Bën si bën, veten e sheh në mes të njerëzve që kanë bërë emër, kanë tituj. Nis e i imiton. Ndryshon edhe stilin e të folurit. Fjalorin e pasuron me citate të njerëzve me emër. Pa hetuar, tjetërsohesh. I tillë, kohëve të fundit u bë edhe shoku i zyrës sonë, Banushi. Ndryshe, si t'i shpjegoj sjelljet e tij? Është bërë fjalëpak. Gjithmonë me do libra përpara. Lexon dhe vetëm tund kokën duke bërë grimasa të llojllojshme. Nejse, e drejtë e tij është të sillet si të dojë, ama pa e tepruar! Sot, hyri në zyrë, as që na përshëndeti.

- More, ç'ka ky njeri? - më pyeti kolegia. Mos është i sëmurë a i ka ngjarë gjë?

- Jo, jo, - iu përgjigja. Tërë kohën buzën e ka në gaz.

- Megjithatë, me të diçka nuk është në rregull.

- Mos e pyet, se t'kallzon vetë, i them.

Dhe vërtet, nuk shkoi shumë. Banushi erdhi në vete. Njëherë na mbuloi me shikime e pastaj i buzëqeshur, foli:

- Ah, po njeri i madh është ai!

- Kush?

- Për kë e ke fjalën?

- Për akademik profesor doktor Manush Bjeshkën, pendën më të mprehtë të mbarë historisë së letërsisë sonë, para figurës së të cilit dridhen si të kishin shtatë palë ethe shumë poetucë e shkarravitës të tjerë të letërsisë.

- Aaaa, këtë, as topi s'e luan ! Fshati që shihet, kallauz nuk do. Për këtë flasin veprat - pohova.

- Merreni me mend, nisi ai bisedën - u takuam sot e ma qiti një kafe. Bile, më lavdëroi për një punim të botuar disa ditë më parë.

- Ashtu, a? - pyeti kolegia.

- Kjo s'është punë e vogël-ndërhyra.

- A për këtë harrove të na përshëndesësh sot? - ngacmoi përsëri ajo.

- E po, e dini, na u përgjigj pa u skuqur fare, s'desha t'ia prish lezetin atij takimi për një kohë.

Në zyrë, plasi gazi sa ky gaz solli edhe shumë shokë të tjerë. Të gjithë donin të mësonin ç'kishim. Fundja, kaherë të keqen dhe gëzimin e ndajmë së bashku. Kjo, Banushin, që kishte pirë kafe me njeriun më të njohur të qytetit tonë, e nxori nga takti.

- Ç'ka këtu për t'u qeshur?!

Kolegia, pa një pa dy, si njeri pa qime në gojë ia priti:

- Kjo puna jote ma përkujton një anekdotë.

- Na trego, të lutem, na trego? - u dëgjuan disa zëra.

Meqë në administratë pjesë përbërëse e punës është edhe përfolja, rrëfimi i tregimeve apo anekdotave nga mungesa e punëve, kolegia as që priti më shumë lutje.

- Në kohën e sundimit turk në një fshat tonin, i kishte rënë rruga të kalonte një alamet begu. E takon një fshatar dhe në mënyrë urdhëruese dhe përbuzëse e urdhëron t'ia mbajë kalin duke e quajtur gomar. I shkreti fshatar, ishte shkrirë nga lezeti dhe një javë s'kishte bërë as gëk, as mëk me njeri. Kur dikur e kishin pyetur se ç'ka,

ai ishte përgjigjur shkurt: "S'dua t'ia prish lezetin bisedës me begun".

Nuk mbërrimë më për të qeshur. E tërë zyra ushtoi nga zëri i çartur: "e një varg epitete të tjera”. Prej, atëherë, shokun Banush e quajmë MIKROBORGJEZI I ZYRËS SONË.

(1986)

SHYQYR QË ISHA ËNDËRR

Bobooo, ç'kiamet! Një javë i shtrirë në shtrat. Ç'të shtrirë se. As më hahej, as më pihej. Pale, pale të më shihnit si u zbeha. Njëherë më vinte mysafire teze zjarrmia. T'ia fillonte nga majat e gishtërinjve, hopa hopa, t'më përfshinte të tërin. Kur ngjitej në kokë, kuku për mua! Më kaplonin ndjenja të çuditshme. Buzët më rëndonin si petulla të pagoditura. Nga sytë më bëhej se do shpërthejnë lumenj metali të shkrirë. Dhe, merreni me mend, në pikë të ditës, syhapur, shihja ëndrra gjithfarësh. Ama, dy si harroj dot.

U gjenda në një vend të çuditshëm! Ç'bukuri. Gjithandej gjelbërim. Lule, gurgullimë lumenjsh, cicërimë bilbilash, liqene, pallate...Po, mbi të gjithat, i rrethuar me vasha të bukura. Ah, sa dëshirova atë çast të jem mjeshtër i fjalës së bukur! Më morën. Sidomos njëra që konsiderohej si kryezana. Nga nuk më dërgoi. Çka nuk pashë. Më duhet të pranoj harrova çdo gjë, gruan, fëmijët, shtëpinë e vendlindjen.

Sa zgjaste kjo, s'e di, ama dikush nga të shtëpisë më zgjonte nga halucinacionet dhe kur hapja sytë, ç'zhgënjim. Shihja veten në dhomën time të vjetër. Shihja dritaret e pëlcitura e të ngjitura me aeroselotejp. Ja dhe ime grua e vyshkur përpara. Pa fëmijët. Aty për aty, s'doja të shoh asgjë. Përsëri mbyllja sytë. Dëshiroja t'ia kap fijen edhe njëherë ëndrrës. Dhe që thoni ju, me teze zjarrminë, ja edhe teto ethet. Më mbulojnë me jorgana, plafa e çka gjejnë. Vetëm dhëmbët që s'më bien për tokë nga

dridhmat. Ç'është edhe më keq përsëri një figurë femre më del përpara. Tmerr Flokëshprishur, hundëkërrabe, sygjar por që më afrohet, më gishtërinjtë e thatë e thonjgjatë. Me duar të zgjatura, duke u zgërdhirë, ia shosh dhëmbët e prishur e të dalë jashtë. Me zë Oh, forcë ku je? - them. S'më punon asnjë gjymtyrë e trupit. Ndihem si në pranga.

- Ti!

- Po, unë

- Flliqan!

- Jo...

- Flliqan! I pamoral!!...Ku ishe më parë?! Fluturoje, a?..Të pëlqente të fluturosh në krahët e tjetrës?!..Të pëlqenin gjelbërimi, uji i burimeve, pallatet..

- Dale...prit...

-Hesht!...Harrove gruan, fëmijët, shtëpinë...Edhe atë vetëm për kënaqësinë tënde personale..Dhe ti i thua vetes burrë, a? Jo, burrat si ti s'e kanë të gjatë!

- Aman, një fjalë!

- Fjalën s'e the ku dhe kur duhet lirë u shite.

- Po, çarja?

- Dënohesh me shfarosje!

- Të shfaroset fara e keqe, të shfaroset me rrënjë! - dëgjoja si në kor shumë zëra.

Dhashë e mora, kot. I tëri isha larë në djersë. U dorëzova. U pajtova me çdo gjë. Si duket, për një çast kisha harruar edhe frymë të marr. Kjo kishte bërë që në shtëpi të dëgjohet kukama. Mbushet shtëpia përplot me fqinj. Dhe ashtu, as të gjallë as të vdekur më dërgojnë në spital. Siç shihni edhe njëherë ia dhashë bregut shpëtova. Shyqyr që isha n’ëndërr.

(1988)

NOKAUTI

Që thoni ju, pas dy-tre muaj pa udhëheqës, dua të them pa drejtor, ani pse mungesa e tij s'u ndie fare, dhe punët venin edhe më mbarë, kolektivi ynë fitoi të zotin e shtëpisë. E, sa herë që ndërrohen eprorët rreth tij, si zgjua bletësh bëjnë një kategori punonjësish. Yyy sa buzëqeshje, sa komplimente. Gjë normale, në këtë valle më duhej të inkuadrohem edhe unë. Vrava e ç'vrava mendjen, përpilova disa plane, ncuk. Asnjëra s'më garonte përfitimin e simpatisë së drejtorit të ri. Jo pse s'kam rroba të reja, po jam ca tutkun nga goja e, mund të pengohem në rrugë të drejtë. Provova të shkruaj edhe një letër me ca informacione interesante, por jo. Ndërrova mendjen. E kam shkrimin si këmbë laraskash e...Po halli!!! - pyesja veten. Dikur, ja, më lindi ideja e re. Telefoni. Po, po. Vendosa ta thërrisja drejtorin në telefon. Do t'i thosha se e kam një selam nga djali i motrës që jetonte në një qytezë e të cilin e njoha rastësisht në një dasmë. E dini sa t'ia kap fijen. Tutje, vete si tëlyen. Menjëherë do t'i tregoja se jam Lameja i urtë e i dëgjueshëm. Se jam i gatshëm për t'u sakrifikuar për drejtorin nëse duhet edhe jashtë orarit të punës. Mandej, do t'ia afroja një cigare Dunhill pa kursyer as fjalët lavdëruese për të.

Në fillim, çdo gjë shkoi sipas planit. Bile, më ftoi edhe në kafe. Isha i bindur se ia dhashë bregut. Mezi e prita atë çast të dëshiruar.

Minuta më bëhej e gjatë. Sidomos atëherë kur u gjenda te sekretaresha e tij. I veshur e rregulluar si kikirik. I lyer me livandë franceze. Me çantë speciale si të diplomatit. I armatosur me fjalët më të bukura që dhe shkëmbin e përvetësojnë. Shkurt, i gatshëm t'i ngjitem si rriqër. Fundja, në këtë drejtim kam përvojë nga e kaluara.

- Ju shok, ç'pritni? - dëgjova zërin e butë të sekretareshës.

- Unë?!.. O, po...Më falni...Për te drejtori.

Fisnikja, sipas adetit hyri te drejtori të më paraqiste. Mua filloi të më dridhej zemra si zogu në grusht. Herë bëhesha vetë i dyzeti, herë më luante buza në gaz. Prit e prit, ajo kurrqysh nuk dilte. Pranoj, mendja më shkoi gjetkë. Bukuria ua zhdaravite mendtë goxha burrave. Por, jo, jo, qortova veten s'bën të mendoj kështu. Ama hë de, shko e rri i qetë? Diç si magnet më tërhiqte vrima e çelësit në derë. Helbete, thashë, të shoh ç'ngjet brenda. Ende pa u afruar mirë, kuku për mua! Më polli. Sa çel e mshel sytë, turinjve ndjeva një direk të fortë. Në pikë të ditës numëroja yjet në qiell! Hunda all e kuqe m'u rëndua. Po, toruan, ende s'e kisha humbur. Gjendesha vetëm në nokdaun.

- Hyn! - dëgjova zërin e butë.

Ashtu, instinktivisht, lejova që këmbët të më shpie nga zyra e drejtorit. Qëndroja para tij si hu gardhi, pa bërë gëk as mëk.

- Hë, ç'do, kush ishe ti? - Jam...Unë jam. Kush dreqin jam?!...Dorën s'e largoja dot nga hunda që më bëhej se është bërë si një balonë që çdo çast do më binte për tokë. Mblodha forcë për t'u këndellur.

- Unë jam. Unë jam..ai i telefonit.

Telefonit?!

- Dua të them, jam Lameja.

- More, një Lame e njoh pak më parë ishte këtu, po.

- Jam, Lame Kaculi...Si të them, i urtë, i dëgjueshëm. Jam, jam...e dini!...

- Uaaaa, tash e di! Ti je gjithkund e gjithçka, pos punëtor sa duhet. Të gjitha m'i kanë thënë.

Fjalët e fundit mu ngulën si turjelë në zemër. "Të gjitha m'i kanë thënë". Sigurisht. Unë bëj plane, të tjerët. Uh! U humba i tëri. Pas nokdaunit, ja edhe nokauti i përjetuar. Yh, yh sa rëndë qenka! Ku ta dish. Mbase nga ky pësim marr mësim.

(1986)

PUSHIMI NË MËNYRË VETËQEVERISËSE

Si ia filloi të nxehtit, mori hov edhe biseda nëpër zyra. Temë qendrore, dihet, ku dhe si do t'i kalojmë pushimet verore. Disa vërtet e kanë me gjithë mend, meqë punët i kanë në terezi. Ama ka edhe asish, që për pushimet flasin me afsh ama për e shtetet e huaja, detin, liqenin e shohin vetëm nëpër librat turistike. Kjo, deri vonë, ishte dukuri e femrave. Kohëve të fundit qe besa, as meshkujt s'mbesin prapa. Ja, edhe mua, posa e piva kafenë e mëngjesit, në restorantin e pensionistëve pa një pa dy më pyeti një ish shok imi:

Hë, nga do të shkoni kismet për pushime?

Ende s'kemi vendosur.

Ju, ende s'jeni marrë vesh në kolektiv kur do të shkoni? - Jo. Te ne në pushim shkon secili kur t'i teket. Bile, mund të shfrytëzohet edhe në disa pjesë. Por, në shtëpi s'jemi përcaktuar ende.

- Yyyy, ç'dëgjova! Je a s'je ti zoti i shtëpisë?

- Topi s'e luan. Ama, ne jemi familje përparimtare. Kaherë i kemi tejkaluar ca sjellje të vjetra e primitive kur njëri vendosë për gjithçka.

- Demek?

- Në shtëpinë tonë, pushimin e organizojmë në mënyrë demokratike dhe vetëqeverisëse.

- Dakord, dakord, Ç'janë pra rezultatet?

- Kurrfare.

- Uaaa! Si ore ashtu?

- Gruaja, propozon që pushimet t'i kalojmë në Turqi. Atje, pos që lahemi, shihemi me akraba, mbase bëjmë dhe ca tregti. Vajza, kërkon të shkojmë në bregdetin tonë. Djali ka lidhur qykë të shkojmë në liqe se në liqe.

- E ti?

- Unë, propozoj të shkojmë në fshat!

Ish shoku im ishte shndërruar në sy e veshë. Priste të vazhdoj bisedën, kur hetoi se këtë s'do ta bëja s'u durua.

- Ti, nuk më the se ç'do të bëni me pushimet?

- Pa harmonizimin e mendimeve pushim s'ka.

- Megjithatë, fjalën e fundit duhet ta thuash ti.

- Punë që s'bëhet! Të prishem me gruan s'ma qet. As fëmijët s'dua të më keqkuptojnë. Mandej, vëllaçko, kjo mua më shkon për shtat. Të gjithë mendojnë vetëm ku dhe si t'i kalojnë pushimet! E, mua më duhet të mendoj ku e sa para të gjej nëse shkojmë në pushim dhe si t'i kthej ato.

U ndamë me ish shokun duke i falur njëri-tjetrit nga një buzëqeshje. E, çka fshihej në buzëqeshje as vetë s'dinim ta shpjegojmë.

(1986)

PUTHADORI

Kishim dalë për të thithur ca ajër të pastër gjatë pushimit të mëngjesit. Flisnim edhe për hallet që e preokupojnë kolektivin tonë. Sidomos s'na linte të qetë rënia e standardit. Kjo kishte bërë që bonat për shujtë të ngrohtë t'i shfrytëzonim për idare të shtëpisë. Kështu, shpesh në vend se në menzë të punëtorëve, kënaqeshim duke zënë vend nën hije të blirit. Sot, për çudi, kisha sharruar në heshtje. Në fjalët e shokëve, vetëm pohoja me lëvizje koke. Por, Banushi si Banushi, kur do të të tregojë diç interesante, do t'ia ngulësh sytë drejt në gojë. Andaj, kur hetoi se s'isha me mend atypari, më shkundi fort për krahu:

- A e sheh?

- Cilin?

- Atë atje

- Selimin a?

- Po, Puthadorin

- Të lutem, mos më torturo? Bjerri trup ku e ke fjalën?

Njëherë heshti. E thithi një tym duhani. Dhe si e shkeli duçin e cigares, si çakalle mulliri nisi e koptisi pa pikë e presje kund.

- Vëllaçko, sa ishte Selimi, ishte ndër punëtorët tanë më të mirë. Ia kishin zilinë.

Sa mirënjohje e dhurata! Ama, shpejt u bë kungull e u var në gardh. Dua të them, si më të mirë, e propozuan

nëpër organizatat e ndryshme shoqërore-politike dhe vetëqeverisëse. Në fillim, qengj i butë. Pinte kafe e lëngje dhe heshte. Njëherë, dy tre... Nisi ti hapet goja. T'iu forcuan nofullat. S'kishte mbledhje ku s'e merrte fjalën. Çdo fjalim e fillonte me DUHET...dhe numëronte një varg çështjesh.

- Të të forcohen nofullat, këtu nuk shoh asgjë të keqe - ndërhyra papandehur.

- Atij, lum vëllai, iu forcuan nofullat ama, e lëshoi takati në punë. U bë alergjik ndaj punës. S'e duronte dot zhurmën e makinës, erën e vajrave të derdhur. Pluhuri i hekurit ia çonte kollën.

- Dhe?

- Ndërroi profesionin.

- Prej axhustator me kualifikim të lartë u bë...

- Puthador. U bë orator me nam. Por, jo më, duhet kjo e kjo. Si tha shoku drejtor...Si tha shoku shef...Si tha shoku nga kuvendi i komunës.. Kështu ia dha bregut. Lamtumirë makina, hekura, pluhur e zhurmë. Prapanica e tij u struk në fotele të butë dhe s'ka forcë që e ndanë nga to.

Kur hetova se ai sa më shumë që fliste bëhej all në fytyrë nga një nervozë e pakuptueshme sa kishte harruar se duhej të jemi pranë makinave, i fola me të butë:

- Kësaj i thonë të hash bukën tënde, të mbash gajlen e tjetrit. Ne duhet të punojmë, të tjerët të na vlerësojnë.

- Mbase ke të drejtë. Po, s'më duket e drejtë që nga punëtorët e mirë të krijojmë puthadorë. Të fjalës edhe ashtu kemi me tepricë, ama s'bën aty të zëmë vend ne që jemi kalitur në punë!

(1980)

NJË LIGJERATË E ÇUDITSHME

Kohëve të fundit, në kolektivin tonë punët s'vejnë mbarë. Hallakamë që ç'ke me të. Mbledhje pas mbledhje, takim pas takimi. Njëri thumbit, tjetri patkoit. Shkopi magjik s'u gjet. Dikush propozoi që të ftohet ndonjë njeri i pendës e i fjalës nga jashtë e të mbajë një ligjëratë. Askush s'e kundërshtoi. Të gjithë shpresonim në efektet e mundshme. Prandaj, atë ditë e pritëm me padurim. Salla u mbush ding. Në krye të vendit pranë foltores, kishin zënë vend ajka e kolektivit e në mesin e tyre një çapaçull, mustaqehollë. Nga buzëqeshjet që i falte tërë kohën, sa në të majtë e sa në të djathtë s'na e mbushte dot syrin të jetë njeriu, fjalët e të cilit mund të ndikojnë në ndryshimin e situatës në kolektiv. Ama, durimin s'e humbëm.

Kryesuesi ende pa e prezantuar mysafirin, tërhoqi vërejtjen që të mbanin vesh e t'i hapnim sytë mirë. Se, vazhdoi ai, si i thonë një fjale, njëherë vjen vera nga dera. Ligjëratë të këtillë zor të keni dëgjuar.

Nga këto fjalë, mysafiri çapaçul, u kollitë cazë duke nxjerrë dhembët e mëdhenj e të rrallë dhe si kacagjel, zuri vend para foltores. Pasi na mati me sy për një kohë të gjithëve pa një pa dy, nisi:

- Shoqe dhe shokë, punonjës të nderuar e vetëmohues që dini djersën ta derdhni ditë e natë, pa pushuar për t'i përmbushur të gjitha detyrat e parashtruara për të kontribuar sa më tepër. Më njoftuan se, keni vështirësi të shumta objektive dhe subjektive. Por,

morali i punëtorit, duhet të jetë i fortë. Nuk bën edhe aq të brengoseni. Nuk jeni as të parët, as të fundit. Bile, kjo është bërë modë. E dihet, modën duhet ndjekë.

Në sallë jehuan duartrokitje. U dëgjuan edhe do pëshpëritje. "Eu ç'na dha zemër!" Ligjëruesi këtë e shfrytëzoi për të pirë një gllënkë ujë e për të marrë pozë edhe më serioze.

- Fajtor për të gjitha të këqijat, e dini kush është? - pyeti - Joooo - u përgjigj si në kor tërë salla.

- Ja, ku po ju them koka. Koka me K të madhe. Prandaj sot do të ndalem, shi në këtë temë për ta shkoqitur në hollësi. Kjo më besoni, do t'ju ndihmojë t'i zgjidhni shumë dilema.

- Koka, ç'është koka? Ja, duke e konkretizuar me duar, është pjesë e sipërme e trupit që nga qafa e lartë, selia e truve apo centrali i njeriut dhe i shumicës së shqisave. Ashtu. E shoh se më përcillni dhe më kuptoni. Është pra, kafka e mbuluar me flokë...Por, si hetoi tullacen e djersitur të drejtorit pranë, shtoi - Mund të jetë edhe pa flokë.

Kjo s'ka shumë rëndësi. Kokat, në të parë, janë të njëjta. Ashtu edhe është. Ani se do janë më të mëdha, e do më të vogla. E, ç'i bën të dallojnë prej njëri-tjetrit? Ta sqarojmë së bashku. Në popull ju ka rënë të dëgjoni. Kokëfortë, kokëtrashë, kokëkërcyell, kokëderr, kokëmushkë e shumë lloje kokash të tjera. Ç'fshihet në domethënien e tyre? Ja disa shpjegime. Kokëtul, thuhet për njeriun që është i trashë nga mendja.

Kësaj i përshtaten edhe kokëkungull, kokëmish etj. Kokëderr, thuhet për njeriun kokëfortë, që s'do t'ja dijë kujt, njësoj si kokëshkëmb që punon me krye të vet.

- More, ku po e qet ky? Dërdëllis e dërdëllis e për punën tonë asnjë fjalë! - u dëgjua një nga fundi i sallës.

- Neve është duke na plasur kaptina prej halleve të grumbulluara e ky, koka pa koka! - foli një tjetër.

- Jarani i pites na flet për kokat e harron se në mesin tonë ka edhe asish që s'e kanë fare! - thumboi një i tretë.

E t'plasi zhurma në sallë. Filluan bisedat vesh më vesh! Çapaçuli priste të kthehet qetësia. Vazhdonte me buzëqeshje. Kot, intervenoi edhe kryesuesi. S'bëri punë. Atëherë, ligjëruesi lëshoi një zë të çuditshëm sa në sallë në moment heshtën të gjithë.

- Ja, a po bindeni? - foli ai. - koka, koka është ajo që e ka sjellë kolektivin tuaj në këtë gjendje të mjerueshme. Nuk mjaftohet vetëm të punohet. Puna që bëhet pa kokë është pa fryt. Duhet të tuboheni kokë më kokë dhe t'i shtroni të gjitha problemet e grumbulluara si duhet.

Këtu sa koka ka aq edhe mendime. Kur t'i shtohet edhe thënia e një shokut nga salla se në mesin tuaj paska edhe asish që s'kanë fare kokë, atëherë, ligjërata ime, e as e kërkujt tjetër s'mund ta nxjerrë kolektivin nga balta ku jeni zhytur.

Fjalët e fundit i tha si me nervozizëm por, vazhdimisht buzagaz dhe pasi i mblodhi letrat përpara sa çel e mshel sytë avulloi. Mbetëm me gishta në gojë duke shikuar njëri-tjetrin.

- More, na u duk se e nisi dallash, ama, mirë e pati.

- Gjithmonë e lëshojmë fjalën pa e vënë gishtin në kokë.

U shkapërderdhëm, në heshtje. Ndonëse ligjërata nuk mbaroi, intimisht s'e di pse më mban shpresa se edhe e tillë si ishte, do të jetë e efektshme.

(1986)

AH, MË DOGJE!

Sa njerëz, aq huje. Të mirë e të këqij. Dhe, kjo është shumë mirë. Edhe njëra, edhe tjetra, të bëhet bajat kur zgjasin shumë. Ja, deri para pak kohe, drejtor patëm një njeri në moshë. Te ne e pati kolltukun e fundit të karrierës prej udhëheqësi. Shkoi në pension, i qoftë udha e mbarë. Asgjë të re nuk solli. Ama, as nuk turbulloi. Në reparte, punët s'ishin kurrfarë. Për t'u punuar, punohej, por, nuk dinte kush han, kush paguan. Më të mirë, gjithmonë, ata me llaçka të gjata. Në çdo mbledhje, si biber. Duhet, shokë, të bëjmë këtë e këtë! Shokë, duhet t'i përveshim krahët! Për prodhim më të madh cilësor! E, drejtori, ai që shkoi në pension, vetëm tundte kokën në shenjë pohimi mu si kali kur e rrok vapa verës. Më falni që u shpreha kështu, pasi, siç thonë të moçmit, për të vdekurin vetëm fjalë të mira. Dua të them, për atë që s'është këtu, s'bën të gjuhet gurë. Ai mos qoftë prezent, pas vete ka lënë rrënjë. Bile, rrënjë të forta. Ja, ta marrim Rrapon. Po, po, bash Rrapon që ore çast rrinte në zyrën e drejtorit. I raportonte për gjithçka. Kush si sillet, sa punon. Kush me kënd është i hidhëruar. Kush çka dhe për kënd flet. Dhe që thoni ju, me fjalë të Rrapos e pësoi Syla. Ia ndërroi vendin e punës. E, përse? Vetëm se gjoja, ky Rrapua, e paska zënë Sylën duke folur gojë më gojë me sekretareshën e drejtorit. Nejse, Syla, edhe atje u bë punëtor i dalluar. Rrapua si Rrapua. Avazin e vjetër. Me të ardhur drejtori i ri, pip e në zyrë të tij. I buzëqeshur. I lyer e pispillosur. I rrinte gati

taketukes së tij, sa herë që e shkundte cigaren. Tybe në mund ta gjeje një kamerier ose nuse më të mirë se ai. Një ditë, dy, tre...Një javë...Gati s'dihej më, kush është drejtor, Rrapua, apo ky i riu. Një ditë, e kishte marrë sistematizimin (përshkrimin) e vendeve të punës. Lexonte udhëheqësi i ri dhe diç fliste vet me vete. Bënte ca lëvizje edhe me gishta. Rrapua, sytë filxhan. Priste të japë kontributin e vet, dua të them të ndihmojë.

- Pa, pa, paaa, po ky sistematizim qenka aq i vjetër sa s'bën të shikohet!

- kishte folur ngadalë drejtori i ri.

- I vjetër, i vjetër, yyy, që ç'ke me të! - ishte përzier edhe Rrapua, kur shtëpia kishte të zot sa për sy e faqe. Ai, fare s'çante kokën për asgjë. Vinte, pinte një kafe, lexonte gazetën, herë pas here, shikohej në pasqyrë pa i ardhur fare turp për moshën që kishte dhe avullonte.

- Po, ku në dreq shkonte përditë!

- Ku ta dija unë, i dashuri drejtor. Pale, pale, as një hap s'e bënte pa veturë se! Yyyy, po me ardhjen tuaj shpëtuam!

- Do gjërave, duhet t'ua presim hovin.

- Edhe t'ua presësh, po, poooo!

- Pa disiplinë, s'ka bereqet!

- Ashtu, ashtu he ta lumsha! Disiplinë, disiplinë dhe vetëm disiplinë! Të gjithëve që e meritojnë, t'ua shtypësh kokën! Mjaft e hëngrën sallamadi!

Krahas përshkrimit të vendeve të punës, kishte marrë edhe listën e emrave të të punësuarve. Me kujdes krahasonte moshën, kualifikimin dhe vendin e çdonjërit. Thithte herë pas here cigaren dhe me kujdes merrte ca shënime. Rrapua si shkoqej se si shkoqej.

- Duhet bërë ca ndërrime, kishte pëshpëritur drejtori.

- Me vend. Punë me vend, aty për aty kishte pohuar Rrapua.

- Po, ti, ç'ke të kryer dhe çka punon? - I ishte drejtuar papandehur me pyetje Rrapos.

Rrapo zezës sikur t'i kishte rënë toka e qielli mbi supe. E humbi krejt toruan. Balli i shndriti nga do djersë të ftohtë. Sytë i shkëlqyen si zhivë nga ca bulëza loti. Me zë të dridhur si të ishte në ethe, nisi të belbëzojë:

- Unë...Unë...Asish...Si të them...Axhys...axhys-ta-tor jam...me kualifikim të lartë.

- Nuk ma çoke mallin e axhustatorit fare!

- Po, e dini...Jam ca hall lig...Këndej pari sillem me punë...

- Aha. Sillesh, a! Sillesh e s'di ç'punon a!

- Gjithçka punoj...Jam i urtë e i dëgjueshëm...Kurrë, askujt nuk ia turbulloj ujin. Po, po, më besoni.

Drejtori i ri, fjalëvetë fundit, as që ua vuri veshin si duket. Vazhdonte të bënte ca vizatime e plane. Rrapua, kishte filluar të bluajë edhe më, ama, kur pa se e ka kot, gojës i vuri kapak. Rrinte si në ethe. Parandiente një furtunë të madhe që do ta fshinte përpara dhe si një anije të pafuqishme do ta përplaste për shkëmbinj të rrëpinjtë. Në duar ndiente të ftohtin e metalit, aparatin saldues, syzet mbrojtëse. Ishte humbur i gjori i tëri.

- Ti, ishe? - si në kllapi kishte dëgjuar zërin e drejtorit të ri.

- Po, unë, unë jam, Rrapua i urtë e i dëgjueshëm.

- Unë, më shumë dua një Rrapo punëtor se të dëgjueshëm. Kush punon, s'ka kohë të merret me punë të hallkut. Vetëm puna e nderon njeriun.

- Posi, more drejtor, topi se luan, por,,,

- Prandaj, prej nesër, ti në prodhim! U kuptuam?

- Poo...

- U kuptuam, apo...

- Si urdhëroni si urdhëroni, shok drejtor!

Si bollë e vrarë Rrapua u largua duke thënë vet me vete, ah ç'më dogje more, more...(deshi edhe diç të shkretoj po u përmbajt) shok drejtor!

(1986)

SHKOJ NË PUNË POR...

Hë, si janë ca njerëz. Ti flet seriozisht, ata gajasen së qeshuri me ty. Po, po, Madje, çfarë të gajasurit se. Thuajse u bë nami. Ja, më takoi Lulushi në rrugë për në punë. Ashtu, rafal, më pyeti:

- Si je, ku je, a pushove, a u lodhe?

- Unë jam njeri i ngadalshëm. Të tillë më ka krijuar nëna natyrë. E shikova mikun tim të vjetër, i zënë pisk, pa ia thënë as më të voglën fjalë.

- Me ty e pata, vëllaçko! - më tha.

- Po, po, të kuptova. Mirë, mirë, mirë është...jemi, mirë do bëhet...vetvetiu dolën fjalët nga goja, i bindur se me kaq i dhashë fund bisedës. Po, jo. Ndonëse mëngjes herët sa as sytë nuk më janë kthjellur si duhet, ai përsëri me të veten:

- A po punon, a lodhesh?

- Në punë shkoj e, sa për të punuar...këtu m'u desh ta lija të cunguar fjalinë, mirë, mirë është. S'lodhem fare. Ai, ia plasi gazit. Këndej qeshej, këndej më mëshonte sa mundte shpatullave me atë dorën si shputë arushe.

- Si ore, në punë shkon e asgjë s'bën?! Hahaha, po hokatar i madh qenke!

Dhe, që thoni ju, s'u durova. Tash isha kthjellur mirë. Kohë kisha sa të duash. Fillova rrëfimin tim për punën.

Ka sa vite që, vërtet, vetëm shkojmë në punë. Asgjë prej gjëje s'bëjmë. Blejmë gazetat. Madje nga disa.

Lexojmë e lexojmë. Prej a-së deri në zh. Sa çel e mbyll sytë, vjen koha e mëngjesit. Lëmë gazetat hapekrah dhe ngutemi para kohe të zëmë vend në ndonjë qebaptore për ta mbushur stomakun me qofte, mish të pjekur, mushkëri a diç tjetër. Nuk guxojmë të vonohemi as një minutë. Pa edhe sikur të mos kemi orë. Këtë na e diktojnë zorrët që fillojnë ta ekzekutojnë Bramsin. Shkojmë edhe në çajtore. Pimë, çaj, kafe ose ndonjë limonadë. S'është me rëndësi sa vonohemi. Për këtë, s'na pyet kush kurrë. Kthehemi në zyrë, përsëri i lexojmë gazetat. Jemi bërë të gjithanshëm. Dimë gjithçka. Sidomos politikën në gishta e njohim. Disa nga punonjësit tanë janë bërë oratorë të dalluar dhe kanë depërtuar lart. Dhe nuk e teproj nëse them, jemi bërë gurrë e vërtetë e disa kuadrove deficitare që profesion e kanë oratorinë. Por, të mos largohem nga tema. Posa të lexojmë e të lexojmë, fillojmë, komentimin e disa temave interesante. Sidomos nga futbolli. Tybe treqind tybe përmendësh i dimë biografitë e futbollistëve. Prej nga janë, të kujt janë, ç'kanë qenë, me cilën vajzë kalojnë, sa janë të gjatë, sa të rëndë, çka veshin, çka hanë...Fundja, kjo është gjë normale. I gjithë qyteti ynë jeton për futbollin. E mbushim stadiumin ding. Çirremi në kupë të qiellit. Shajmë sa mundemi. Shkurt, shfryhemi. Në shtëpi kthehemi të qetë e të urtë, si pula. Po, fjalën e kishim te puna. Kur s'kemi më ç'të lexojmë a të komentojmë, nisim e përfolim. Ehe, ku ia nisim e ku dalim. Në vargun e përgojimeve kush nuk zë vend. Kryetari i komunës me ekspeditën e vet, drejtorët, mjekët, tregtarët, pastruesit...Yh, yyyhhh, kur hymë në bisedë për femrat. Aty ke se ç'dëgjon. Çfarë përshkrimesh. Ajo filanja, me flokë të gjatë ngjyrë mjalti e shtatin si bajrak, shitet për goxha serioze, ama, luan, luan bishtin me filan fistekun, që, ç'thoni ju, shkon në shtëpi të saj si mik, e këndej...Pa, paaa, ajo trashallukja e atij drejtorit të rreptë në punë e lepur në shtëpi, e ka përçarë dhe e ka bërë pikë e pesë

kolektivin. Madje, me ca dredhime e buzëqeshje të lezetshme...Sidomos ky avaz ka marrë hov me ardhjen e eprorit të ri. Babaxhan mashkull ky. Yyyy, as që i shkon mendja ta thërras dikë e t'i thotë ti ta punosh këtë e këtë, tjetri atë e atë. Jo, jo. Madje, mua mu desh të trokitja në zyrën e tij për ta pyetur për përgatitjen e numrit të ri të gazetës së kolektivit, kurse ai mezi e çoi kokën.

- Gazetën?! Ç'gazetë, ore?! Kemi gazeta e gazeta sa për të ngrënë lopët!

- Gazetën tonë interne.

- Flasim njëherë tjetër, - ma preu, - Më lë të qetë se isha duke menduar për diçka shumë të rëndësishme.

Dola. Kësaj, kush ka vesh, i thonë përzënie. U bëra helm e vrer. Lidha inat të mos ia shkeli pragun e zyrës pa më ftuar. Kot. Ai as që u bë merak për këtë. Vetëm në mbarim të vitit, kur shqyrtonim llogarinë përfundimtare, u takuam në mbledhje. Për çudi të shërbimit tonë, ai na lavdëroi e na lavdëroi se si me punë e organizim të mirë kishim kursyer shumë mjete dhe kjo është fitore e madhe në këtë krizë ekonomike, duke apeluar që të tjerët të shkojnë gjurmëve tona. Hej, bela, thashë me vete. Po, s'ia prisha. Bëre zot mirë!

- Pëshpërita në heshtje, edhe pse jam komunist e zotit s'i besoj.

Do të thoni, ju a gjithnjë kështu? Jo. Para këtij ishte një hundëlesh. Aaa, ai e dinte punën punë, pushimin pushim, shpërblimin shpërblim. Ishte i ri e sygozhdë. Çdo gjë hetonte, i mbante dizginat në dorë. Po, koha na kalonte sa çel e mbyll sytë. Ç'e do. Shpejt ia pamë shpinën. Pse-hun se mësuam kurrë. Nejse, edhe me këtë u mësuam. Por, hall është se ja, po i skadon mandati. A thua kush na vjen se? Eh, po në hall për të rënë ai me ne e ne me të. I pari na e nxori shpirtin me punë, i dyti me ndenjë, i treti, pale.

- Uaaa, sa paska vajtur ora?! Mua m'u avullua mëditja! - dëgjova zërin e mikut tim të vjetër, i cili mori vrapin si i çartur për në punë. Instinktivisht më kaploi një gaz çmendurak. Ngadalë, ngadalë pa ma turbulluar kush ujin, arrita në zyrë me një deng gazeta nën sqetull.

(1982)

UNE, KOPILI

- Kros, more kros, si tu nis, ashtu tu sosë, ose, si thonë një fjale "as me shehër, as me Barilevë", kështu e nisi bisedën, shoku im i mirë, posa u ulën në vendtakimin e përhershëm.

- Auuuu, edhe ti, ç'ma nxive jetën me kukama! As u pyetën si jemi, ku jemi, ti, dërdërdër si çakalle mulliri! Taman sikur të të ketë rënë bota mbi supe, e qortoj.

Edhe më ka rënë, në daç ta dish!

- Pa hë, pa hë, ç'të keqe ke, shprehu të të dëgjoj! Mos ke ndonjërin të sëmurë?

- Jo.

- Të ka vdekur njeri?

- Nuk.

- Mos ke mbetur pa bukë, pa idare?

- Jo, jo dhe joooo!

- Mbylle pra atë çorape se s'të ka hije!

- Fjalët e fundit, hetova se ia lënduan sedrën. S'më tha gjë, po në fytyrë u bë prush. Duart që i dridheshin, i futi në xhepa dhe pas pak, mbi tavolinë përplasi një deng letrash.

- Nuk i kam syzat me vete dhe s'kam kohë t'i lexojë të tërat. Më thuaj, ç'janë e ç'të mundon?!

- Unë, jam kopil. Yt shok, është kopil. Ja, këtë hall kam.

- Ti ke nënën dhe babanë, ke vëllezër dhe motra, ke vendin e lindjes.

- Të gjitha i kam, asgjë nuk kam. Unë, jam vetëm një kopil.

- Bobooo, sa me siklet e paske marrë!

- More edhe si kokërr kripe të plasi, pak është.

- Atëherë, të flasim shtruar, le të shkoj gjuha ku dhemb dhëmbi dhe mjaft më torturove veten dhe mua!

Si i hoqi me zhurmë nja dy gërçama çaji dhe kërcëlloi gishtat e duarve, sipas adetit m'i daltoi sytë dhe shkrepi:

- Lum vëllai, faj s'më ke ti e as kërkush. Faj s'kam as unë. Fajin e ka një i treti. Por, kur s'ke ç'ti bësh atij, bjeri samarit, të merr vesh gomari. Ç'e do. Ja, se ky gomar, ka qëlluar lëkurëtrashë dhe i shurdhër! Vrapon e vrapon pas dokumenteve. Në këtë skamë, jep e jep para, punët në vend. Që thua ti, vdiq dhe Jugosllavia e dytë, ndjesë pastë se shumë sherrin pas veti e la, u përzien keq leshrat sa qeni t'zonë se njeh dhe vaj halli për atë që e keqja e merr përpara. Ky nafakprerë jam edhe unë. Mbeta kopil. Në vendlindje që ia kam kthyer shpinën prej zori afro një çerek shekulli, më thonë s'je më i yni. Këtu, ku kam shoqen e fëmijët, s'më pranojnë për të vetin. Kërkojnë dokumente e dokumente. Vrapo andej vrapo këndej. Sa e nxjerrësh njërën i skadon afati tjetrës dhe uraaa e prej fillimit. Këmbët më ranë.

- Me sa kuptoj, problemi yt qenka...

- S'jam nënshtetas i askujt. Nuk më jep kush pasaportë, letërnjoftimit i kalon afati. Ç'të bëj? Që thua ti, mu mbush mendja dhe vendosa të kërkoj nënshtetësinë e dyfishtë në vendin amë. Thash, përditë dikush qarkullon andej e ma kryejnë këtë punë. Helm e vrer u bëra edhe më keq. Kërkojnë dëshmi se jam shqiptar, kërkojnë dëshmi nga gjykata që jetën ma ka nxirë, se nuk jam nën hetime dhe i dënuar. Desh u çmenda nga sikleti. Shyqyr që s'më pa njeri se do bëhesha përrallë, letrën me udhëzimet e

nevojshme për nënshtetësi të dyfishtë, pa vetëdije, e kisha ngrënë. Shyqyr që s'më bëri dëm.

- Futja në pordhë, lum shoku, e ngushëllova ca banalisht. Jepi fund kësaj pune e t'pimë çaj rahat. Zullumi këputet prej s'trashi e...

- Ç'do me këtë të thuash?

- Dua të them se këtu nuk është fundi i botës. Të mirat vijnë ngadalë. Nuk shkon gjatë e ishalla nis e funksionon Republika e jonë dhe të gjitha harrohen. Nuk është krejt zi si të duket! Buzëqeshi. Edhe pse si besoi, i erdhi mirë. E mundi zemërimin.

(1992)

INTERVISTA

Më kërkoi redaktori.

Kur mora të ngjitem shkallëve për në zyrën e tij, filloi të më rrahë zemra si e zogut në grusht. Nga s'më shkonin mendtë. Mbase s'është i kënaqur me punimet e mia. Mbase, helbete, në këtë kohë të çuditshme mishmash, më ka pjellë ndonjë e papritur. Hej, taksirat, he taksirat! Dikur e bëra zemrën gur. Le të bëhet ç'të bëhet. Prej kësaj lëkure s'dilet. Do të më duhet të pajtohem me zor, se gazetarinë e dua, ama, ja s'më vete dot. Në ato përpëlitje, ende pa e zgjatur dorën nga doreza e portës, dëgjova fjalët:

Hë, më, ç'pret, futu brenda! S'kemi kohë për të humbasur! Duhet të nisesh menjëherë!

Ishte zëri i redaktorit, i cili mbiu si prej toke. Së bashku u gjendëm në zyrën e tij. Ngado që të shkonin sytë, letra, letra, letra, gjithandej letra, gazeta, libra. Të shkapërderdhura që ç'ke me të. Ndonëse do bulëza djerse ende i ndija të më rrëshqisnin ballit teposhtë, sikur u lirova nga një barrë e rëndë. Ama, rrija gatitu dhe pritja të dëgjoja fjalën e tij.

- Dëgjo, çuni!- ia nisi shkurt e trup pa zbukurime. Gazetaria është punë dinamike. Gjithmonë je në vrap për të zënë diçka. Dhe, shpesh të duket ia arrite qëllimit, kthehesh me gjah të plotë, sheh se s'ke bërë asgjë. Ia nis nga fillimi. Kështu përditë. Tërë jetën. Por, t'i lëmë filozofimet. Ti je i ri e do të bindesh. Duhet ta realizosh një

temë. Ta intervistosh një punëtor nga prodhimi i drejtpërdrejtë. Ta lejosh të flasë pa pikë, pa presë e thonjëza, për të gjitha çështjet që e preokupojnë. U kuptuam?

- Si urdhëron!

- Atëherë, udha e mbarë! Për nesër, dua të jetë gati.

Hyra te redaktori përplot kokën me një ngarkesë psikike, dola i lehtë, fluturoja. Tema m'u duk e realizueshme. Bllokun nën sqetull e në rrugë. Nuk e vrava shumë mendjen. Pranë redaksisë gjendet një kantier ndërtimtarie. O, aty, e gjej personazhin e temës sime, o s'ka. Ecja dhe vetmevete i përpiloja një varg pyetjesh. "Biseda të jetë sa më spontane" më tingëllonte zëri i redaktorit. Buza më luajti në gaz. E shihja se është çasti më i volitshëm për t'i hyrë në huj njeriut që ua kishte futur shtatë palë ethe shumë gazetarëve. Disa ishin detyruar ta lëshojnë edhe punën. Kur erdha në vete, hetova se gjendesha në mesin e punonjësve. Meqë më treguan kush është brigadier, kërkova nga ai të ma zgjedhë një punëtor të vyeshëm e të zellshëm.

Ju jeni?

Lame Kaculi, - ma priti shkurt.

Jeni punëtor i vjetër, apo jo?

Po. Qe 25 vjet ndërtoj e ndërtoj godina të reja.

Jeni i kënaqur?

Yyyyyyyy

Me të ardhurat?

Aaaaaaaa!

Demek, të majme.

Milioner, ore, milioner.

A bën të na thoni, nëse s'është fshehtësi, sa fitoni në muaj?

Një thes sheqer.

Çkaaa?!

Nj-ë th-e-s sh-e-q-e-r.

Dhe me gjashtë anëtarë të familjes ia del në krye?! Dhe për këtë më thua yyyy, aaaa, uuuu?!

Pse habitesh? Kaloj shumë më mirë se ti e shumë shokë tu. I shtrij këmbët sa e kam jorganin. Me të hollat që i marr blejmë 5 kgr., sheqer, 3-4 litra vaj, kripë, bukë popullore e nga ndonjë sapun dhe ...

Dhe?!

Dhe bëjmë pikën e sefasë.

T'mu lidh gjuha nyjë. E humba toruan. I kisha zgurdulluar sytë mbi bllokun me shkarravina pa pasur guxim ta shihja bashkëbiseduesin në sy. Bile, edhe stilografin e kishte lëshuar shpirti nga një shtypje e pakontrolluar. Ndërsa, në vesh më jehonin fjalët: Çdo e keqe e ka të mirën e vet. Vend për auuuu, nuk ka. Nuk sëmuremi nga sheqeri, nga majmëria as nga sëmundjet e zemrës, meqë ëmbëlsira e mish hamë vetëm për ndonjë festë...

Edhe rrugës më shoqëronin fjalët e tij. Ecja si pula pa krye, pa ditur ku dhe nga. "Gjithmonë je në vrap. Kujton se kthehesh me gjah të plotë, e kthehesh ... duarzbrazët" – më ushtonte koka nga zëri i redaktorit.

Si bollë e vrarë u nisa nga redaksia pa ditur si do t'ia lidh kryet kësaj bisede.

(1988)

MJALTI

Lame Kaculi i pari arriti në rend për bukë popullore. E mbushi cigerin plot dhe turr e vrap në shtëpi. Si hëngër ca kafshata në këmbë të përcjellë me një spec kërc, kërkoi nga e shoqja t'ia jepte librezat shëndetësore të fëmijëve. Me një të puqur të shikimeve, u kuptuan mirë se nga do t'ia mbajë. Ecte Lameja rrugës, duke folur vetmevete. Me sy në rrugë, me mendje vetëm ai dinte nga ishte. Dhe sa çel e mshel sytë, u gjet në Shtëpinë e Shëndetit. Tek atëherë u shkund dhe u step në vend. Nisi ta vrasë mendjen pse kishte ardhur. Jo, ai e dinte mirë ç'kërkonte, ama, s'dinte si quheshin të shkretat ilaçe. Mandej, a thua me çfarë mjeku do të kishte punë. Qëllon ngandonjë që ka durim e të dëgjon deri në fund, por, ka do që i bien shkurt e trup: "Hajde, ç'ke, ç'do, s'kam kohë tepër për të humbasur!" Kësaj ia kishte dronë shumë. Do t'i lidhej gjuha në fyt o do të bëhej lole në sy të botës. U ulë në bankën e vendosur në hyrje. Priste mos ndonjë sebep i del përpara. Nuk u mashtrua.

Sot, më ka nisur mbarë, pëshpëriti dhe i qeshi nuri.

Përballë, pa të afrohej një tezak i largët, mjek.

- Hë, mor Lame, ç'e mirë të solli këtu?

- Paj, hallet, hallet tezak.

- Këtu, shtëpi hallexhinjsh është. Por, nejse, hajde hymë brenda e shohim e bëjmë.

Sa u gëzua Lame ziu, aq edhe u ngushtua. Nëpër kurriz ndjeu t'i rrëshqasin ca djersë të ftohta. Zihej e

përzihej i shkreti si t'ia fillonte. As që kishte hetuar se gjendej në ordinancë të mjekut.

- Lame, Lame ore, nga i lëshove të shkretat të të kullosin? – dëgjoi zërin e butë të tezakut.

- Ah, jo... po, si të them...

Tash, më thuaj, kë e ke të sëmurë?!

Të sëmurë?!... Bah, edhe kjo më mungon!- foli në heshtje. –Të sëmurë, thatë?... Paj, tezak, shyqyr, shëndosh si molla të gjithë i kam.

- Atëherë, pse ke ardhur?

Të më shkruash do reçeta.

- Mirë. Do për zjarrmi?

- Ncuk.

- Për bark?

- Jo.

- Diç për lëkurë?

- Jo, jo, jo. Dua, dua, s'di as ç'dreqin dua! M'i tregoi fqinji emrat, po kujt? Më janë rralluar të shkretat. Me shishe janë.

- Sirup për kollë?

- Lloj sirupi është, ama, jo për kollë, po... si të them... Nisi me dorë të tregojë diç si për të lyer. Dikur, nga sikleti, i erdhi te hunda dhe tha:

- Mjaltë, dua mjaltë për ta lyer fëmijët bukën.

- Mjaltë?!... Hahahahaaa, ç'ma qite gazin. Po, ti ke ardhur te mjeku a te bletari? Gazi i mjekut sikur e shtrëngoi keq për fyti e bëhej se po ngufatej. Sytë picërrake, i daltoi te një e thyer xhami në dritare dhe ndjeu se po e lëshonin këmbët. Po, nuk u dorëzua.

- Mbase s'dita ta sqaroj mirë. Ama, që thua ti, bukën popullore po e siguroj diqysh, por për ta përcjellë s'arrij dot t'u sjell fëmijëve asgjë. Një fqinj, hajr bëftë, më tregoi për këtë lloj ilaçi që e paska shijen e mjaltit. Andaj, erdha dhe ja fati, të takova ty, e mbase më ndihmon.

Mjeku u zu ngushtë. E kuptoi ç'kërkon Lame Kaculi. Mori librezat e fëmijëve dhe për secilin shkoi nga dy shishe Vidalin dhe Multi Sanostol. E përcolli Lamën me një buzëqeshje të vrarë, i cili shend e verë vrapoi nga barnatorja e parë e qytetit.

(1988)

KUADRI DEFICITAR

Lexo e mos beso. Dikur kishte për të ngrënë lopët, sot deficitar. Sa lufta bëhej, duke ia qitur njëri-tjetrit sytë për ta zënë kolltukun e butë- nisi të dërdëlliste që në mëngjes Memish Shuli, duke e shfletuar shtypin e ditës. Disa herë hoqi syzat për t'i fshirë dhe kur lexonte përsëri tundte kokën në shenjë habie pa e bindur veten se e gjithë kjo është e saktë. Nuk m'u durua:

Hë, Memish, përsëri po kacafytesh me ndonjë të padrejtë,- e ngacmova.

- Po kacafytem me një të pabesueshme. Në disa qytete të vendit, po përsëriten konkurset, të interesuar s'ka.

- Eeee, eee, të më falësh, - ia prita. – Sigurisht janë kuadër deficitar, prandaj, vështirë të sigurohen.

- Jo, vëllaçko jo. Fjala është për drejtor. Ky post, deri vonë i shenjtë, s'tërheq më.

- Ani, ç'ka këtu të paqartë?

- Në të parë, hiq. Ama, kur e di sa të rinj me përgatitje superiore kërkojnë punë...

- Stop, stop, s'e ke mirë! Mos deshe pa pikë përvoje, hopa e drejt mbi kalë, a?

- Aiii, edhe ti, po shpirtin në fyt e ke! Të rinjtë si përmenda për t'i ngjitur mbi altarë, jo. Por, me gjithë atë ushtri kuadrosh të reja çdo drejtor e ka më lehtë t'i dëshmojë aftësitë e veta si organizator. Pra, trimi i mirë, me shokë shumë.

- Nuk pajtohem! Pak ke drejtorë që duan shumë shokë. Prandaj, edhe ato që i patëm, sa çel e mbyll sytë avulluan.

- Ku në dreq shkuan! Ishalla, toka si përbiu.

- Jo toka, po sefaja. Më kuptove?

Heshta. Prita që Memishi ta vazhdonte bisedën. Të më thoshte ku e ka fjalën. Ai, i daltoi sytë diku dhe një kohë qëndroi si mumje. E dija se pa e pickuar me fjalë s'kishte forcë të vinte në vete. Dinte edhe me orë të tëra të qëndronte në atë pozitë.

Mish, o Mish, mbase nga xhelozia flet kështu, - fola.

Si ta kishte kafshuar gjarpri, brofi në këmbë.

- Dëgjo këtu, ma ktheu duke ma treguar gishtin tregues, - unë as kam qenë, as kam pretendime për t'u bërë drejtor e kurrfarë udhëheqësi! Ky që jam, do të mbetem sot e mot. E kuadri "deficitar", të nderuarit drejtorë, të gjithë, këtë s'e bëjnë nga modestia, por ...

- Pa hë, pa hë, të dëgjoj!

- E bëjnë se s'kanë çka të gërryejnë më. Erdhën burrat e botës asht e lëkurë, u bënë si dema. Prej atit në at. Morën banesa, ndërtuan shtëpi, blenë vetura luksoze, ca ndërtuan dhe vila "të vogla" në bjeshkë e bregdet, shëtitën sa mundën brenda e jashtë vendit, shkretuan një varg organizatash dhe...

- Dhe?

Dhe shkuan në pushim të merituar. Ca u pensionuan, ca udhëheqin do BVI e disa, qe besa, ende mbajnë ders nëpër organizatat politiko-shoqërore të komunës.

- Ç'do të thuash me këtë?

Të vërtetën e hidhur. Të vjetrit të rinjve u lanë vetëm halle. Andaj, kush është ai i marrë që do t'i futë vetes therrë në këmbë?

Rrudha supet. Buzëqesha. Buzëqeshi edhe ai. Ishte shenjë e puqjes së mendimeve.

(1989)

UNË, GOJËMBËLI

Thonë: të jesh trim, është punë e madhe, për të diturin, rrugët janë të hapura. E vërteta është e ngadalshme, por e arritshme. Dakord. Mbase të gjitha janë ashtu. Më duhet të pranoj se nuk jam as trim, as shumë i ditur, besa, as këtë të tretën s'e kam provuar. Do të më pyesni si eca përpara. Kam, jahu, edhe unë armën time. Dëgjueshmërinë, gojëmbëlsinë. Këtyre ua pashë hajrin. Ju kujtohem, punën e nisa si daktilograf. Dhe, që thoni ju, edhe atë të shkretë e kreva, falë qengjave të pjekur, djathit, mazës e ca cikërrimave të tjera. I hapa veshët si buf, që ditën e parë kur më thirri drejtori.

- Jotja është, më kështilloi, të jesh i mirë, i dëgjueshëm, pa veshë, pa sy, pa gojë, pa ...

Unë, kokëtuli, fjalët i mora kallëp. U bëra all në fytyrë nga sikleti. A mund të hiqja dorë nga sytë, veshët, goja? Ama, ai, njeri me përvojë e kopil, e kuptoi hutinë time. Ma hodhi dorën mbi supe, e si të ishim miq të vjetër, më foli:

- Qengji i butë, thith dy nëna. Flitet e ç'flitet, sheh ç'sheh, dëgjon ç'dëgjon, mbeten këtu. Sekreti i kolektivit s'bën të dalë jashtë. Veshët i bëra si të lepurit e përpiqesha t'ia shpjegoja vetes ç'dreq fjalë më qe "sekret". Nuk lejova të kuptohem se sa i trashë jam. Vura buzën në gaz e si kali kur e zë vapa verës, tundja kokën në shenjë pohimi. Si duket, të dy u ndamë të kënaqur nga ky takim.

Pranoj, të vështira i pata ditët e para në punë. Shkronjat në makinë, si i thonë një fjale, duhej t'i gjeja me "polic". Bubuuu, sa gabime që bëja! Ama, me përkulje, me buzëqeshje, me lepe e peqe, i gëlltita të gjitha qortimet. Mandej, s'e harrova as zanatin e vjetër. Nga fshati solla ca herë edhe fli të mazitur me ndonjë kalanicë kos dhensh. Eh, të shihni se si u forcuan urat e miqësisë. Do ti, së shpejti, nisën pëshpëritjet. "Eu, po çarkaloz djalë që është. I dëgjueshëm, i paprituesshëm, gojëmbël". Kur i dëgjoja, njëherë skuqesha. Por, së shpejti, disi kjo më dukej joshëse dhe nisa të besoja se isha i tillë. Ndërrova mënyrën e sjelljeve. Lyhesha, kruhesha e krekosesha si bibani. Kurrë pa livando s'dilja kund. Ndalesha shpesh edhe para pasqyrës kur shkoja në toalet dhe para saj bëja lëvizje e grimasa të shumta. Nxirrja dhëmbët, të cilat, e pranoj që sapo hyra në punë, nisa t'i pastroja, krihja flokët. Shkurt, përditë e më shumë, më hynte vetja në huj. Ambiciet për t'u bërë dikush e diçka, sa vinin e shtoheshin. Tashti, të gjithë atyre që e kishin pushtetin në dorë, ua njihja dhëmbë e dhëmballë. Andej, vazhdoja të luaja sipas muzikës që bënin. Rrugët i kisha të hapura. Hajt e hajt, nisën të më lironin nga detyra e daktilografit. Ja dhe rasti i parë të ngjitem për një shkallë më lart. Dua të them, më caktuan njëfarë referenti. Çfarë referenti do më pyesni. E, ku ta di unë. Kryeja çdo punë që ma caktonte drejtori. U bëra krahu i tij i djathtë. Besa edhe sekretarit ia merrja temenanë. Helbete. Sa më shumë të lëshosh rrënjë, më i fort je. Mandej, përpiqesha të isha sa më xhentil me të gjitha palët që vinin te drejtori. Punë me leverdi, më besoni. Lidhje pas lidhjeje, privatisht arrita ta fusja në xhep edhe shkollën e mesme. Vërtet, kjo më kushtoi ca, një dash, në fërlik, bakërdar me tëlyen has, ama, s'ka dert. Ku ke parë ti dasmë pa mish. Kryesorja, autoriteti im rritej e rritej. Por edhe fati më printe. Drejtorit mandatet i

përsëriteshin. Unë shpinën fort e më fort. U bëmë si njerëz të një shtëpie, ore.

Sa më shumë që kalonte koha, unë sikur nuk isha i qetë. Më dukej se ngadalë po ecja përpara. Lakmoja të bëja edhe ndonjë hap më shpejt. Ndonëse ia dija hallin vetes, më tepër u besoja fjalëve që vinin anash "mëkat që s'e ka fakultetin". Kjo dëshirë më linte pa gjumë. Sa i mbyllja sytë, shihja veten si akademik. Ulur në kolltuk të butë e të veshur me kadife të kuqe. Sekretareshën belhollë që më sillej me tabaka në dorë, e gatshme për të gjitha shërbimet e mundshme. E, mua, nga kënaqësia, më lëviznin mustaqet spic. Mustaqet? Uaa, unë as që i kam. Por, patjetër se do t'i lëshoj. Përvesha krahët. As për të punuar as për të mësuar, por për të kërkuar mundësi të reja përparimi. U regjistrova në fakultet. Ama, që thoni ju, koka ime ishte e vogël për t'i nxënë gjithë ato mësime e gjithë ato libra. Prandaj, nisa aksionin e ri. Një profesorit ia dërgova një pikturë të bukur. Tjetrit ia rregullova të shfrytëzonte një kredi të majme me kamatë të ulët. Një të tretit i mundësova të blinte veturë me çmim të vjetër e kështu me radhë. Të gjitha bëheshin rastësisht e këndej dardhë me bisht. Ç'ti bësh. Kështu e donte puna. Në punë s'lejoja të më ikte asnjë ngjarje pa e ditur unë. Kudo qëlloja. Si biber më. Aha, u mësova edhe të diskutoja. Më doli gjuha, po. Sa herë flisnin ata të kreut të organizatës e ndonjë mysafir nga "lart", aty isha edhe unë. Jo vetëm që i përkrahja me zemër, po dhe i zbukuroja edhe më tepër duke i lavdëruar e falënderuar për kontributin e tyre. Hop e hop, hop e hop, do ti e t'mu hapën rrugët për të depërtuar në të gjitha organizatat politiko-shoqërore. Njëherë në kolektiv e më vonë edhe në komunë e më lart. Ndërrova edhe shoqërinë. S'kisha kohë të humbisja me djerrakohësit. Fundja, aq isha zhytur nëpër aktivitete, sa s'më binin ndërmend as të mitë në fshat. Madje, fshati nisi të më bëhej i huaj. Më duhej të ikja të mos takohesha

fort me ta. S'i dëgjoja dot bisedat e tyre të zbrazëta. Ta lodhin kryet. Mandej, bre vëlla, vetëm një teli dinë t'i bien. E, ju paça juve që më kuptoni, autoriteti është vështirë të fitohet. Por edhe më vështirë të ruhet. Apo, s'e kam mirë?

(1989)

NDËRGJEGJA

Cuci s'është mirë. Ka kohë që i ka humbur qetësia. Rri vetëm. Flet me vete. Qëndron para pasqyrës. Merr poza gjithfarë. Ngre grushtin përpjetë. Dikujt i kërcënohet. Dikend e qorton. Dhe plandoset mbi kolltuk i lodhur e i rraskapitur. Nga s'i shkon mendja. I del përpara Tali. Eh, Tali, Tali! Katër vjet i kaluan bashkë në një bankë. Po, ku është se. Avulloi. Dhe atë, si thonë, pa bërë uh as oh. Çfarë kallushani që ishte.

- Phu, mendja e dreqit, nga s'më çon! – e shau veten. Unë, Tali s'jam. Një fije dhjam s'e gjen në trupin tim. Megjithatë, diç në frymëmarrjen time s'është në rregull. S'ngihem dot frymë. Ndihem si bollë e vrarë.

Çohet në këmbë. Sillet nëpër zyrë si pula pa krye. Kërcëllon dhëmbët. Bën lëvizje të çuditshme me duar, këmbë e kokë.

- Ehhh! – kot s'thonë të vjetrit, flet zëshëm. Çka i bën vetes, s'të bën ngjeti. Atyre që ua zgjata dikur gishtin, sot po ma hanë dorën. Dorën?! Çfarë dore more! Kokën, kokën dhe s'kanë të ngirë. Dhe kush? Më të afërmit. Shihe si më kanë bërë e më kanë katandisur sa as gjumin gjumë s'e bëj. Edhe ata atje "lart", si mushka kanë ngulur këmbë, përgjegjësi pa përgjegjësi. Vite me radhë ua lava kryet me akull diqysh. Ama, kupa u mbush. Po, nga t'ia filloj se. Pale ç'më thotë krahu i djathtë, i madhërishmi zëvendësi im. T'ia nisim, ore, t'ia nisim nga pastrimi! Si m'i përngjet dhe kjo punë asaj anekdote kur mbreti kish kërkuar nga

qytetarët që nga mesi i tyre ta lëçitnin të keqin. E, që thoni ju, i keqi çon gishtat e pajtohet me këtë propozim. I gjori. Veten e harron fare. Shko e thuaj të varet për qerpik të syve. Yh, sa hoqa derisa e pranova! E kam djalë motre të shkretin. Edhe motra pa ditë të bardha. Ama, i pangiri i pangirë. S'di ku është kufiri. Është në gjendje të kollufisë tërë ndërmarrjen. Në shënjestër është edhe arkëtari. Thonë, është kasap i vërtetë. Aq bukur di t'i rrjepë punëtorët dhe është njeriu më i respektuar. Edhe ky ia nxori bishtin. Paska bërë edhe marifetllëqe me ca çeqe. Eu, eu! Në to firmosja ime. Do ti edhe këtë e kam sebep. E kam bash djalin e hallës. Erdhi, na, koc e lëkurë. Ç'të shohësh. Është bërë si kacë. Dera nuk e zë. De, deee, po sekretarin ç'e kam! Është vëllai i burrit të tezes. Të gjithë çelësat për çështje juridike, besa edhe të kuadrove, në duar të tij. Mbjellë e korrë nëpër ndërmarrje. Ligji thotë kështu dhe pikë. Madje, shpesh harron kush jam e nis e më mban ligjërata...! ja, yhhh! – nisi të më zihet fryma. Patjetër të dal në dritare për ajër të pastër. Diç sikur më është lidhur në fyt. Më ngulfat. Kështu i lau duart sa çel e mshel sytë Tushi, he, ndjesë pastë! S'ngihej dot frymë. E çuan në spital. I thanë, ke ndezje në mushkëri. Mandej, jo, shihet një hije aty. Dhe si priti rezultatet përfundimtare. Treti sikur të mos ishte fare. Po, po. Edhe në djersë ishte larë si unë. Sa fort më rrahë zemra. Ç'më sillen përpara Tali e Tushi? Ata kanë vdekur. I takojnë një bote tjetër. Unë kam punë me të gjallët. Me të gjallët?! Madje, më tepër se ç'duhet të jenë. Ah, si po çmendem nga mendime të errëta! Pse nuk e thërras sekretareshën? Pse nuk kërkoj të ma sjellë një kafe me një lëng limoni, mbase do të qetësohem? Jo, jo. Nuk bën. Edhe ajo dash me brirë më doli. Derisa s'e mori vendimin, mjaltë nxirrte nga goja. "Urdhëroni, shoku drejtor. Më kërkuat, shoku drejtor. Doni kafe, shoku drejtor". Eh, bukëpërmbysja! Tashti s'më përfill fare. Prej zyre në zyrë. Do ti, si e ndien

mungesën time, e mbush zyrën me do horongopa. E, bujrum në sofër të mixhës, ha e pi me tefter të reprezentacionit tim. Meqë është çika e ballduskës, një ditë vendosa që përmes gruas t'ia tërheq vërejtjen. Fjala më mbeti në fyt, pa e kryer fjalinë. M'i zgurdulloi sytë fisnikja: "Jooo! Çka mendove ti! Ajo është e re! Mos deshe të bëhet rob si unë e ime motër?!. Mandej, pse, mos po t'i shpenzon paratë e xhepit tënd?! Hajt se thesi i organizatës është pa fund. Harxhimet e saj s'janë as sa një pikë uji në det". U pendova si qeni që e përzjeva... për t'i ardhur era. Desha s'desha, i futa veshtë në lesh. Më nuk di me kënd ta hapi zemrën. Sidomos tash, kur nga "lart" kërkohet përgjegjësi. Pse më largohen njerëzit? U bëmë a s'u bëmë si një familje? Të mirën e të keqen?!... Të keqen?! Punë që s'bëhet. Të mirat i ndanim bashkë, madje pa hoxhë, merrnin edhe më tepër. Ama, sa për të këqijat, ja shihe. Ua pafsh hajrin! Pos Tushit e Talit, asnjëri s'më sillet përpara syve. Eh, kësaj i thonë, e mira me bisht. E mira atyre, bishti mua.

Ja, cingëron telefoni. Ata janë. Unë s'kam bërë asnjë hap përpara. Nuk do ta çoj, jo. Nuk kam forcë për këtë. Mua më shtrëngon diçka në gjoks. Ajër? Dua ajër! Ajër të pastër!... Sa është ndotur ambienti. As me ajër s'ngihem dot. Ja, po më lëshon fuqia. Po më bie të fikët... Oh!

Cuci i shkretë. As vetë s'e dinte sa kishte qëndruar në atë gjendje. Kur i hapi sytë, si në mjegull, pa të jetë i rrethuar. Sa fytyra të çuditshme. I bëhej se të gjithë zgërdhiheshin me të. Shikimet e tyre e thernin si shigjeta helmuese. S'i shikonte dot. Çuditërisht shtrëngonte trupin sikur atë çast do t'i vërsuleshin ta gllabërinin. E, në kokë sikur i ushtonin fjalët: "Ah do të vdesësh! Do t'na i lësh këmbët e arushës në dorë! Jo, jo! Edhe i vdekur do të japësh përgjegjësi! Mjaft e kullote livadhin e huaj!" Sa

dëshiroi atë çast që të ishte i vdekur. Madje, kjo ndjenjë e kishte kapluar të tërin. As provoi më t'i çilte sytë. Në gjendje as i gjallë as i vdekur e dërguan në spital. Më kot i flisnin mjekët. Më kot qante e shoqja mbi kokë. Cuci luftonte në heshtje me ndërgjegjen e çuar peshë.

(1988)

FABRIKA E RE

Thonë, njëherë të vjen vera te dera. Prandaj, po qe se di ta shfrytëzosh, bëhesh çirak. E, po ndodhi e të iku, tërë jetën do të vuash duke mallkuar veten e çdo gjë. Me këto fjalë e hapi mbledhjen Baluci, kryetari i Këshillit tonë Punëtor. Zogun e kemi në grusht. Ka arritur propozimi që me një firmë simotër nga vendi t'i bashkojmë mjetet dhe punën, t'i zgjerojmë kapacitetet prodhuese me produkte të reja që tregu i ha si hallvë. Por, për këtë duhet të diskutojmë shtruar të gjithë. Të mirat e të këqijat, duhet t'i shoshitim.

- Yh, s'paska bereqet nga kjo punë, - dëgjua një zë.

- Pse, ore?

- Pse të këqijat te ne ua marrin anën të mirave.

- Dale, dale, punën s'duhet kuptuar ashtu kallëp. Unë, fola ashtu siç e do rendi i kryesuesit të mbledhjes. Ama, e dini, fjalët janë fjalë, e, punët vejnë ndryshe.

- Bjeri më trup, ç'duhet të bëjmë ne? – pyeti një tjetër.

- Asgjë të jashtëzakonshme. Ta shfrytëzojmë rastin që na është ofruar. Të mos lejojmë që zogu të na ikë nga dora. Shkurt, mjetet të ngelin këtu.

- Demek, të luftojmë për mjetet, pa marrë parasysh se ka a s'ka arsye për këtë.

- Të luftojmë, jaran, për të ndërtuar objekt të ri ekonomik që pos "zbutjes" së papunësisë, do të ndikonte

drejtpërdrejt në zhvillimin e gjithëmbarshëm të qytezës sonë.

- Çka do të prodhonte?

- Për çka të merremi vesh.

- Ne këtu, apo disa atje nëpër zyra?

Kjo pyetje ia ngriti nervat Balucit. Por, meqë nga rreshti i parë mori sinjal të mos e bënte këtë të madhe, duke u kollitur, foli butë.

- Shokë, për thumba s'kemi nevojë. Ja ku jemi. Secili le të propozoj diç për çka ia merr mendja dhe mandej, shohim e bëjmë.

Në sallë heshtje. Filluan pazarllëqet vesh më vesh. Si lumenjtë në vjeshtë vërshuan propozimet. Prej fabrikës së gjilpërave e deri te ai për makina më të komplikuara. Madje, gati çdo propozues, kur e arsyetonte propozimin e vet, sikur mbyllte sytë. Fytyra i qeshej. Atë çast, si në shirit filmi, shihte objektin e ri ashtu sipas imagjinatës së tij. Procesverbalisti i shkretë ishte bërë qullë nga djersët dhe vetëm turfullonte. Mbase dhe shante. Se merrte dot me mend se si mund t'i duronte qyteza e tyre gjithë ato objekte të propozuara. Këndej, një që e kishim, pareshtur "prodhonte" humbje. Shkruaj e shkruaj, dikur u bë vet i dyzeti. E gjuajti lapsin me rrëmbim. Të gjithë drejtuan sytë nga ai.

- Ç'u bë?

- Ç'e gjeti?

Një varg pyetjesh u drejtuan nga ai. Ai vetëm buzëqeshi duke fshirë djersët e ballit. Si i mati mirë të gjithë me sy, foli:

- Edhe unë, si punëtor i këtij kolektivi, kam të drejtë të bëj një propozim.

- Si jo, si jo, ia ktheu Baluci përgjigjen. Madje, sa më shumë propozime, aq më mirë. Të kemi çka të zgjedhim.

- Propozimi im është, e dini, si të them...

- Hë more, hape të shkretën!

- Jo, jo, s'e them dot. Druaj se nuk ia qëlloj e mbase dhe më keqkuptoni.

Të gjithë e kishin ngulur shikimin te procersverbalisti. Ai rrallë ose kurrë s'e merrte fjalën. Andaj, paraqitja e tij ishte befasi. Kur pa se s'kishte nga t'ia mbante shkrepi:

- Shokë, unë jam i mendimit që ta ndërtojmë një fabrikë të re.

- Shumë mirë, ndërhyri kryesuesi i mbledhjes. Çka do të prodhonte?

- Hiç, asgjë.

- Hiç, asgjë?! – si në kor u dëgjua pyetja.

- Diçka po, - foli gjakftohtë. Në këtë fabrikë do t'i tubonim të gjithë ata që më qejf kanë të marrin pjesë nëpër mbledhje e ndenja për të të diskutuar, të gjithë gjumashët, demagogët, poltronët. Troç papunëtorët. Madje, do t'a përgatisnim edhe banakun për pije, do t'u siguronim shah, tavlla, letra e diç tjetër për t'u argëtuar. Ndërsa, në fabrikën që e kemi, do t'u mundësonim të vinin ata që punës si bëjnë lak. Ata mund të punojnë e të fitojnë për vete dhe për ne.

Për çudi të të gjithëve, askush s'pati guxim më tepër të bënte gëk as mëk. Kokulur, me bishtin ndër vegë, boshatisën sallën.

AUTOBIOGRAFIA

Kam lindur në shekullin e kaluar në Tetovë. Sipas dokumenteve zyrtare më 19 maj 1945. Sipas mbamendjes së nënës sime të ndjerë, e cila plotë nëntë muaj më ka mbajtur në bark në kohën e manave e të shirave, 3-4 muaj pa u prishur Shipëria e pa ardhur partizanët. Nuk ia bëj kurrë hallall këtë nënës – që aq shumë e desha. Ka mundur të më lindte në fshatrat e Kërçovës, a të Drenicës, mbase do të bëhesha edhe në unë trim me fletë si Alameti me shokë dhe pa e shkrepur asnjë plumb të merrja flamurin e të parit të fisit, dua të them të shqiptarëve të rajonit që bashkë me pobratimat e shpirtit, t'ua thitja gjakun si ushujzë. Nejse. shkollën fillore dhe atë të mesmen i mbarova në vendlindje. Pra, qeveritarët e mortajës së kuqe, nuk më lanë analfabet si prindërit. Ani se nuk më ndanë as bursë e as kredi, nuk më penguan të shkoj në studime në qytetin më të madh të Perandorisë së kuqe në Beograd, ku regjistrova Albanologjinë pranë Fakultetit Filologjik. Nuk bën të ankohem, mirë kalova. Me hamallëk e shkarkim të vagonave me qymyr në stacionin e trenave, arrita t'i kryej dy vitet e para. Fatbardhësia më e madhe ishte se në bibliotekën e pasur të fakultetit (më e pasura me libra në gjuhën shqipe pas asaj në Tiranë), arrita përmes leximit ta njoh veten kush

jam e nga e kam prejardhjen. Kjo, do t'më ndihmojë që të çohem nga gjumi i rëndë e të nisi me zevzëkllëqet e mia. Kështu, do të marrë pjesë në të gjitha demonstratat që rinia e kohës i organizonte, për t'u parapërgatitur që atë ndjenjë ta barti (me shokë) edhe në trojet e populluara me shqiptarë. Kështu, më 1968, m'u dha detyrë që në vendlindjen time të organizojmë demonstratat e para masovike pas të ashtuquajturës Luftës së Dytë çlirimtare për të tjerët e jo për ne. Për këtë, për trimni, nga Gjykata e Qarkut në Shkup u dekorova me "Medale të artë" - pesë vjet e gjysëm heqje lirie. Kjo më bëri mirë. U poqa e u stërpoqa me përvojë të hatashme jetësore. Pas afro tri vjetë të kaluara në Idrizovë, ia pashë sherrin Prishtinës. Aty m'u dha e gjithë përkrahja e mundshme për të vazhduar studimet (vitin e III-IV) në Fakultetin Filozofik – Grupi Gjuhë dhe letërsi shqipatare, të cilat i kreva gati me kohë. Sheri më i madh, por i ëmbël, plasi kur njoha një vajzë tepër serioze nga Peja, që më vonë do bëhet diploma ime jetësore. Meqë, po që më fali në seri dy djem dhe një vajzë si drita edhe pas dyzet vitesh martese, vazhdojmë të duam njëritjetrin si në fillim. Punë e madhe nëse dikujt i duket e pabesueshme. Kam copa-copa edhe përvojë pune. Kam punuar nga një vit mësues në fshatin Grupçin, Shipkovicë të Tetovës, ndërsa në fshatin Sellcë më lanë vetëm tre muaj, ku nuk më mbetet zemra djegë, e vendosa flamurin kombëtar e prej atje në kazamate. Pastaj, kamë dhënë gjuhën shqipe në Gjimnazin e Vitisë, ku Letra e Titos, s'më dha afat as të përfundoja vitin. Përfundimisht, do të përcaktohem të merrem me gazetari. Do të filloj me "Botën e Re", pastaj në "Rilindje" (pas testit provues), të cilën, u detyrova ta lëshojë, apo më mirë të them, nuk munda ta përmbushë kërkesën e njëfarë sekretari Manxhuka, për t'ia paraqitur vërtetimin se jam mik i shtetit, se nuk jam nën hetime e as i dënuar. Falë vëllezërve nga Kosova, gjithmonë gjendeshin zgjidhje

rezervë për të ardhurit nga rajonet e tjera të Perandorisë së kuqe.

Do të punoj më shumë se katër vite si redaktor në gazetën "Kosova" të KXEMK në Obiliq, për të kaluar në gazetën lokale të delegatëve në KK të Prishtinës, plotë 12 vjetë. Me t'u përzier leshrat në ish Jugosllavi, ndër të parët do të më kap paragrafi i pushimit nga puna. Gjatë viteve të demokracisë, 4 vite do të shërbejë si korrespondent i "Zërit të Amerikës" nga vendlindja, 4 vjet, pastaj, kryeredaktor i të përditshmes "Flaka e Vëllazërimit" ku e lash një nam të vogël: ia shkurtova bishtin ideologjik dhe e pagëzova vetëm "Flaka, të cilin emër e ruajti deri në vdekje e saj.

Me shkrime kam filluar të merrem qysh si nxënës i gjimnazit, i nxitur nga prof. Murat Isaku. Kam bashkëpunuar tërë jetën gati me të gjitha gazetat dhe revistat serioze dhe joserioze të kohës. Ndërsa, për botimin e veprave jam zgjuar në pleqëri që ta bëj. Jo për t'u bërë shkrimtar, por për ta mundur pleqërinë dhe mbase edhe t'i gëzoj nipat e mbesat.

Ky është libri i dytë me tregime humoristike-satirike pas "Bacaloku" (1986), pa i harruar as librat me epigrame e vargje satirike "Vargje të serta","Britmat e buta"(2011), "Pëshpërima të ëmbla", "100" (2012).

Për çudi, duke u ikur detyrave të shtëpisë po më shtohet vullneti që të rri vetëm, për të shkruar. Kështu e arsyetoj dezertimin. Gati të gjitha librat e viteve të fundit i botojë me pensionin prej 80 euro të Kosovës me të cilat ha, pi dhe bile më mbesin të shkoj në pushime e të kursejë për ditë të zeza.

PËRMBAJTJA

RRËFIME JO THJESHT HUMORISTIKE 3
KUDR-A 5
FLIJA NË FYT 9
BURRAT E DHEUT 13
MJEKRA MIQËSORE 17
SHKULJA E GJUHËS 21
TUTA NË PALCË 25
TOPET 29
PROMOVIMI 33
HAJMALIA 37
KRYEKOKA 39
GOJA HAM, SHPINA BAM 43
UJI I TASIT 47
MËNGJESI I MAJMË 51
MEZEJA 55
XUXI 59
KËNGËTARI 63
PËRVJETORI I MARTESËS 67
DHËMBI POLITIK 71
KACULI 77
AH, KJO ORË POLICORE! 79
PAMPERSAT 81

PETICIONI 83
S'KA MË BYTH VIÇI 85
MINISTRI YNË LESHKO 87
QENËRISHT 89
OGRAKU 91
MIKROBORGJEZI I ZYRËS SONË 95
SHYQYR QË ISHA ËNDËRR 99
NOKAUTI 101
PUSHIMI NË MËNYRË VETËQEVERISËSE 105
PUTHADORI 107
NJË LIGJERATË E ÇUDITSHME 109
AH, MË DOGJE! 113
SHKOJ NË PUNË POR... 117
UNE, KOPILI 121
INTERVISTA 125
MJALTI 129
KUADRI DEFICITAR 133
UNË, GOJËMBËLI 135
NDËRGJEGJA 139
FABRIKA E RE 143
AUTOBIOGRAFIA 147